



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera/Office of the Prime Minister

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

2009-2011

Prishtinë, maj 2009

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PARATHËNIE

2. FALËNDERIME

3. AKRONIMET DHE SHKURTESAT

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

5. HYRJE

6. PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

6.1 ÇËSHTJE TË GËRSHETUARA

6.1.1 Grupet e rrezikuara brenda personave me aftësi të kufizuara

6.1.2 Mbledhja e të dhënave

6.1.3 Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi për ndryshimin e sjelljes

6.1.4 Komisionet shumë-disiplinore

6.1.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar

6.2 SHËNDETËSIA

6.3 ARSIMI

6.4 PUNËSIMI

6.5 MBROJTJA SOCIALE

6.6 QASJA

6.7 TË DHËNA STATISTIKORE

6.8 RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

6.9 SHTOJCAT

1. PARATHËNIE

Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë të vendosur ka theksuar se një nga angazhimet kryesore të saj ka qenë hartimi dhe zbatimi i politikave anti-diskriminuese, të cilat garantojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj pavarësisht nga mosha, gjinia, etnia, religjioni, raca, kufizimet e aftësisë etj. Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitet 2009 – 2011 është një nga hapat e rëndësishëm drejt përbushjes së këtij zotimi. Pos kësaj, me këtë plan janë përcaktuar parimet fundamentale për hartimin dhe zbatimin e politikave të qëndrueshme kombëtare me qëllim të sigurimit të mundësive që njerëzit me aftësi të kufizuara të jenë pjesëmarrës aktiv dhe të pavarur në të gjitha fushat e jetës sociale në Republikën e Kosovës.

Qëllimi

Qëllimi i përgatitjes së këtij plani është të përmirësojë cilësinë e jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovë dhe po ashtu të përbushë obligimet shtetërore që Kosova i ka për respektimin e Konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) që janë në mesin e parakushteve që Kosova të lëvizë përpara në procesin e integritimit evropian.

Ky dokument strategjik është një mjet i rëndësishëm në kuadër të përpjekjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të krijuar politika më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara. Ky plan ofron mundësinë që t'u kushtohet më shumë vëmendje Personave me Aftësi të Kufizuara dhe është një intensifikim i përpjekjeve të përgjithshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt respektimit të plotë të këtyre të drejtave.

Në takimin e mbajtur më 20.03.2008, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr.10/20 ka miratuar propozimin për të përgatitur një Plan Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Bazuar në vendimin nr.10/20, është krijuar një Grup Punues, i cili përbëhej prej gjashtë nën-grupeve punuese për çështje të veçanta: arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, punësimin, qasjen dhe të dhënat statistikore. Grupi Punues ka qenë përgjegjës për sigurimin e informacioneve për planin kombëtar të veprimit në mënyrë që ai të jetë në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor për të drejtat e njeriut.

Përgatitja e planit është plotësisht në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dokumentet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bashkëpunimi

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është rezultat i koordinimit dhe bashkëpunimit të ngushtë midis Zyrës së Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë dhe përfaqësuesve të ministrive të ndryshme, përfaqësuesve të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara dhe ekspertëve të Bashkëpunimit Italian / Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë, që ka mbështetur aktivitetet e ndërlidhura me procesin e përpilimit.

Si rezultat i kësaj, ky plan pasqyron, në mënyrë reale, gjendjen aktuale të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, por, në të njëjtën kohë, përkufizon veprimet të cilat duhet ndërmarrë në periudhën kohore 2009-2011, për të tejkaluar problemet e tanishme.

Ky plan është përgatitur me qëllim që të jetë një plan i qartë, funksional, i arritshëm dhe fleksibël në mënyrë që të mund të jetësohet, dhe nëse është e domosdoshme, të mund të ndryshohet në përputhje me zhvillimet në të ardhmen. Në këtë plan janë identifikuar dhe përkufizuar detyrat më parësore, është qartësuar bashkërendimi mes palëve të interesuara, janë vënë afate të sakta të përbushjes së detyrave

dhe po ashtu janë përkufizuar institucionet përgjegjëse të cilave u janë dhënë detyra dhe përgjegjësi të ndryshme për jetësimin e këtij plani.

2. FALËNDERIME

Ministritë dhe institucionet

KK Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MEF Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale
MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
MSH Ministria e Shëndetësisë
MSHP Ministria e Shërbimeve Publike
MTTK Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
ESK Enti Statistikor i Kosovës
IPK Instituti Pedagogjik i Kosovës
UP Universiteti i Prishtinës

Organizatat Lokale

Caritas Kosova
Qendra për Jetë të Pavarur, Pejë (Center for Independent Life)
Koalicioni i OJQ-ve (Coalition of NGOs)
DONI Autizëm
Downsyndrome Kosova
Hader, Prizren
HANDIKOS – Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës
Shoqata e Distrofisë Muskulare - Handicapped and Disabled People of Kosova
HENDIFER Ferizaj
Hendikap Kosova
Shoqata e personave të shurdhër (Gluvi), Gjilan
QEK Qendra për Edukim e Kosovës (KEC)
KGVK Komiteti për gratë e Verbëta të Kosovës (CBWK)
Klubi Dëshira
Institucioni Parashkollor “Ardhmëria 2”, Gjilan
SHKSH Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (Kosovar Association of the Deaf)
K-MDRI Kosovo Mental Disability Rights Initiative
SHNNJV Shoqata Ndërkomunale e Njerëzve të Verbër (Intermunicipal Association of Blind People)
Shoqata Njerëzit e Vegjël të Kosovës (Little People of Kosovo)
Shoqata Mustafa Bakija, Gjakova
Shoqata Ne për Ne
SHPFK Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Kosovës OPFAKKOS (Parents Association of Children with Disabilities of Kosovo)
QKVP Qendra Kosovare për Vetë-Përkrahje (Kosovar Centre for Self Help)
QR Qendra Rehabilituese “Shtëpia e Bletëve” (Rehabilitation Center “Shtëpia e Bletëve”)
Qendra e Burimeve “Përparimi” (Resource Centre “Përparimi”)
Shoqata Sfida, Gjakovë
Shoqata Kosovare e të Verbërve dhe më të Parë të Dobësuar (SH.V.P.D.K Kosovar Association of the Blind and Partially Sighted)

Shkolla Speciale – Qendra e Burimeve “Xh. Deda”, Pejë (Special School - Resource Center “Xh. Deda”, Pejë)

Shkolla Speciale - Qendra e Burimeve “Nënë Tereze”, Prizren (Resource Center “Nënë Tereze”, Prizren)
SOS Kinderdorf

Grupi T.E.M.A. (T.E.M.A. Group)

Agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare

BI Bashkëpunimi Italian (Italian Cooperation)

KE Këshilli i Evropës (COE)

KE Komisioni Evropian (EC)

Qeveria Finlandeze (Finnish Government – FSDEK II)

Handicap International

ONP Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

IKS Instituti Kombëtar i Statistikave, Itali (ISTAT Istituto Nazionale Statistica)

MDRI Mental Disability Rights International

ZKLDNj Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR)

OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)

Save the Children

SIDA / ESK (SIDA/SOK)

PZHKB Programi për Zhvillimi i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

UNICEF Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)

FZHGKB Fondi për Zhvillim për Gra i Kombeve të Bashkuara (UNIFEM)

UN HABITAT United Nations Human Settlements Programme

BB Banka Botërore (WB)

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO)

3. AKRONIMET DHE SHKURTESAT

QBB Qendrat me Bazë në Bashkësi
RBB Rehabilitimi me Bazë në Bashkësi
KE Këshilli i Evropës
QKP Qendra për Kapacitete Profesionale
KDPAK Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
PKVPAK Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
DPP Departamenti i Punës dhe i Punësimit
OPAK Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara
KE Komisioni Evropian
NFZHAK II Ndhima Finlandeze për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë
ABEF Analizë e Buxhetit të Ekonomive Familjare
DNJ Të Drejtat e Njeriut
KNFSHPAK Klasifikimi Ndërkombëtar mbi Funksionimin, Shëndetin dhe Aftësitë e Kufizuara - ICF
TIK Teknologjia e Informimit dhe e Komunikimit
ZNC Zyra Ndërkombëtare Civile
ONQ Organizata Ndërqeveritare
IKAP Instituti Kosovar i Administratës Publike
ONP Organizata Ndërkombëtare e Punës
IPK Instituti Pedagogjik i Kosovës
SNKA Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Arsimit - ISCED
SIAK Sistemi i Informimit mbi Aftësitë e Kufizuara
BKK Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
AFP Analizë e Forcës së Punës
MIPJ – BI Ministria Italiane e Punëve të Jashtme – Bashkëpunimi Italian (Italian Cooperation)
MKK Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit
MKRS Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DKA Departamenti Komunal i Arsimit
MEF Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ZKP Zyra Komunale për Punësim
MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPB Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH Ministria e Shëndetësisë
MSHP Ministria e Shërbimeve Publike
KASH Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MTI Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
MTPT Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
OJQ Organizata Joqeveritare
IKSHP Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
ZQM, DNJ, SHB Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta
ZKLDNJ Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
IO Institucioni i Ombudspersonit
ZKM Zyra e Kryeministrit
OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PIA Programi Individual i Arsimimit (PEI)
PAK Personat me Aftësi të Kufizuara
QRP Qendra Rajonale e Punësimit

RREG Rregullore
ESK Enti Statistikor i Kosovës
GTP Grupi Tematik Punues
DUDNJ Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut
KB Kombet e Bashkuara
UN HABITAT Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
PZHKB Programi për Zhvillimi i Kombeve të Bashkuara
DÇESKB Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara
OASHKKB (UNESCO) Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
EKBB Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën
FFKB Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara
FZHGKB Fondi i Zhvillimit për Gra i Kombeve të Bashkuara
UNMIK Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UP Universiteti i Prishtinës
QPT Qendra Profesionale të Trajnimit
KFIAKB W3C Konzorciumi i Faqes së Internetit Anekënd Botës (World Wide Web Consortium)
BB Banka Botërore
GP Grupi Punues
OBSh Organizata Botërore e Shëndetësisë

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Më 20 mars, 2008 Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 10/20 ka miratuar propozimin për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut dhe Mundësi të Barabarta e ka koordinuar dhe udhëhequr tërë procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Procesi i pjesëmarrjes ka filluar më 18 qershor 2008, me angazhimin aktiv të përfaqësuesve nga Ministritë, institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare (shih paragrafin 2, FALËNDERIMET).

Bashkëpunimi Italian – Ministria për Punë të Jashtme (Italian Cooperation-Ministry of Foreign Affairs) ka siguruar mbështetjen teknike për hartimin e Planit të Veprimit.

Organizatat Ndërkombëtare kanë marrë pjesë në procesin e pjesëmarrjes, duke siguruar kontributet teknike gjatë procesit të hartimit të këtij plani.

Gjashtë grupe punuese tematike janë themeluar për të udhëzuar diskutimet teknike dhe për ofrimin e informacioneve mbi: Shëndetësinë/Rehabilitimin, Arsimin, Mbrojtjen Sociale, Punësimin, Qasjen, Statistikat dhe Mbledhjen e të Dhënave.

Deri më 15 shtator 2008 janë mbajtur disa takime pune për të diskutuar haptazi dhe për të gjetur gjuhë të përbashkët brenda grupeve punuese, konkluzionet e të cilave janë inkorporuar në gjashtë matricat, të bashkëngjitura projektit të planit të veprimit. Më 3 dhjetor 2008, versioni i parë i Planit të Veprimit i është prezantuar publikut dhe pastaj është shpërndarë në pesë komuna: Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, për komente të mëtejme, të gjitha të përfshira në versionin final të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PVPK).

Struktura dhe parimet ligjore të Planit të Veprimit i referohen në mënyrë të veçantë Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e hyrë në fuqi më 3 maj 2008, dhe Planit të Veprimit të Këshillit të Evropës.

Aktualisht, këto Akte ende nuk kanë forcë ligjore në Republikën e Kosovës, por ato vërtet përfaqësojnë terma të referencës fundamentale juridike për Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, për të siguruar politika mbi aftësitë e kufizuara të bazuara në akte konkrete ligjore dhe për të ushtruar një ndikim pozitiv mbi personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës. Njohja ndërkombëtare e Kosovës si anëtare e Kombeve të Bashkuara do të kërkojë po ashtu analiza të legjisllacionit lidhur me respektimin e parimeve ndërkombëtare kryesisht të mishëruara në Konventat e Kombeve të Bashkuara. Së këndejmi, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është përpjekja e parë për të harmonizuar legjisllacionin e Kosovës me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut në sektorin e aftësive të kufizuara.

Diskutimi i gjerë dhe konsultimi në nivel qendror dhe komunal, që ka çuar deri te versioni final i projektit, nuk duhet të konsiderohet i përfunduar, duke pasur parasysh se Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPK) ka për synim të jetë një dokument vital programatik i cili monitorohet, vlerësohet dhe përpunohet në baza vjetore dhe që po ashtu përshtatet ndaj zhvillimeve socio-ekonomike dhe financiare të Republikës së re të Kosovës.

Procesi i participimit i testuar gjatë hartimit të dokumentit duhet të shfrytëzohet si një trashëgimi për korrigjimet e ardhshme të Planit të Veprimit.

Pjesëmarrja aktive e anëtarëve të grupeve tematike të përmendura në paragrafin 2 është karakterizuar me diskutime konstruktive e demokratike në kuadër të grupit punues. Një kontribut i veçantë, në kuptimin e analizës, propozimeve, rekomandimeve dhe komenteve është siguruar nga të gjithë pjesëmarrësit në një qasje aktive participuese.

Produkt i secilit grup punues tematik është përshkrimi i situatës së tashme dhe matrica e propozuar për Planin e Veprimit, bazuar në kornizën e një metodologjie logjike.

Sipas matricës për të cilën është arritur pajtimi, versioni i parë është bazuar në objektivat, aktivitetet, aktorët llogaridhënës, treguesit e përmeshjes së detyrave, afatet kohore dhe burimet financiare.

Çështjet e tjera të gërshetuara, të cekura në tabelën e përmbajtjes, janë vetëm një propozim për aktivitete të reja, të cilat kërkojnë diskutime të hollësishme në një fazë të mëvonshme pas shpërndarjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPK).

Lidhur me çështjet financiare, të gjitha objektivat sektoriale dhe aktivitetet, si dhe propozimet për ato që gërshetohen, ato u referohen treguesve ekonomik bazuar në tri dispozita të ndryshme buxhetore:

- Burimet financiare në dispozicion nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të miratuara me Ligjin nr. 03/L-105 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009;
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve si një program relevant programatik, periodikisht i shqyrtuar dhe i zbatuar përmes burimeve interne dhe buxhetit të donatorëve ndërkombëtarë dhe
- Aktivitetet me shpenzime të ulëta ose pa shpenzime për të cilat nuk kërkohen ndarje të mjeteve shtesë.

5. HYRJE

Statusi i pavarur i Republikës së Kosovës, me të gjitha përpjekjet ligjore e administrative në procesin transitor, është mjedisi i duhur për një qasje të re ndaj aftësi të kufizuara si çështje e të drejtave të njeriut dhe si çështje e zhvillimit.

Në pajtim me nenin 1 të Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ky Plan i Veprimit ka miratuar përkufizimin e mëposhtëm: “Persona me aftësi të kufizuara konsiderohen ata persona që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore që, në ndërveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efikase në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Ky përkufizim i personave me aftësi të kufizuara është shtyllë e planit të veprimit dhe e legjisllacionit të ardhshëm në Republikën e Kosovës.

- Aftësitë e kufizuara universalisht janë të pranuar si çështje e të drejtave të njeriut. Në të vërtetë, Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) është Konventa e parë e të Drejtave të Njeriut e shekullit 21 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 26 dhjetor 2006 dhe e hyrë në fuqi më 3 maj 2008, më 23 mars 2009 Konventa është nënshkruar nga 139 Shtete Anëtare dhe është ratifikuar nga 50 Anëtarë¹.

KDPAK së bashku me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale janë shtyllat ligjore për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Republika e Kosovës është zotuar t'u përmbahet të gjitha instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në veçanti Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, edhe pse tash Republika e Kosovës nuk mund ta nënshkruajë atë si dokument intern ligjor. Megjithkëtë, Kosova ka filluar me një proces në vazhdimësi për afirmimin e të drejtave të njeriut dhe garantimin e standardeve më të larta të jetesës për personat me aftësi të kufizuara.

Aftësitë e kufizuara po ashtu konsiderohen si faktor i zhvillimit, për shkak të ndikimit mbi varfërinë, jo vetëm të individit me aftësi të kufizuara, por po ashtu edhe në familjet e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara nga të qenit pjesëtarë aktiv i ambientit socio-ekonomik nuk do të lejojë arritjen e Qëllimeve të Mijëvjeçarit të vendosura nga bashkësia ndërkombëtare. Personat me aftësi të kufizuara shpesh janë personat më të varfër dhe më të marginalizuar në shoqëri dhe secili intervenim i cili e ka objektin këtë nën-grup të popullatës së Kosovës ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi varfërinë.

Përkundër mungesës së të dhënave të besueshme mbi aftësitë e kufizuara në Republikën e Kosovës, efektet e konfliktit të mëhershëm dhe situata e rëndë socio-ekonomike e disa pjesëve të vendit është e mundshme që forma të ndryshme të aftësisë së kufizuar në Republikën e Kosovës mesatarisht prekin 7 % të tërë popullatës, të përcaktuar nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011².

Sistemi i tashëm ligjor në lidhje me personat me aftësi të kufizuara është heterogjen për shkak të bashkekzistencës së ligjeve me qasje si mjekësore ashtu edhe sociale ndaj personave me aftësi të kufizuara. Legjisllacioni më i ri i miratuar lidhur me personat me aftësi të kufizuara, bazuar në qasjen e të drejtave të njeriut, siç është legjisllacioni jo-diskriminues³, nuk është zbatuar në mënyrën e duhur.

Plani Kombëtar i Veprimit miraton qasjen e tashme ndërkombëtare sociale, duke vendosur parime dhe veprime me qëllim të promovimit, mbrojtjes dhe garantimit të realizimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara si dhe përkrahjen e respektit për dinjitetin e tyre të pandashëm.

Si pasojë e kësaj, fjalori i përdorur në shkrimin e Planit për Personat me Aftësi të Kufizuara është në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe në pajtim me Organizatat për Personat me Aftësi të Kufizuara. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mire, të Drejtat e Njeriut dhe Bashkëpunimi Italian (Italian Cooperation) nënvizojnë rëndësinë e disponimit të një fjalorthi të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës mbi

¹ Të dhëna nga Faqja e internetit e Kombeve të Bashkuara <http://www.un.org/disabilities/>

² Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011, Paragrafi IV. B. 1

³ Ligji nr. 2004/3 Ligji kundër diskriminimit.

sektorin e aftësive të kufizuara për të dyja gjuhët zyrtare, si udhëzim për shfrytëzim nga hartuesit e politikave për konsistencë dhe respektim të personave me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e njeriut

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e Kombeve të Bashkuara parasheh se gjendja e aftësive të kufizuara *“rezulton nga ndërveprimi midis personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimeve dhe të ambientit të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efikase në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”*, dhe e vendos respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në kornizën e mbrojtjes dhe të përkrahjes së të drejtave të njeriut.

Sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi të drejtat e njeriut të Republikës së Kosovës (2009-11), Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) përfaqëson veprimin kryesor për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës. Lidhur me zbatueshmërinë e instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) thekson masa konkrete për garantim të shanseve të barabarta dhe jo-diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Derisa është i përqendruar në disa nga fushat qendrore tematike, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) nuk përjashton veprime të tjera të brendshme me bazë ndër-sektoriale, siç është njohja e barazisë para Ligjit, qasja ndaj drejtësisë, respektimi i të drejtave të njeriut në rast të kufizimeve ligjore të lirisë etj.

Për këtë qëllim, legjislacioni jo-diskriminues i Republikës së Kosovës është gur-themel ligjor për krijimin e një kornize të gjithmbarshme, po ashtu, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

6. PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011 kërkon integrimin e qëllimeve të Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁴ dhe të traktateve të tjera relevante ndërkombëtare dhe rekomandimeve për të drejtat e njeriut, jo-diskriminimin, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në kornizën e parë kombëtare të politikave mbi personat me aftësi të kufizuara për vitet 2009-2011.

Plani i Veprimit ka për qëllim sigurimin e një kornize e cila është fleksibile dhe e adaptueshme me qëllim të plotësimit të kushteve specifike të vendit. Ka për qëllim të shërbejë si një udhërrëfyes për hartuesit e politikave dhe Organizatat për Personat me Aftësi të Kufizuara që t'u mundësojë atyre të hartojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë planet e duhura, programet dhe strategjitë e reja, të cilat në mënyrë periodike do të përshtaten dhe të ri-fokusohen.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mire, të Drejtat e Njeriut dhe Mundësi të Barabarta është thirrur të monitoroj Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara përmes sigurimit të asistencës për të gjitha Ministrinë kompetente dhe administratat lokale në formë të rekomandimeve, këshillës dhe informacionit të ekspertëve dhe sigurimit të pjesëmarrjes së OPAK dhe palëve tjera kyçe.

Parimet fundamentale

Republika e Kosovës do të vazhdojë të punojë brenda kornizave anti-diskriminuese dhe të të drejtave të njeriut për të përforcuar pavarësinë, lirinë e zgjedhjes dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe për të ngritur vetëdijen mbi aftësitë e kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor.

Për hartimin e planit janë marrë parasysh instrumentet evropiane dhe ndërkombëtare, traktatet dhe planet, me përqendrim të veçantë në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të hyrë në fuqi në maj të vitit 2008.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara e pranon parimin themelor se shoqëria ka detyrë ndaj të gjithë qytetarëve të saj të sigurojë se efektet e aftësive të kufizuara janë të minimizuara përmes mbështetjes aktive të stilit të shëndetshëm të jetesës, ambienteve më të sigurta, kujdesit shëndetësor adekuat, rehabilitimit, pajisjeve dhe komuniteteve mbështetëse.

Plani i Veprimit bazohet në **tetë parime të përgjithshme** të përkrahjes së të drejtave të njeriut dhe të pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës:

- Respektimi i dinjitetit të patjetërsueshëm, autonomisë, duke përfshirë lirinë për të sjellë vendime vetjake, dhe i pavarësisë së personave;
- Jo-diskriminimi;
- Pjesëmarrja e plotë, efikase dhe përfshirja në shoqëri;
- Respekti për dallimet dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit apo larmisë njerëzore dhe e humanitetit;
- Mundësitë e barabarta;
- Qasja;
- Barazia midis meshkujve dhe femrave dhe
- Respektimi i kapaciteteve evoluese të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetet e tyre.

⁴ Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përbënë etapë ndërkombëtare; e nënshkruar nga 139 vende dhe e ratifikuar nga 51 vende (më 17 Mars, 2009)

Qëllimet strategjike

Objektivi kryesor i Planit Kombëtar të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara është të shërbejë si një mjet praktik për zhvillim dhe implementim të strategjive të realizueshme sektoriale me qëllim të realizimit të pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke e përfshirë çështjen e aftësive në të gjitha fushat e politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Plani Kombëtar i Veprimit 2009-2011 ka për synim plotësimin e kushteve specifike të vendit si dhe proceset transitorë që po ndodhin në Kosovë.

Ai përfshin rekomandimet për të ndërmarrë veprime specifike në nivel kombëtar dhe po ashtu për të ndriçuar aspektet e grupeve të rrezikuara të personave me aftësi të kufizuara, të cilët ballafaqohen me pengesa specifike dhe me probleme të cilat kërkojnë qasje të gërshtuar.

Ai inkurajon Qeverinë qendrore dhe atë lokale për t'ju përgjigjur nevojave të personave me aftësi të kufizuara përmes sigurimit të shërbimeve cilësore e novatore dhe për konsolidimin e masave që tashmë ekzistojnë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara siguron një burim të dobishëm të inspirimit po ashtu edhe për ndërmarrjet private, organizatat joqeveritare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Ai i konsideron organizatat joqeveritare dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara si partnerë kompetentë dhe ekspertë në zhvillimin e politikave, të cilët duhet të këshillohen si palë të kyçura në proceset vendimmarrëse të cilat ndikojnë mbi jetët e tyre. Implementimi i Planit të Veprimit do të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht me qëllim të identifikimit të përparimit të arritur dhe këmbimit të praktikave të mira.

Plani është një dokument pune me një **matricë të objektivave, aktiviteteve, aktorëve, indikatorëve të përmbushjes së detyrave**, burimeve financiare, afateve kohore dhe përgjegjësisive.

Burimet financiare

Matrica përcakton parametrat e aktiviteteve të lidhura me afatet kohore, përgjegjësitë e aktorëve/institucioneve të angazhuara, indikatorët për vlerësim dhe monitorim të rezultateve si dhe propozimet për kërkesa të mundshme për financim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe agjencitë donatore për përcaktimin dhe implementimin e saj.

Para së gjithash, do të ishte e nevojshme të realizohen aktivitetet gjatë vitit 2009 për të cilat ministritë do të mund të shfrytëzonin fondet tashmë të ndara (BKK) duke i ri-alokuar ato drejt aktiviteteve të ndërlidhura me personat me aftësi të kufizuara.

Në të njëjtën kohë, procesi i aktiviteteve me shpenzime të ulëta dhe pa shpenzime duhet të fillojë me qëllim që të kompletojë aksionet brenda afateve kohore të treguara (p.sh. në ndërtimin e objekteve ose prodhimin e mallrave, koncepti i “dizajnit universal”, mundëson dhe garanton qasjen e secilit person pa shpenzime plotësuese për ndryshime.)

Duke marrë parasysh rrethanat se disa objektiva dhe aktivitete të caktuara të Planit Kombëtar të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara nuk korrespondojnë me dispozitat specifike ekonomike, korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) do të azhurnohet nga ministritë sipas Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave përmes procesit semestral të rishqyrtimit.

Struktura e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është i strukturuar në çështje të gërshetuara si më poshtë:

- Grupet e rrezikuara brenda personave me aftësi të kufizuara (duke përfshirë Gratë, Vajzat, Fëmijët, të Rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe migrantët);
- Mbledhja e të dhënave;
- Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi me qëllim të ndryshimit të sjelljes;
- Komisionet shumë-disiplinore;
- Trajnimi mbi Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për deputetët dhe zyrtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Si dhe çështje tematike si më poshtë:

- Shëndetësia;
- Arsimi;
- Punësimi;
- Mbrojtja sociale
- Qasja
- Të dhënat statistikore.

6.1 ÇËSHTJE TË GËRSHETUARA

6.1.1 Grupet e rrezikuara brenda personave me aftësi të kufizuara

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës, në pajtim me Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë e Re për Kohezion Social të Këshillit të Evropës (2004), thekson nevojën për një angazhim të veçantë për të siguruar qasje ndaj të drejtave të njeriut për njerëzit të cilët janë në rrezik të arritjes së kategorisë së njerëzve të rrezikuar, siç janë fëmijët dhe të rinjtë, pakicat etnike dhe të shpërngulurit, personat me aftësi të kufizuara serioze dhe të moshuarit.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara në nevojë për nivel të lartë të ndihmës, fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, personat e moshuar me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe komunitetet e shpërngulura kanë një rrezik më të lartë të përjashtimit dhe zakonisht kanë nivele më të ulëta të pjesëmarrjes në shoqëri se sa njerëzit e tjerë me aftësi të kufizuara dhe së këndejmi, kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të pengesave e barrierave specifike, diskriminimit të shumëfishtë, dëmtimit të vetëvendosjes dhe rrezikueshmërisë me të cilat ata ballafaqohen.

Një nga grupet më të rrezikuara të personave me aftësi të kufizuara është grupi i njerëzve të cilët, për shkak të kompleksitetit dhe të seriozitetit të aftësive të tyre të kufizuara, kanë nevojë për një nivel të lartë të ndihmës.⁵ Cilësia e jetës së tyre në masë të madhe është e varur nga të qenët në dispozicion të shërbimeve cilësore dhe të veçanta, shpesh nga ndihma intensive. Planifikimi dhe bashkërendimi midis autoriteteve relevante, agjencive qeveritare dhe ofruesve të shërbimeve janë të nevojshme për të adresuar në mënyrë adekuate problemet e veçanta të këtij grupi të njerëzve.

Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta – siç janë parashtruar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara – dhe mundësi të barabarta si edhe fëmijët e tjerë. Të rinjtë me aftësi të kufizuara po ashtu janë një grup i rrezikuar në shoqërinë tonë. Ata ende ballafaqohen me një numër pengesash në qasjen e tyre ndaj të gjitha aspekteve të jetës. Problemet e veçanta me të cilat ballafaqohen fëmijët dhe të rinjtë duhet të studiohen në një thellësi më të madhe me qëllim të hartimit dhe të zbatimit të politikave të informuara mirë në kuadër të një spektri të gjerë të fushave të politikës.

Procesi i plakjes progresive i personave me aftësi të kufizuara, posaçërisht i atyre të cilët kanë nevojë për më shumë ndihmë, paraqet sfida të reja për shoqëritë. Për t'u ballafaquar me këto sfida në kuadër të një vargu të gjerë të politikave dhe të fushave të shërbimit kërkohen qasje novatore.

Personat me aftësi të kufizuara nga minoritetet dhe komunitetet e shpërngulura mund të ballafaqohen me gjendje shumëfish të pafavorshme për shkak të diskriminimit ose të mungesës së afërsisë me shërbimet publike. Për të adresuar problemet e veçanta, me të cilat këto grupe mund të ballafaqohen, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila merr parasysh kontekstin kulturor, gjuhën dhe nevojat e veçanta.

Kur merret parasysh niveli i lartë i rrezikshmërisë dhe i diskriminimit të shumëfishtë të këtyre grupeve të personave me aftësi të kufizuara, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të inkuadrojë referenca të veçanta dhe aksione me objektiva të caktuara me qëllim të sigurimit të realizimit të plotë dhe të barabartë nga ta të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut dhe Mundësi të barabarta dhe Bashkëpunimi Italian sugjerojnë diskutimin në të ardhmen në thellësi të kësaj çështjeje me qëllim të propozimit të përfshirjes së referencave të veçanta dhe të veprimeve me objektiva të përcaktuara në planet përkatëse ekzistuese të veprimit për gratë, fëmijët dhe minoritetet.

⁵ Konventa e Kombeve të Bashkuara në Preambulën e saj thotë: “(j) *pranimi* i nevojës për të përkrahur dhe mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ata të cilët kanë nevojë për ndihmë më intensive.”.

Grupet e rrezikuara

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Garantimi se këto grupe të rrezikuara do të kenë mbrojtjen adekuate të drejtave të tyre	1.1 Përfshirja e referencës për këto grupe të rrezikuara në planet e tjera tematike të veprimit (p.sh., gratë, minoritetet etj..).	ZQM dhe Ministrinë përkatëse përgjegjëse për Planet e tjera të Veprimit	Numri i Planeve të Veprimit ku personat me aftësi të kufizuara janë të përfshirë	Në vazhdim e sipër 2009-2011	Shpenzimet do të përfshihen në planet e tjera të veprimit

6.1.2 Mbledhja e të dhënave

Të qenët në dispozicion i informatave të besueshme, adekuate dhe në kohë (sasiore dhe cilësore) ka një rëndësi të madhe për hartuesit e politikave për formulimin dhe zbatimin e politikave për vënien në fuqi të planit të tashëm dhe të ardhshëm të veprimit.

Procesi i mbledhjes dhe i mirëmbajtjes së këtyre informacioneve:

- Do të jetë në përputhje me rregullat, duke përfshirë legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave, sigurimin e konfidencialitetit dhe respektimin e privatësisë së personave me aftësi të kufizuara dhe
- Do të jetë në përputhje me normat ndërkombëtarisht të pranuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale si dhe parimeve etike në mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave statistikore.

Informacionet e mbledhura përmes regjistrimeve të popullsisë ose anketave do të shpërndahen, sipas nevojës, dhe do të shfrytëzohen për të ndihmuar në vlerësimin e implementimit të parimeve ndërkombëtare dhe për të identifikuar dhe adresuar pengesat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në të ushtruarit e të drejtave të tyre.

Shpërndarja e këtyre të dhënave statistikore do të jetë e arritshme për personat me aftësi të kufizuara dhe të tjerët⁶.

6.1.3 Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi për ndryshimin e sjelljes

Pos barrierave dhe pengesave, përjashtimi dhe marginalizimi varen po ashtu edhe nga stigma dhe diskriminimi social. Me qëllim të adresimit të ndryshimit të sjelljes, popullsia e përgjithshme dhe hartuesit e politikave kanë nevojë për të qenë të informuar dhe të arsimuar lidhur me çështjen e aftësive të kufizuara.

Ekziston nevoja për një komunikim dhe fushatë të arsimimit për ndryshimin e sjelljes.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut dhe Mundësi të Barabarta dhe Bashkëpunimi Italian kanë identifikuar trajnim të veçantë për Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KMDPAK) për deputetët dhe zyrtarët qeveritarë si trajnim shumë të rëndësishëm për suksesin e Planit të Veprimit.

Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi për ndryshimin e sjelljes

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
------------	-------------	---------	-----------	---------------	---------

⁶ Shih po ashtu Paragrafin 6.7 TË DHËNAT STATISTIKORE

1. Ndryshimi i sjelljes së popullatës së përgjithshme dhe i hartuesve të politikave mbi aftësitë e kufizuara	1.1 Fushatat e komunikimit me qëllim të ndryshimit të perceptimit të popullsisë lidhur me aftësitë e kufizuara (shkollat, organizatat fetare)	ZQM/ZKM dhe Ministrinë përkatëse përgjegjëse për Planet e tjera të Veprimit	Numri i fushatave dhe numri i njerëzve të cilët arrihet me anë të fushatave	Në vazhdim e sipër 2009-2011	Disa fushata mund të bëhen pa shpenzime (shkollat dhe organizatat fetare)
	1.2 Trajnimi mbi KMDPAK për deputetët dhe zyrtarët qeveritarë	ZQM/ZKM	Numri i deputetëve / zyrtarëve të qeverisë të trajnuar	2010, 2011	Donatorët të identifikohen

6.1.4 Komisionet shumë-disiplinore

Një çështje e cila është ngritur nga anëtarët e disa grupeve tematike është nevojja për vlerësim të aftësive dhe potencialeve individuale që në mënyrë adekuate të përkrahet përfshirja dhe pjesëmarrja e plotë në shoqëri me ndihmën e duhur, heqjen e barrierave, pengesave dhe të diskriminimit.

Një qasje e mundshme mund të ishte sigurimi i “komisioneve shumë-disiplinore”, të cilat mund të vlerësojnë aftësitë e individëve përgjatë gjithë ciklit jetësor. Komisionet shumë-disiplinore mund t’ju shërbejnë nevojave të Ministrive të ndryshme: shëndetit - për identifikim dhe intervenim të hershëm, Arsimit - për identifikim dhe planifikim individual të planeve të arsimit profesional, Punës dhe Mirëqenies Sociale - për vlerësim të shkathtësive, identifikim të trajnimeve profesionale dhe për gjetje të vendit të punës si dhe për vlerësim të kufizimeve funksionale për pensione.

Veprimet: Praktikant e mira ndërkombëtare mbi “komisionet shumë-disiplinore” duhet të mblidhen dhe të merren parasysh për një përfshirje të mundshme në korrigjimin e parë të Planit të Veprimit.

6.1.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Duke pasur parasysh rolin e bashkësisë ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, është thelbësore që aktorët ndërkombëtarë të pranishëm në Republikën e Kosovës të thirren për të hartuar dhe zbatuar programet dhe projektet e tyre në pajtim me parimet e shpallura në këtë Plan të Veprimit dhe në mënyrë më të veçantë të detajizuara në KMDPAK.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Përfshirja e çështjeve të aftësive të kufizuara në të gjitha projektet e financuara dhe / ose të ekzekutuara nga partnerët e zhvillimit (organizatat e zhvillimit multilateral dhe bilateral, OJQ-të ndërkombëtare).	1.1 Korrespondenca me të gjitha agjencitë e zhvillimit multilateral dhe bilateral dhe me OJQ-të ndërkombëtare për të kërkuar zyrtarisht një qasje gjithëpërfshirëse të bazuar në aftësitë e kufizuara në të gjitha projektet dhe programet e reja dhe ato në vazhdim e sipër.	ZQM/ZKM	Numri i organizatave të përfshira dhe numri i përgjigjeve pozitive	Në vazhdim e sipër 2009-2011	Nuk ka shpenzime të përfshira në aktivitetet të tilla

6.2 SHËNDETËSIA

KONTEKSTI POLITIK DHE LEGJISLATIV

Personave me aftësi të kufizuara duhet t'u ofrohet cilësia më e mirë e mundshme e jetës dhe të drejta të barabarta në shërbimet e kualitetit më të mirë shëndetësor që i ofrohen tërë shoqërisë.

Republika e Kosovës tashmë ka legjislacionin mbi shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Aktet kryesore janë: Ligji 38/2004 mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, neni 4.5 “*Kujdesi shëndetësor ofrohet pa asnjë diskriminim ... mbi bazën e ... kombësisë, besimit, gjinisë, orientimit seksual, moshës, statusit martesor, aftësive të kufizuara mendore ose trupore*”; Ligji 4/2004 Ligji mbi Shëndetësinë i Kosovës, neni 28 mbi Rehabilitimin e Bazuar në Bashkësi. Krahas kësaj, Plani i Veprimit i Këshillit të Evropës (2006) deklaron se “Rehabilitimi i personave me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur në integrimin ekonomik dhe social të cilin e arrinë, duhet të jetë në mesin e prioriteteve të secilës shoqëri”.

Në anën tjetër, është e dukshme se nuk ekziston një legjislacion i veçantë për shëndetin mendor në Kosovë. Sidoqoftë, ekzistojnë pikat relevante të përmendura në fusha të tjera të legjislacionit vendor, për shembull, Rregullorja mbi Procedurën Penale që përfshinë Kryerësit e veprave penale me çrregullime mendore. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 34/2004 është ligj i cili ka për objektiv të garantojë se procedurat penale që përfshijnë individët me çrregullime mendore duhet të trajtohen në pajtim me parimet e vendosura të së drejtës ndërkombëtare dhe trendet e përgjithshme në reformën e ligjit. Megjithatë, vetëm 3% e totalit të buxhetit mbi shëndetësinë të Ministrisë së Shëndetësisë është e rezervuar për shërbimet e shëndetit mendor.

Sipas parimeve të shpallura në Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kombeve të Bashkuara, siç është neni 25 “Shëndetësia” dhe neni 26 “Pajisja dhe Rehabilitimi”, është pranuar se personat me aftësi të kufizuara e kanë të drejtën të gëzojnë standardet më të larta të mundshme të shëndetit pa diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar dhe se do të merren parasysh masat efikase dhe të duhura për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara për të arritur dhe ruajtur pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, sociale dhe profesionale, përfshirjen e plotë si dhe pjesëmarrjen në të gjitha aspektet e jetës.

Programi i ardhshëm i propozuar mbi këtë çështje pjesërisht është frymëzuar nga kjo Konventë dhe nga plani i Veprimit i Këshillit të Evropës.

TË DHËNA

“Ekziston një mungesë e informacioneve mbi rezultatet e shëndetësisë, duke përfshirë të dhënat statistikore mbi morbiditetin (sëmundshmërinë) dhe mortalitetin, që mund të përdoren për krahasim ndërkombëtar. Kosova nuk mbledh të dhëna mbi treguesit e përgjithshëm shëndetësorë, duke përfshirë treguesit themelorë demografikë; treguesit e lidhur me stilin jetësor dhe ambientin; mortalitetin, morbiditetin dhe aftësitë e kufizuara si dhe burimet e kujdesit shëndetësor, shfrytëzimin e gjithanshëm dhe shpenzimet. Të dhënat ekzistuese mbi karakteristikat demografike të popullsisë dhe statusi shëndetësor janë në masë të lartë kontradiktore dhe e theksojnë nevojën për investim në një monitorim më të mirë dhe kapacitete vlerësuese në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH). Kjo mungesë e të dhënave pengon analizën e trendeve dhe krahasimin me të dhënat statistikore shëndetësore ndërkombëtare të cilat mund të ndihmojnë për të mbështetur formulimin dhe monitorimin e politikave shëndetësore në nivel kombëtar. Spitalet nuk janë të shfrytëzuara në masën e duhur. Edhe pse në Kosovë raportohet dendësia më e ulët e shtretërve në Evropë, pesë spitalet rajonale raportojnë një përqindje shumë të ulët të shfrytëzimit të shtratit, që lëviz prej asaj të ulëtës në 41% në Vushtrri deri te ajo mesatare prej 65% në katër spitalet e tjera.”⁷

Përqindjet e ulëta të shfrytëzimit të shtretërve spitalorë shkaktohen nga përqindjet e ulëta të pranimit dhe mesatares së shkurtër të kohëzgjatjes së qëndrimit. Spitalet kryesisht trajtojnë pacientët e kujdesit primar dhe sekondar dhe ofrojnë vetëm kujdes shëndetësor terciar të kufizuar, që çon deri tek një përzierje relativisht e ulët e rasteve për nga serioziteti midis pacientëve. Arsyet më të shpeshta për hospitalizim në pesë spitalet

⁷ Dokument mbi gjendjen teknike të sektorëve socialë në Kosovë, 7 korrik 2008 Komisioni Evropian – Banka Botërore

rajonale janë: sëmundjet respiratore (15 për qind), shtatzënia dhe lindja e foshnjave (11 për qind), dhe sëmundjet e sistemit të qarkullimit (10 për qind). Qendra Klinike e Prishtinës raporton të njëjtin model të sëmundjeve si edhe spitalet rajonale (Enti Statistikor i Kosovës, 2006). Shkalla e ulët e shfrytëzimit në sektorin publik tregon për një kërkesë të madhe për kujdes shëndetësor për pacientët në sektorin privat dhe në vendet fqinje duke përfshirë ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë, ku ata paguajnë me të holla të gatshme (kesh) në kohën e shfrytëzimit të shërbimit.

Është me rëndësi për të krijuar një proces efikas dhe llogaridhënës të menaxhimit financiar të Fondit të Sigurimit Shëndetësor, duke përfshirë kontabilitetin, raportimin dhe auditimin. Duhet të zbatohen standardet e kontabilitetit ndërkombëtar, me pak modifikime, nëse është e nevojshme. Një strategji efikase dhe krijimi i kapaciteteve në menaxhimin financiar duhet të jenë prioritete të larta që nga fillimi i fazës së implementimit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka nevojë për të zhvilluar një plan dhe kapacitete për të siguruar një sistem të besueshëm të auditimit për Fondin e Sigurimit Shëndetësor.

BURIMET FINANCIARE

Burimet duhet të jenë në dispozicion në pajtim me:

- BUXHETIN E KONSOLIDUAR TË KOSOVËS 2009 dhe
- KASH 2009-2011, Paragrafi 4.5.2 Sektori i Shëndetësisë

Financimi i projekteve të përfshira në KASH, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	Total 2009-11
Rinovimi i Objektivit të Pediatrisë – Prishtinë	0.4	0.0	0.0	0.4
Pajimet mjekësore dhe instalimi i sistemit qendror për gazrat mjekësore	0.3	0.0	0.0	0.3
Rinovimi i Institucioneve shëndetësore	2.2	0.5	0.3	3.0
Pajimet mjekësore për institucionet shëndetësore	5.8	3.2	2.6	11.6
Infrastruktura e institucioneve shëndetësore	3.1	2.3	1.2	6.6
Ndërtimi	0.0	4.4	7.7	12.1
Shërbimi Informativ Mjekësor (ang: HIS)	0.0	1.8	1.0	2.8
Projektet e tjera	0.0	0.9	1.0	1.9
Totali	11.7	13.2	13.8	38.7

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Si pikë fillestare, është nënvizuar se, në përgjithësi, ilaçet/barërat për personat me aftësi të kufizuara janë të njëjta si për të gjithë të tjerët. Personi me aftësi të kufizuara nuk është person i sëmurë i prekur nga një sëmundje përveçse nëse ai ose ajo sëmuret si rezultat i cilësdo sëmundje. Ekzistojnë disa aftësi të kufizuara të cilat kanë nevojë për trajtim të veçantë farmaceutik, furnizime apo mjete të veçanta.

Siç mund të shihet në matricën e shëndetësisë, objektivat kryesore për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara shansin e mirë të gëzojnë shërbimet më të mira shëndetësore, të arritura pas pjesëmarrjes së mirë në diskutime interesante, janë si më poshtë:

1. Kujdesi gjithëpërfshirës shëndetësor pa pagesë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

Aktiviteti 1.1.a, Përkufizimi i listës së ilaçeve esenciale për personat me aftësi të kufizuara;

Aktiviteti 1.1.b Kalkulimi i kostos së ilaçeve të domosdoshme mjekësore për personat me aftësi të kufizuara;

Aktiviteti 1.1.c Implementimi i listës së ilaçeve dhe furnizimeve mjekësore për persona me aftësi të kufizuara në kuadër të burimeve në dispozicion;

Aktiviteti 1.2.a Përkufizimi i shërbimeve plotësuese shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në pakon themelore të kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm deri te rehabilitimi);

Aktiviteti 1.2.b Kalkulimi i kostos së shërbimeve shëndetësore plotësuese për personat me aftësi të kufizuara që duhet të përfshihen në pakon themelore të kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm deri te rehabilitimi);

Aktiviteti 1.2.c Implementimi i shërbimeve shëndetësore plotësuese për personat me aftësi të kufizuara që duhet të përfshihet në pakon themelore të kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm deri te rehabilitimi) brenda burimeve në dispozicion;

Aktiviteti 1.3.a Përkufizimi i mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara;

Aktiviteti 1.3.b Kalkulimi i kostos së mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara;

Aktiviteti 1.3.c Sigurimi i mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara brenda burimeve në dispozicion;

Aktiviteti 1.4 Sigurimi i shërbimeve në shtëpi për personat e palëvizshëm;

Aktiviteti 1.5.a Përkufizimi dhe kalkulimi i kostos së projektit për operacion kurrizor (të shpinës) brenda Klinikës Ortopedike në Spitalin Universitar të Prishtinës dhe

Aktiviteti 1.5.b Themelimi i një njësie brenda Klinikës Ortopedike të Spitalit Universitar të Prishtinës brenda burimeve në dispozicion për investim kapital.

2. Përkufizimi i një programi kombëtar për qasjen profesionale të ofruesve të kujdesit shëndetësor ndaj personave me aftësi të kufizuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Aktiviteti 2.1 Përkufizimi i standardeve për qasjen profesionale të ofruesve të kujdesit shëndetësor ndaj personave me aftësi të kufizuara;

Aktiviteti 2.2 Trajnimi plotësues për nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 2.3 Shqyrtimi dhe ndryshimi, në pajtim me kornizën ligjore, lidhur me hospitalizimin e pavullnetshëm të personave me aftësi të kufizuara mendore, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

3. Përmirësimi i qasjes në infrastrukturën shëndetësore (shih, po ashtu, pjesën për Qasjen)

Aktiviteti 3.1 Identifikimi i problemeve të mungesës së qasjes;

Aktiviteti 3.2 Planifikimi i qasjes në infrastrukturën e objekteve të kujdesit shëndetësor në pajtim me problemet e identifikuar të mungesës së qasjes

Aktiviteti 3.3 Qasja ndaj objekteve në infrastrukturën e kujdesit shëndetësor në pajtim me problemet e identifikuar të mungesës së qasjes, në kuadër të burimeve në dispozicion për investime kapitale.

4. Përmirësimi i shërbimeve të rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara

Aktiviteti 4.1 Krijimi i një strategjie dhe mekanizmi legjislativ për të miratuar dhe zbatuar Shërbimet e Bazuar në Komunitetin, posaçërisht rehabilitimin;

Aktiviteti 4.2 Përkrahja e procedurave për licencim të ofruesve të shërbimit shëndetësor;

Aktiviteti 4.3 De-institucionalizimi dhe shqyrtimi i strategjisë ekzistuese mbi shëndetin mendor dhe përshtatja në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara mendore në institucionin e Shtimes;

Aktiviteti 4.4 Përkrahja e shfrytëzimit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit (KNF);

Aktiviteti 4.5 Rritja e bashkëpunimit midis palëve të interesuara.

5. Sigurimi i interpretuesit të gjuhës së shenjave në sistemin shëndetësor në nivel lokal dhe kombëtar

Aktiviteti 5.1 Krijimi i rrjetit të shërbimeve midis Asociacionit të Interpretuesve të Gjuhës së Shenjave dhe Sistemit të Shëndetit Publik

Aktiviteti 5.2 Trajnimi profesional i interpretuesve të gjuhës së shenjave në sektorin shëndetësor.

Në varësi nga objektivat dhe aktivitetet vijuese, janë rinjohur disa tregues të përmbushjes së detyrave. Për të garantuar një listë të ilaçeve esenciale dhe furnizime mjekësore për personat me aftësi të kufizuara është me rëndësi në fillim për të qenë të sigurt se lista është krijuar dhe është monitoruar nga Mjekët e Përgjithshëm, doktorët e specializuar dhe koalicioni i OJQ-ve, me qëllim të përkufizimit të tenderit për ilaçe dhe furnizime mjekësore dhe kontrollin se mjetet janë siguruar.

Kur kërkohet një program i trajnimit kombëtar, është procedurë themelore për të kontrolluar se ai është hartuar dhe miratuar. Po ashtu është theksuar se procedurat për të strehuarit (në spital) duhet të jenë de jure dhe de facto në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Gjatë procesit të monitorimit, rekomandimet pasuese duhet të raportohen në një deklaratë vjetore për t'u diskutuar nga palët relevante të interesuara.

Hartimi i procedurave për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve besohet të jetë i rëndësishëm me qëllim që të sigurohet mbështetja e sektorëve të ekspertëve si këshilltarë në disa degë të Qeverisë.

SHËNDETËSIA

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Kujdesi i gjithmbarshëm pa pagesë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	1.1.a Përkufizimi i listës esenciale të ilaçeve që janë të domosdoshme për personat me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Agjencioni për Mjekësi i Kosovës, Departamenti i Farmaceutikës, Komisioni i Agjencisë së Kujdesit Shëndetësor OJQ-të dhe OPAK.	Lista e ilaçeve esenciale përfshin barërat për personat me aftësi të kufizuara.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK 2009 (Linja buxhetore e ilaçeve KASH (Objektivi I.3, III.1.b)
	1.1.b Kalkulimi i kostos së ilaçeve të domosdoshme esenciale për personat me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Agjencioni për Mjekësi i Kosovës, Departamenti i Farmaceutikës, Komisioni i Agjencisë së Kujdesit Shëndetësor, OJQ-të dhe OPAK.	Shpenzimet janë të përkufizuara.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH 1.1.a + 1.1.b = 5.000 Euro**
	1.1.c Implementimi i listës së ilaçeve dhe i pajimeve mjekësore për personat me aftësi të kufizuara brenda burimeve në dispozicion.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Agjencioni për Mjekësi i Kosovës, Departamenti i Farmaceutikës, Komisioni i Agjencisë së Kujdesit Shëndetësor, OJQ-të dhe OPAK.	Personat me aftësi të kufizuara marrin ilaçet nga lista esenciale.	2011	KASH 1,5 milion Euro
	1.2.a Përkufizimi i shërbimeve plotësuese shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara që duhet të futen në pakon e kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm e deri te rehabilitimi).	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Spitali i Prishtinës (Njësia për Rehabilitim fizik), OJQ-të dhe OPAK.	Numri i shërbimeve shëndetësore të përfshira në pakon themelore për persona me aftësi të kufizuara.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH (Obj. I.3, III.1.b) 1.2.a + 1.2.b = 5.000 Euro**

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
...Objektivi I vazhdon	1.2.b Kalkulimi i kostos së shërbimeve plotësuese shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara që duhet të futen në pakon e kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm e deri te rehabilitimi).	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Spitali i Prishtinës (Njësia për Rehabilitimin fizik), OJQ-të dhe OPAK.	Shpenzimet janë të përkufizuara.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (Objektivi. I.3, III.1.b) 1.2.a + 1.2.b = 5.000 Euro **
	1.2.c Implementimi i shërbimeve plotësuese shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara që duhet të futen në pakon e kujdesit shëndetësor (nga diagnostikimi i hershëm e deri te rehabilitimi) nga burimet në dispozicion.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Spitali i Prishtinës (Njësia për Rehabilitimin fizik), OJQ-të dhe OPAK.	Pajimet janë të siguruara.	2011	KASH Shpenzimet duhet të përkufizohen
	1.3.a Përkufizimi i mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, Agjencioni për Mjekësi i Kosovës, Departamenti i farmaceutikës, OJQ-të dhe OPAK.	Lista e krijuar e pajimeve ndihmëse.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK KASH (Obj. I.2.b)
	1.3.b Kalkulimi i kostos së mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, Agjencioni për mjekësi i Kosovës, Departamenti i farmaceutikës, OJQ-të dhe OPAK	Shpenzimet janë të përkufizuara.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (Obj. I.2.b) 1.3.a + 1.3.b = 5.000 Euro **
	1.3.c Sigurimi i mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara nga burimet në dispozicion.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, Agjencioni për Mjekësi i Kosovës, Departamenti i farmaceutikës, OJQ-të dhe OPAK.	Një numër i siguar i mjeteve ndihmëse.	2011	KASH 500.000 Euro
	1.4 Sigurimi i shërbimeve në shtëpi për personat e palëvizshëm.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Instituti i Shëndetit Publik, Ofruesit e Licencuar Privatë të kujdesit shëndetësor, OJQ-të dhe OPAK.	Numri i siguar i shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara pa mundësi lëvizjeje.	2009	BKK KASH (Obj. I.2.b) 100.000 Euro
Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

...Objektivi I vazhdon	1.5.a Përkufizimi dhe kalkulimi i kostos së projektit për intervenime kirurgjike kurrizore (të shpinës) brenda Klinikës Ortopedike në Spitalin Universitar të Prishtinës.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut) Departamenti për Buxhet dhe Financa, Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore, Qendra Klinike Universitare.	Projekti i dorëzuar brenda procesit të buxhetit të vitit 2010.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK KASH (Obj. I.1.a) 5.000 Euro **
	1.5.b Krijimi i një Njësie brenda Klinikës Ortopedike në Spitalin Universitar të Prishtinës brenda burimeve ekzistuese në dispozicion për investim kapital.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut) Departamenti për Buxhet dhe Financa, Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore, Qendra Klinike Universitare, OJQ-të dhe OPAK.	Njësia funksionale për trajtime kurrizore.	2011	KASH 25.000 Euro
2. Hartimi i programit kombëtar për qasjen profesionale të ofruesve të shërbimeve mjekësore ndaj personave me aftësi të kufizuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.	2.1 Përkufizimi i standardeve për qasje profesionale të ofruesve të kujdesit shëndetësor ndaj personave me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Divizioni i Kualitetit të Kujdesit Shëndetësor, MASHT, OJQ-të dhe OPAK.	Harta e lëshuar shërbimeve.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (Obj. I.5) 4.000 Euro **
	2.2 Trajnimi plotësues mbi nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Divizioni i Kualitetit të Kujdesit Shëndetësor, MASHT, OJQ-të dhe OPAK.	Kurset e mbajtura të trajnimit.	2010	KASH (Objektivi I.5) 10.000 Euro **
	2.3 Shqyrtimi dhe ndryshimi në pajtim me kornizën ligjore lidhur me hospitalizimin e pavullnetshëm të personave me aftësi të kufizuara mendore në pajtim me standardet ndërkombëtarisht të pranuar.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), ZKM/ZQM, Kuvendi	Procedurat e hospitalizimit janë de jure dhe de facto në përputhje me standardet ndërkombëtare.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5.000 Euro **

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
3. Përmirësimi i qasjes ndaj infrastrukturës shëndetësore (shih po ashtu pjesën për Qasjen).	3.1 Identifikimi i problemit të mungesës së qasjes.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore, MAPH, OJQ-të dhe OPAK.	Lista e identifikuar problemeve të lidhura me mungesën e qasjes.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH (Obj. IV. 1b) Pa shpenzime
	3.2 Planifikimi i qasjes në infrastrukturën e objekteve të kujdesit shëndetësor sipas problemeve të identifikuara të mungesës së qasjes.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MAPH, OJQ-të dhe OPAK.	Projektet e hartuara për qasje në ndërtesat e kujdesit shëndetësor.	2010	KASH (Obj. IV. 1. b) 45.000 Euro
	3.3 Qasja në infrastrukturën e objekteve të kujdesit shëndetësor sipas problemeve të identifikuara të mungesës së qasjes, brenda burimeve në dispozicion për investime kapitale.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MAPH, OJQ-të dhe OPAK.	Numri i siguruar i qasjes.	2011	KASH 100.000 Euro
4. Përmirësimi i shërbimeve të riaftësimi për personat me aftësi të kufizuara.	4.1 Krijimi i një strategjie dhe mekanizmi legjislativ për të miratuar dhe implementuar Shërbimet e Bazuara në Bashkësi, posaçërisht rehabilitimi.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, MASHT, ZKM/ZQM, Kuvendi, OJQ-të dhe OPAK.	Projekti mbi strategjinë dhe aktin.	2009	BKK-KASH (Obj. I.5) 15.000 Euro **
	4.2 Përkrahja e procedurave të licencimit të ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, OJQ-të dhe OPAK.	Numri i procedurave të hartuara për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve.	Vazhdimisht	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (Objektivi I.5) Pa shpenzime
	4.3 De-institucionalizimi dhe shqyrtimi i strategjisë ekzistuese mbi shëndetin mendor dhe përshtatja e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara mendore në institucionin e Shtimes.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), MPMS, MASHT, ZKM/ZQM, Kuvendi, OJQ-të dhe OPAK.	De-institucionalizimi i Qendrës Integruese të Shtimes.	2010	KASH 15.000 Euro
	4.4 Përkrahja e shfrytëzimit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit (KNF).	4.4 MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Shoqata e Mjekëve, OJQ-të dhe OPAK.	Seminaret e mbajtura.	2011	KASH (Obj. I.5) 20.000 Euro **

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

	4.5 Rritja e bashkëpunimit mes palëve të interesuara.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Shoqata e Mjekëve, OJQ-të dhe OPAK.	Takimet dhe seminarët e mbajtura.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 3.000 Euro
--	---	--	-----------------------------------	------	--

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
5. Vënia në dispozicion të përhershëm e interpretuesit të gjuhës së shenjave në sistemin shëndetësor në nivel lokal dhe kombëtar.	5.1 Krijimi i një rrjeti të shërbimeve midis Asociacionit të interpretuesve të gjuhës së shenjave dhe Sistemit të shëndetit publik.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore, OJQ-të dhe OPAK.	Sigurimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave për shërbimet shëndetësore.	2010	KASH (Obj. I.5) 100.000 Euro
	5.2 Trajnimi profesional i interpretuesve të gjuhës së shenjave në sektorin shëndetësor.	MSH (Njësia për të Drejtat e Njeriut), OJQ-të dhe OPAK.	Numri i mjaftueshëm i interpretuesve të trajnuar të gjuhës së shenjave.	2009	KASH (Obj. I.5) 10.000 Euro

**

Kërkoheh ndihma teknike

Shkurtesat

MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
ZKM	Zyra e Kryeministrit
NJDNJ	Njësia për të Drejta të Njeriut
OJQ-të	Organizatave Joqeveritare
OPAK	Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Shëndetit dhe Aftësive të Kufizuara
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2011
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

6.3 ARSIMI

KONTEKSTI POLITIK DHE LEGJISLATIV

Ligji kundër diskriminimit nr.2004/3, në nenin 1, pohon: “Qëllimi i këtij Ligji është parandalimi dhe lufta kundër diskriminimit, kultivimi i barazisë efikase dhe vënia në fuqi e parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Republikës së Kosovës në pajtim me sundimin e Ligjit”⁸. Së këndejmi, në fushën e arsimit, ai e synon ndërtimin e një modeli të edukimit në të cilin kanë qasje të gjithë.

Në pajtim me këtë synim, e drejta e të gjithë fëmijëve për arsimim në mënyrë të qartë dëshmohet në ligjin mbi arsimin parashkollor dhe atë të obligueshëm, atë të nivelit 1 dhe 2 (Ligji nr. 02/L-52).

Neni 6 i Ligjit Parashkollor thotë: “Arsimi parashkollor është e drejtë e të gjithë fëmijëve duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, që do të realizohet në pajtim me këtë Ligj dhe aktet nënligjore”.

Në pajtim me këtë Ligj, fëmijë me nevoja të veçanta përfshihen fëmijët me dëmtime mendore, fëmijët e verbër, fëmijët me dëmtime vizuale (pamore), fëmijët me dëmtime motorike, dhe fëmijët me vështirësi emocionale dhe intelektuale, fëmijët me dëmtime të kombinuara, ose fëmijët e tjerë në rrezik të të qenit në një situatë të pafavorshme arsimore, në nevojë për këshilla ose udhëzime të veçanta me ndihmën plotësuese profesionale ose programeve speciale.”⁹

Pos kësaj Neni 10 – i kushtuar “planeve dhe programeve” shkollore – saktëson se programi i arsimit vjetor lidhur me mbrojtjen arsimore, shëndetësore dhe sociale duhet të realizohet përmes marrëveshjes reciproke me prindërit dhe me fëmijët.¹⁰

Ngaqë arsimimi parashkollor nuk është i obligueshëm, pagesa e mjeteve kërkohet qoftë nga familja qoftë nga komuna dhe i njëjti ligj përcakton kriteret për trajtimin e situatave të familjeve të cilat kanë vështirësi në pagesën e mjeteve të tilla, duke siguruar subvencione nga komuna e cila vendos mbi pagesat, shpenzimet, dhe asistencën e lejuar.¹¹

Lidhur me shkollën fillore të obligueshme, referencë është ligji nr.2002/2 “Mbi arsimin fillor dhe të mesëm”, i hyrë në fuqi më 31 tetor, 2002, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2002/19. Pjesa e saj e tretë, neni 1 “E drejta për arsimim”, afirmon nevojën për një sistem të arsimit të obligueshëm i cili përfshin shkollat fillore dhe të mesme në të cilat të gjithë duhet të kenë qasje. Ai më tej vazhdon të afirmojë se asnjë fëmije nuk duhet t’i mohohet e drejta në arsimim.

Kapitulli 7 i Ligjit mbi Shkollimin e Obligueshëm i kushtohet arsimimit special. Aktualisht ekzistojnë shtatë shkolla speciale në disa komuna. Pos këtyre shkollave, ekzistojnë klasë, të cilat vijohen vetëm nga fëmijët me aftësi të kufizuara, të vendosura në shkollat e zakonshme, që quhen “klasat e bashkëngjitura”. Kapitulli 7 po ashtu përmban dispozita lidhur me bashkëpunimin me komunat mbi këshillimet me ekspertët në sektorin e shëndetësisë.¹² Ekziston një mjet i preferuar për planifikimin shkollor¹³ i cili duhet të realizohet brenda shkollave në bashkëpunim me familjen.

Proceset e integritimit janë në rrugë e sipër, shpresohet se përvoja e tyre do të çoj tek praktikat e mira të gjithëpërfshirjes të inkuorpuara në ligjet e ardhshme.

Është e domosdoshme për të theksuar një aspekt tjetër të sistemit të tashëm të arsimit në Republikën e Kosovës: siç është raportuar në dokumentin “Strategjia dhe plani i veprimit mbi të drejtat e njeriut në

⁸ Ligji kundër diskriminimit, nr. 2004/3 Kuvendi i Kosovës

⁹ (Sugjerim: Ky indikacion relativ për disa lloje të aftësive të kufizuara, edhe pse shumë i gjerë, mund të keqinterpretohet kur problemet e fëmijëve nuk janë të qarta ose nuk janë diagnostikuar apo shfaqur gjatë shkollimit. Në të ardhmen, mundësia e qasjes ndaj shkollës për të gjithë fëmijët mund të tregohet në çdo situatë dhe gjendje ose kërkesë shëndetësore.)

¹⁰ “Ligji mbi arsimin parashkollor”, neni 10.4 “Plani dhe Programi”

¹¹ “Ligji mbi arsimin parashkollor”, neni 24, Vendosija e tarifave të pagesave nga prindërit”. Është e këshillueshme një lidhje me Ministrinë e Mirëqenies dhe atë të Shëndetësisë, posaçërisht për fëmijët me nevoja të veçanta shëndetësore.

¹² Po aty., paragrafi 39

¹³ Seksioni 38, “përmbytja e pagesës për shkollim: 38.1 “Plane individuale për shkollim duhet të përgatiten për nxënësit që ndjekin arsimimin special. Këto plane duhet të qartësojnë objektivat dhe përmbytjen arsimore si dhe të tregojnë se si të kryhet pagesa për shkollim.” 38.2 “për çdo semestër, mësuesi i klasës përgatit një përmbledhje me shkrim të pagesës së pranuar nga një nxënës që ndjek arsimim special dhe vlerësimin për zhvillimin e nxënësit. Drejtori e dërgon këtë përmbledhje dhe këtë vlerësim dhe vrojtimet e tij/saj te prindi/prindërit e nxënësit.”

Republikën e Kosovës 2009 - 2011” të publikuar në janar të vitit 2009 nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit , “ Sfidë më e madhe e sistemit të arsimit në Republikën e Kosovës, shikuar nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, pa dyshim është ekzistimi i dy sistemeve të veçanta të arsimit, njëri nën administrimin dhe financimin e Qeverisë së Kosovës dhe sistemi tjetër paralel serb.”¹⁴

TË DHËNA

Mbi arsimin ekziston vetëm një përmbledhje e të dhënave administrative, të cilat nuk i janë nënshtruar përgatitjes statistikore.¹⁵

Ekzistojnë 7 shkolla speciale që funksionojnë në Republikën e Kosovës, të vendosura në rajone të ndryshme (për një përshkrim të hollësishëm të Shkollave Speciale shih Aneksin 1).

Krahas shkollave speciale, ekzistojnë po ashtu edhe të ashtuquajturat “klasat e bashkëngjitura speciale” të rezervuara vetëm për nxënësit me nevoja të veçanta dhe këto janë të vendosura brenda shkollave të rregullta në të njëjtën ndërtesë shkollore. Këto nuk duhet të përzihen me klasat e përkufizuara si “paralele” që thjesht janë disa pjesë të së njëjtës klasë. Po ashtu ekzistojnë situata të klasave të kombinuara (grupet e fëmijëve të cilët vijojnë klasë të ndryshme nga klasa I-IX), por nuk ekziston një numër i saktë i tyre (Lidhur me hollësitë mbi klasat speciale të bashkëngjitura, shih Aneksin 2).

Shkollat e mesme që nga viti 2002/2003 janë organizuar në nivel më të ulët të shkollimit të përgjithshëm për nxënësit e moshës prej 15 deri 19 dhe në nivel më të lartë të shkollimit për nxënësit me moshën prej 19 deri 24- (niveli 1 i studimeve).

Disa nxënës me aftësi të kufizuara vijojnë mësimin në shkollat e rregullta me orar të plotë, por numri i tyre i saktë nuk dihet.

BURIMET FINANCIARE

Burimet e zbrërthyer në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) në lidhje me sektorin e Arsimit janë të treguara më poshtë me referencë në buxhetin publik dhe intervenimet e financuara nga donatorët privatë.¹⁶

Financimi i projekteve i përfshirë në KASH, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	Totali 2009-2011
Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore (për vijim të kryesisht në dy ndërrime)	18.3	18.3	14.5	51.2
Riparimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	3.6	5.1	6.1	14.8
Krijimi dhe furnizimi me pajisje të duhura i qendra kompjuterëve	2.2	2.2	2.2	6.5
Pajisja e objekteve shkollore me laborator dhe pajime të tjera laboratorike	2.4	2.6	4.1	9.0
Shpërndarja falas e teksteve shkollore për nivelin fillor dhe për familjet e varfra	2.5	2.5	2.5	7.5
Përshkrimi	0.3	0.5	0.7	1.5
Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore (për vijim të mësimin kryesisht në dy ndërrime)	0.4	0.3	0.3	1.0
Riparimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	5.2	5.5	9.5	20.2

¹⁴ “Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi të drejtat e njeriut i Republikës së Kosovës dhe plani i veprimit mbi të drejtat e njeriut i Republikës së Kosovës, 2009-2011” botuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, janar, Kosovë, f. 32

¹⁶ “Të dhënat statistikore mbi arsimin në Kosovë 2007/2008” botuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Sistemi Informativ për Menaxhimin e Arsimit, Prishtinë, shkurt 2008. “Të dhëna statistikore mbi arsimin në Kosovë” është botim vjetor i lëshuar nga Njësia EMIS / MASHT që paraqet shkurtimisht shumë të dhëna statistikore të nivelit shkollor, komunal dhe rajonal. “Të gjitha të dhënat dhe treguesit e lëshuar në këtë botim janë të krahasueshme me të dhënat dhe treguesit e vendeve të tjera në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED-97)⁸, miratuar nga konferenca gjithëpërfshirëse UNESCO-s (nga parathënia f 3)

¹⁷ Nga KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2009-2011 (KASH) f. 79

Ndërtimi i objekteve të reja universitare dhe riaktivizimi i atyre ekzistuese	0.2	0.1	0.1	0.3
Totali	35.0	37	40.0	112.00

Projektet për financim nga donatorët (1), në miliona euro (po aty)

Përshkrimi	2009
Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore (për vijim të mësimit kryesisht në dy ndërrime)	1.0
Riparimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	1.0
Ndërtimi i objekteve të reja universitare dhe riaktivizimi i atyre ekzistuese	1.0
Totali	3.0

Projektet për financim nga donatorët dhe të tjerët (2), në miliona euro (po aty)

Përshkrimi	2009	2010	2011	Total 2009-2011
Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore (për vijim të mësimit kryesisht në dy ndërrime)	2.6	2.0	1.5	6.1
Riparimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	1.3	0.9	0.8	3.0
Ndërtimi i objekteve të reja universitare	0.2	0.4	0.3	0.8
Pajisje të TI-së	0.0	0.0	0.0	0.0
Modernizimi i rrjetit bibliotekar	0.0	0.4	0.5	0.9
Ndërtimi i objekteve të reja universitare dhe riaktivizimi i atyre ekzistuese	0.1	0.3	0.1	0.5
Totali	4.7	4.7	4.7	14.2

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Puna e bërë brenda kornizës së grupit punues “Arsimi” e ka bërë të mundshme për të dalluar pesë (5) objektiva kryesore të cilat janë jashtëzakonisht të çmueshme për përkrahjen e reformës së vërtetë në sistemin përfshirës të arsimit në pajtim me nenin 24 të “Konventës së KB”. Për strategjinë e bashkëpunimit u arrit pëlqimi me të filluar të punës së Ekipit të Grupit Punues (EGP) dhe pas këshillimeve në nivel komunal të realizuara në janar të vitit 2009, Ekipi i Grupit Punues ka zgjeruar veprimet nga 3 sa ishin në versionin e parë në pesë të fundit në draftin e fundit. Duke konfirmuar atë se çfarë është krijuar më herët, EGP ka pranuar dy objektiva dhe veprime të tjera të ndërlidhura. Së këndejmi, objektivat 3 dhe 5 i janë shtuar matricës. E para, një vëmendje e veçantë i është kushtuar arsimit parashkollor nëpër të gjitha objektivat, për përmirësim të arsimit të hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. E dyta, ka qenë me rëndësi për të përkufizuar rolin e komunave me qëllim të realizimit të projekteve të përfshirjes në bashkësi, jo vetëm për të përmirësuar qasjen në shkollim, por po ashtu, edhe për të lidhur njerëzit të cilët punojnë së bashku në nivel institucional, arsimor dhe social.

Për të gjitha këto objektiva tashmë janë ndarë fonde sipas një dispozite të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.¹⁰

Objektivat kryesore lidhur me arsimin janë:

1. Krijimi i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit;
2. Zbatimi i legjislacionit në fushën e arsimimit për personat me aftësi të kufizuara;
3. Garantimi i një sistemi përfshirës të arsimit në institucionet parashkollore;
4. Programet profesionale të zhvillimit mbi arsimin gjithëpërfshirës për arsimtarët dhe kuadrin e përfshirë në sistemin arsimor dhe
5. Përmirësimi i fuqisë ligjore për personat me aftësi të kufizuara në nivel komunal.

1. Krijimi i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit

Aktiviteti 1.1 Konvertimi gradual i shkollave speciale dhe e klasave të bashkëngjitura në qendra burimore.

Para vitit 1999 fëmijët me aftësi të kufizuara kanë qenë të vendosur në një numër të vogël të shkollave speciale ose nuk kanë qenë në gjendje të vijnë shkollimin. Objektivi për të krijuar mundësi për gjithëpërfshirje fillon nga mundësia reale për të krijuar gradualisht një sistem të ri. E gjithë ekspertiza e shkollave të vjetra speciale mund të jetë e dobishme për të ndërtuar një mënyrë të re të përfshirjes në rrjedhën e përgjithshme të sistemit të arsimit. Së këndejmi, ky aktivitet duhet të “konvertojë” shkollat speciale në qendra burimore, për arsye se do të jetë e nevojshme që ekspertizat e vjetra dhe të reja t’u përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Vetëdija për këtë perspektivë është e mirënjohur nga përfaqësuesit institucionalë, shoqatat e prindërve, shoqatat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, siç është thënë në ekipin e Grupit Punues (EGP) të arsimit.

Aktiviteti 1.2 Sigurimi i pajisjeve ndihmëse, materialeve arsimore, interpretuesve të gjuhës së shenjave në qendrat e ndihmës

Vënia në dispozicion e institucioneve shkollore për nxënësit me aftësi të kufizuara është kusht parësor për zbatimin e mësimin të arsimit gjithëpërfshirës. Megjithatë, duhet të përcaktohen masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen e plotë të nxënësve me aftësi të kufizuara në mësimin e rregullt me anë të metodave adekuate, formave dhe sistemeve të përmirësuara dhe alternative të komunikimit, materialeve të duhura teknike dhe arsimore për personat me aftësi të kufizuara. “Modeli social” i aftësive të kufizuara argumenton se arsyeja e pamundësisë së personit me aftësi të kufizuara për të gëzuar pjesëmarrje të barabartë në shkolla nuk është gjendja shëndetësore ose dëmtimi i individëve të caktuar, por më parë është paaftësia e shoqërisë për t’u ballafaquar me nevojat e tyre të ndryshme të jetesës.

Aktiviteti 1.3 Eliminimi i pengesave në ndërtesat ekzistuese arsimore.

Sigurimi i mundësive të barabartë do të thotë shkolla pa pengesa “arkitekturale” dhe, me qëllim të arritjes së objektivit kryesor, do të jetë e domosdoshme për të modifikuar, sa më mirë që të jetë e mundur, objektet ekzistuese shkollore në pajtim me standardet ndërkombëtare të qasjes.

Aktiviteti 1.4 Ndërtimi i shkollave të reja dhe i institucioneve të reja parashkollore në pajtim me standardet ndërkombëtare të qasjes.

Në KASH ekziston dispozita e hapësirës shtesë fizike, siç është “ndërtimi i hapësirës shkollore, me qëllim që të gjitha shkollat të punojnë vetëm në dy ndërrime në fund të vitit 2011”¹¹. Në të vërtetë, ekziston një mungesë e objekteve arsimore. Kur merren parasysh nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, do të jetë e domosdoshme për të planifikuar ndërtimin e objekteve të reja në pajtim me standardet ndërkombëtare të qasjes.

Aktiviteti 1.5 Sigurimi i arsimtarëve që udhëtojnë për fëmijë me aftësi të kufizuara që jetojnë në zona më të pafavorshme për shkak të largësisë së madhe, qasjes thuajse të pamundshme, për shkat të aftësivëtë kufizuara serioze.

Duke marrë parasysh problemet sociale lidhur me komunitetin në zonat rurale dhe të largëta, është diskutuar mundësia e “arsimtarëve udhëtues” me qëllim të arsimit të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara aty ku ata jetojnë. Po ashtu do të ishte strategji e mirë për të identifikuar dhe për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara që nuk janë të regjistruar si dhe familjet e tyre.

2. Zbatimi i legjislacionit në fushën e arsimit për personat me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 2.1 Miratimi i ligjit mbi sistemin gjithëpërfshirës të arsimit.

Promovimi i një projektligji i cili do të zbatonte praktikat gjithëpërfshirëse për të udhëzuar institucionet shkollore në nivel qendror dhe lokal. Pas kësaj, do të jetë e domosdoshme për të pasur instrumente për të siguruar të kuptuarit, vetëdijesimin mbi ligjin për të realizuar atë në jetën e përditshme. Në këtë mënyrë, veprimet për të cilat është arritur pajtimi duhet të jenë konkrete dhe në

gjendje për të arritur te secili individ, familje, person me aftësi të kufizuara, arsimtar dhe të gjithë personat e përfshirë në jetën sociale. Këto do të jenë “aktivitete me shpenzime të ulëta”, por me një shpërndarje të madhe të njohurive të larta dhe sugjerimeve konkrete për të realizuar një bashkësi gjithëpërfshirëse.

Aktiviteti 2.2 Hartimi i legjislacionit mbi gjuhën e shenjave.

Me qëllim që reforma e ligjit mbi personat me aftësi të kufizuara të bëhet e qasshme, për të garantuar pjesëmarrjen e njerëzve të shurdhër do të jetë e domosdoshme për të pasur dokumente të përkthyer në gjuhën e shenjave. Do të ishte po ashtu e dobishme të promovohen takime e debate për të angazhuar secilin individ në procesin social të gjithëpërfshirjes në nivel komunal.

Aktiviteti 2.3 Botimi i një udhëzuesi mbi arsimin gjithëpërfshirës.

Për të studiuar të gjitha aspektet e lidhura (qëndrimet legjislative, administrative, sociale dhe kulturore), ekziston nevoja për të lidhur sektorin e arsimit me sistemin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara. (transporti, pajisja me materiale të veçanta arsimore dhe ndihmë). Udhëzuesi do të ishte i dobishëm për të gjithë njerëzit me qëllim që ata të dinë se si dhe sa mundësi janë adaptuar për të përmirësuar dhe garantuar arsimin gjithëpërfshirës, nga pikëpamja ligjore, administrative dhe sociale.

Aktiviteti 2.4 Botimi i një doracaku të zhvillimit të Planit të Individualizuar Arsimor (PIA).

Është e mirënjohur rëndësia e Planit të Individualizuar Arsimor (PIA) si një instrument i dobishëm për zhvillimin e personalitetit të personave me aftësi të kufizuara, të talentit dhe kreativitetit, si dhe shkathtësive fizike e mendore deri në maksimumin e mundësive të tyre. Ky plan do të karakterizohet nga disa objektiva të përgjithshme, të përbashkëta për secilin fëmijë, dhe disa objektiva të veçanta, të cilat janë të përzgjedhura nga arsimtarët, sipas mendimit të prindërve, për të promovuar arsimimin individual. Duke marrë parasysh vështirësitë e fëmijës, do të jetë e nevojshme për të planifikuar një program të aktiviteteve për nxënie, arsimim, për ndihmë për fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrën më të mirë. Doracaku/ udhëzuesi për zhvillim të Planit të Individualizuar Arsimor (PIA) do të ishte instrument i mirë pedagogjik për arsimtarët, prindërit dhe operatorët socialë, për të zhvilluar një gjuhë të përbashkët, për këmbim të përvojave si dhe për përdorim të metodave moderne nga secili individ.

3. Garantimi i sistemit gjithëpërfshirës të arsimit në institucionet parashkollore.

Aktiviteti 3.1 Botimi i doracakëve dhe i udhëzuesve mbi aftësitë e kufizuara dhe zhvillimin fëmijëror.

Përmes përmirësimit të njohurive lidhur me marrëdhënien midis zhvillimit fëmijëror dhe aftësive të kufizuara do të ishte e mundshme për të zvogëluar ndikimin e rëndë të aftësive të kufizuara në jetën e secilit fëmijë dhe të familjes së tij. Pos kësaj, do të ishte e mundshme për të zvogëluar pasojat negative të aftësive të kufizuara të nënvleftësuar në fëmijëri. Botimi i doracakëve dhe i udhëzuesve mbi aftësitë e kufizuara dhe zhvillimin fëmijëror është i rëndësishëm për të përmirësuar njohuritë mbi zhvillimin e fëmijëve dhe për të identifikuar nevojat dhe aftësitë e secilit fëmijë të përfshirë në procesin e arsimimit. Vështuar nga pikëpamja pedagogjike, kjo do të thotë të gjenden arsimtarë të aftë për të hetuar jo vetëm vështirësitë, por edhe aftësitë e nxënësve, aftësitë të cilat si rezultat i arsimimit mund të bëhen kapacitete.

Aktiviteti 3.2 Garantimi i shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore parashkollore gjithëpërfshirëse.

Falë bashkëpunimit me OJQ-të, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) dhe shoqatave të prindërve, në Republikën e Kosovës ekzistojnë përvoja të llojeve të ndryshme të shërbimeve mbështetëse. Këto aktivitete, të cilat kanë filluar vitet e fundit duhet vazhduar patjetër nën drejtimin e komunave, të cilat në të ardhmen janë të obliguara për të siguruar shërbimet e këshillimit arsimor dhe psikologjik dhe për të punësuar ekspertë për vlerësim të nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar udhëzime mbi adaptimin e pagesave të tyre të shkollimit.

Aktiviteti 3.3 Krijimi i marrëveshjeve midis Qendrave me Bazë në Bashkësi (QBB) dhe institucioneve parashkollore.

Ky aktivitet është shumë i rëndësishëm për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës të komunitetit mes shumë aktorëve (institucioneve parashkollore, Qendrave me Bazë në Bashkësi, qendrave të ndihmës dhe Departamenteve Komunale të Arsimit) dhe orientimin e tyre për t'u kujdesur për arsimimin e hershëm, duke i lidhur ata të gjithë me objektivat dhe strategjitë me qëllim të promovimit të arsimit efikas.

Përvojat e QBB, të promovuara në pjesën më të madhe të Kosovës, janë një burim i nevojshëm me qëllim të zbulimit dhe të sigurimit të secilit lloj të ndihmës për personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, në nivel të bashkësisë, është me rëndësi të krijohet një rrjet i komunikimit të saktë mes arsimtarëve, prindërve dhe personave me aftësi të kufizuara për të arritur deri te secili, ngaqë rehabilitimi i bazuar në bashkësi varet nga aftësia për të lëvizur. Ngritja e vetëdijes për përfitimet e rehabilitimit të bazuar në bashkësi është prioritet kyç.

Ndërtimi i një rrjeti të integruar të shërbimeve sociale, po ashtu mund të përforcojë efikasitetin e intervenimit në arsim.

Aktiviteti 3.4 Zbatimi i Planit Individual të Arsimit (PIA) për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

PIA përfaqëson një mënyrë të arsimit për të konkretizuar idenë e përfshirjes së plotë të nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit dhe në jetën sociale. Është një program (zgjedhje e ideve, veprimeve) qëllimisht i orientuar kah përmirësimi i arsimit për secilin fëmijë duke marrë parasysh nevojat e përgjithshme të tyre, të drejtat dhe burimet e zhvillimit. Është, po ashtu, i rëndësishëm ngaqë shfrytëzohet së bashku me prindërit, arsimtarët dhe të gjithë aktorët social të sistemit përfshirës social. Aksioni i "lidhjes së njerëzve" të komunitetit rreth të njëjtës tryezë të fëmijës me PIA është mënyra më e mirë për të zbuluar pengesat dhe burimet për t'ju qasur problemeve sa të jetë e mundur më herët.

Aktiviteti 3.5 Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët vijnë në institucionet parashkollore

Nuk dihet numri i fëmijëve të cilët vijnë në institucionet parashkollore, por është e mundur për të nxjerrë përfundimin se, duke marrë parasysh numrin e nxënësve në nivelin fillor të arsimit, një numër i madh i fëmijëve janë duke pritur për institucione parashkollore. Arsimimi fëmijëror është prioritet në strategjinë gjithëpërfshirëse dhe, së këndejmi, rritja e numrit të fëmijëve të përfshirë në arsimin parashkollor do të jetë një shenjë konkrete e një kualiteti të mirë të jetës për vetë ata dhe për familjet e tyre.

4 Programet e zhvillimit profesional mbi arsimin gjithëpërfshirës për arsimtarët dhe njerëzit e inkuadruar në sistemin arsimor

Aktiviteti 4.1 Zhvillimi i programeve të trajnimit për arsimtarët në të gjitha nivelet e edukimit

Trajnimi i arsimtarëve duhet të jetë një kusht përmes trajnimeve të reja gjithëpërfshirëse dhe kurseve arsimore. Kjo duhet të vlejë për arsimtarët e rinj dhe për arsimtarët të cilët tashmë kanë përvojë në sistemin e nevojshëm të vijimit të shkollave publike, por të cilët nuk kanë qenë të trajnuar në çështjet që kanë të bëjnë me arsimin për persona me aftësi të kufizuara dhe atë të specializuar. Trajnimi mund të jetë teorik dhe praktik dhe mund të vlerësojë përvojën e arsimtarëve të cilët kohë pas kohe janë të ngarkuar me nxënës me aftësi të kufizuara, mund të nxisë këmbimet e përvojave dhe shpërndarjen e materialeve dhe të praktikave të mira.

Aktiviteti 4.2 Zhvillimi i programeve të trajnimit për arsimtarët, asistentët, vullnetarët, edukatorët, prindërit dhe personelin e OJQ-ve në të gjitha nivelet e arsimit.

Për të përmirësuar sistemin gjithëpërfshirës është po ashtu e domosdoshme paralelisht për të kultivuar vetëdijen dhe njohuritë e të gjithë njerëzve të cilët punojnë me personat me aftësi të kufizuara. Së këndejmi, është e domosdoshme të kemi më shumë kapacitete profesionale dhe njerëzore për të gjithë njerëzit e angazhuar në marrëdhëniet me personat me aftësi të kufizuara. Më shumë njohuri për të gjithë do të thotë më shumë përfshirje për të gjithë.

5. Përmirësimi i kompetencës mbi aftësitë e kufizuara në nivel komunal

Në të ardhmen e afërt, shikuar nga pikëpamja administrative, një pjesë e madhe e kompetencave lidhur me shërbimet sociale dhe të sistemit të arsimit janë të lidhura me organizimin e ri të komunave. Për të favorizuar këtë proces të rëndësishëm të decentralizimit, të gjitha kompetencat të cilat formalisht janë të lidhura me dimensionin komunal duhet të qartësohen dhe të garantohen. Së këndejmi, është e domosdoshme që udhëzimet e reja komunale të realizojnë përfshirjen e plotë. Për të realizuar këtë objektiv, janë vendosur tri aktivitetet:

Aktiviteti 5.1 Punësimi i një zyrtari / eksperti për arsimin gjithëpërfshirës në secilën komunë

Punësimi i një zyrtari / eksperti për arsimin gjithëpërfshirës në secilën komunë, inkurajimi i krijimit të rrjeteve mes të gjithë aktorëve të modelit gjithëpërfshirës, garantimi i kompetencave të larta në secilin nivel lokal. Kompetencat e këtij lloji të ekspertit duhet të saktësohen në nivel komunal.

Aktiviteti 5.2 Botimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi praktik mbi sistemin e arsimit gjithëpërfshirës dhe kompetencat komunale

Siç është treguar në ligjin e decentralizimit, një pjesë e madhe e veprimeve administrative lidhur me edukimin do të jenë detyrë e komunës. Së këndejmi, “përkthimi” i parimeve të decentralizimit në nivel lokal duhet të qartësohet dhe të shfrytëzohet bashkërisht me sistemin administrativ të komunës.

Aktiviteti 5.3 Trajnimi i zyrtarëve komunalë

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, trajnimi i zyrtarëve të komunave është i dobishëm për të përmirësuar shpërndarjen e madhe të kompetencave për promovim dhe monitorim të procesit të përfshirjes së të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara.

ANEKSET

Aneksi 1 – Të dhëna mbi shkollat speciale në Kosovë

TABELA 1 – Shkollat speciale në Kosovë

Numri	Komuna/ Rajoni	Numri i fëmijëve		
		Djem	Vajza	Totali
1	Mitrovicë	41	20	61
2	Mitrovicë ¹⁷			0
3	Pejë	34	21	55
4	Prishtinë	54	46	100
5	Prizren	68	29	97
6	Prizren	50	16	66
7	Shtime	2	3	5
Totali		249	135	384

Llojet e aftësive të kufizuara të treguara¹³ janë:

Lloji i aftësisë së kufizuar	Djem	Vajza	Totali
Intelektuale	78	36	114
Dëgjimi	57	25	82
Shikimi	34	21	55
Fizike	4	0	4
E shumëfishtë	76	53	129
Totali	249	134	384

Arsimtarët dhe edukatorët:

	Komuna/ Rajoni	Arsimtarët /edukatorët		
		M	F	Totali
1	Mitrovicë	4	10	14
2	Mitrovicë	0	0	0
3	Pejë	4	14	23
4	Prishtinë	0	13	13
5	Prizren	9	22	31
6	Prizren	1	16	17
7	Shtime	1	1	2
		24	76	100

Personeli i përkujdesjes:

	Komuna/ Rajoni	Personeli i përkujdesjes		
		M	F	Totali
1	Mitrovicë	1	1	2
2	Mitrovicë	0	0	0
3	Pejë	3	3	6
4	Prishtinë	0	0	0
5	Prizren	2	5	7
6	Prizren	1	2	3
7	Shtime	0	0	0
		7	11	18

Personeli administrativ:

	Komuna / Rajoni	Personel administrativ		
		M	F	Totali
1	Mitrovicë	1	1	2
2	Mitrovicë	0	0	0
3	Pejë	1	0	1
4	Prishtinë	1	1	2
5	Prizren	1	2	3
6	Prizren	1	0	1
7	Shtime	0	1	1
		5	5	10

Asistentët:

	Komuna / Rajoni	Asistentë		
		M	F	Totali
1	Mitrovicë	4	1	5
2	Mitrovicë	0	0	0
3	Pejë	5	8	13
4	Prishtinë	0	13	13
5	Prizren	0	1	1
6	Prizren	3	2	5
7	Shtime	0	1	1
		18	20	38

Shkollat shpesh sigurojnë hapësirë / tabela.

¹⁸ Lidhur me këtë shkollë nuk janë futur të dhëna.

Aneksi 2 – Të dhëna mbi klasat speciale të bashkëngjitura në Kosovë

Numri i fëmijëve sipas klasave të vijuara:

Nr.	Klasa	Totali	Djem	Vajza	% vajza
1	Klasa 1	44	21	23	57.1
2	Klasa 2	74	53	21	56.9
3	Klasa 3	41	20	21	45.2
4	Klasa 4	72	43	29	42.6
5	Klasa 5	131	83	48	42.7
6	Klasa 6	77	47	30	38.5
7	Klasa 7	27	17	10	31.5
8	Klasa 8	12	9	3	30.0
9	Klasa 9	9	7	2	60.0
Totali		487	300	187	45.9

Numri i nxënësve sipas llojit të aftësisë së kufizuar

Lloji i aftësisë së kufizuar	Djem	Vajza	Totali
Intelektuale	128	149	277
Dëgjimi	15	14	29
Shikimi	2	0	2
Fizike	12	4	16
E shumëfishtë	116	65	181
Totali	306	187	493

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

ARSIMI

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Krijimi i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit	1.1 Konvertimi gradual i shkollave speciale dhe i klasave të bashkëngjitura në qendra burimore.	MASHT, DKA, Institucionet arsimore, OJQ-të dhe OPAK	Numri i shkollave speciale dhe i klasave të bashkëngjitura i konvertuar në baza vjetore	2011	KASH (Obj. I) Strategjia e MASHT-it 2007-2017 400.000 Euro
	1.2 Sigurimi i mjeteve ndihmëse, materialeve arsimore, interpretuesve të gjuhës së shenjave përmes qendrave burimore.	MASHT, DKA, Institucionet shkollore, UP	Numri dhe lloji i ndihmave të siguruar në baza vjetore	2011	KASH 100.000 Euro/3 vite
	1.3 Eliminimi i pengesave në objektet ekzistuese arsimore.	MASHT (Departamenti i infrastrukturave), MAPH, DKA, Institucionet arsimore, UP	Numri i shkollave dhe i objekteve parashkollore që vihen në dispozicion në baza vjetore	2011	KASH (Obj. II) Strategjia e MASHT-it 2007-2017 2 milionë Euro
	1.4 Ndërtimi i shkollave të reja dhe i institucioneve të reja parashkollore sipas standardeve ndërkombëtare të qasjes.	MASHT (Departamenti i Infrastrukturës), MAPH, DKA, institucionet arsimore, UP	Përqindja e shkollave të reja në dispozicion dhe i objekteve parashkollore	2009	Aktivitete me shpenzime të ulëta KASH (Obj. II)
	1.5 Sigurimi i arsimtarëve që udhëtojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në zona me kushte të pafavorshme, për shkak të largësisë së madhe, vendeve të paarrishme, paaftësive serioze, etj.	MASHT, DKA, Institucionet arsimore, OJQ-të dhe OPAK	Numri i nxënësve që në baza vjetore shfrytëzojnë arsimtarët që udhëtojnë Numri i orëve të mësimi të arsimtarëve që udhëtojnë të siguruar në baza vjetore për nxënës	2011	KASH 45.000 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
2. Implementimi i legjislacionit në fushën e arsimit për persona me aftësi të kufizuara.	2.1 Miratimi i ligjit mbi sistemin gjithëpërfshirës arsimor.	MASHT, institucionet arsimore, UP, komunat, OJQ-të dhe OPAK	Projekti i ligjit	2009	Aktivitete me shpenzime të ulëta BKK-KASH 4000 Euro
	2.2 Projekti mbi gjuhën e shenjave.	MASHT, DKA, UP, OJQ-të dhe OPAK	Projekti i legjislacionit	2010	Aktivitete me shpenzime të ulëta KASH 4000 Euro
	2.3 Botimi i udhëzuesit mbi arsimin gjithëpërfshirës.	MASHT, komunat, DKA, qendrat burimore	Numri i kopjeve të shtypura dhe të shpërndara	2010	Aktivitete me shpenzime të ulëta KASH 5000 Euro
	2.4 Botimi i doracakëve / udhëzuesve për PIA.	MASHT, DKA, UP, OJQ-të dhe OPAK	Doracaku i botuar	2009	Aktivitete me shpenzime të ulëta KASH 5000 Euro
3. Garantimi i sistemit arsimor gjithëpërfshirës në institucionet parashkollore.	3.1 Botimi i doracakëve dhe i udhëzuesve mbi aftësitë e kufizuara dhe zhvillimin fëmijëror.	MASHT, DKA, institucionet arsimore, UP, OJQ-të dhe OPAK	Numri i doracakëve të botuar dhe të shpërndarë	2011	KASH 10.000 Euro
	3.2 Garantimi i shërbimeve ndihmëse për institucionet parashkollore arsimore gjithëpërfshirëse.	MASHT, DKA, institucionet arsimore, UP, OJQ-të dhe OPAK	Numri dhe lloji i shërbimeve të siguruara	2011	KASH 150.000 Euro/ 3 vite
	3.3 Krijimi i marrëveshjeve midis Qendrave me Bazë në Bashkësi (QBB) dhe institucioneve parashkollore .	Institucionet parashkollore, Qendrat me bazë në bashkësi, komunat, DKA	Numri i marrëveshjeve të realizuara	2011	KASH Aktivitete me shpenzime të ulëta
	3.4 Implementimi i Programeve të Individualizuara të Arsimit (PIA) për personat me aftësi të kufizuara.	Institucionet parashkollore, Qendrat me bazë në komunitet, komunat, DKA	Përqindja e institucioneve që shfrytëzojnë PAI	2011	KASH 150.000 Euro
	3.5 Rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara që i vijnë institucionet parashkollore.	MASHT, DKA, institucionet parashkollore	Numri i fëmijëve që vijnë institucionet parashkollore në baza vjetore	2011	KASH 50.000 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
4. Programet e zhvillimit profesional mbi arsimin gjithëpërfshirës për arsimtarët dhe njerëzit e inkuadruar në sistemin arsimor.	4.1 Zhvillimi i programeve të trajnimit për arsimtarët në të gjitha nivelet e arsimit.	UP, Fakulteti i Edukimit - Departamenti për trajnime profesionale, DKA, institucionet arsimore, PIA, Agjencia e Akreditimit	Numri i programeve të krijuara të trajnimit Numri i arsimtarëve të trajnuar	2010	KASH (Obj. III) 40.000 Euro/2 vite
	4.2 Zhvillimi i i programeve të trajnimit për asistentë, vullnetarë, edukatorë, prindër dhe personel të OJQ-ve në të gjitha nivelet e arsimit.	UP, Fakulteti i Edukimit, PIA, OJQ-të dhe OPAK	Numri i programeve të krijuara të trajnimit Numri i personave të trajnuar	2011	KASH (Obj. III) 40.000 Euro
5. Përmirësimi i kompetencave mbi aftësitë e kufizuara në nivel komunal.	5.1 Punësimi i zyrtarit / ekspertit për arsimin gjithëpërfshirës në secilën komunë.	Komunat, DKA	Zyrtarët e punësuar	2011	KASH Buxheti komunal 111.000 Euro/viti
	5.2 Botimi dhe shpërndarja e udhëzuesve praktikë mbi sistemin e arsimit gjithëpërfshirës dhe kompetencat komunale.	MASHT, DKA, UP OJQ-të dhe OPAK	Udhëzuesit e botuar dhe numri i kopjeve të shpërndara	2009	BKK 20.000 Euro
	5.3 Trajnimi i zyrtarëve të komunave.	MASHT, DKA, UP OJQ-të dhe OPAK	Numri i trajnimeve të realizuara në komuna	2010	KASH 7.000 Euro

Shkurtesat

MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
DKA Departamenti Komunal i Arsimit
UP Universiteti i Prishtinës
IPK Instituti Pedagogjik i Kosovës
QBB Qendrat me Bazë në Bashkësi
MAPH Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor
OJQ-të Organizatat Joqeveritare
OPAK Organizatat për Persona me Aftësi të Kufizuara
PIA Programi i Individualizuar i Arsimit PEI

6.4 PUNËSIMI

SITUATA POLITIKE DHE LEGJISLATIVE

Duhet të theksohet se kohët e fundit në Kosovë është miratuar një akt i cili ua mundëson personave me aftësi të kufizuara të jenë pjesë e forcës punuese. Ky është Ligji 2009/03/L-019 mbi Aftësitë Profesionale, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara .

Para kësaj, ligjet në fuqi për personat me aftësi të kufizuara kryesisht kanë qenë dy të mëposhtmet:

- 1) Rregullorja Nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë dhe
- 2) Ligji Nr 2003/1 mbi Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Korniza Gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara është e përfshirë me këto “Akte nënligjore”:

- Udhëzimi administrativ nr. 9/2004 për proceduarat e prezantimit të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar
- Udhëzimi administrativ nr.13/2004, skema administrative e pagesave të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara
- Udhëzimi administrativ nr.15/2004, për implementimin e ligjit për pensionet për personat me aftësi të kufizuar;
- Udhëzimi administrativ nr.3/2005 për proceduarat, monitorimin dhe rishqyrtimin e të drejtës për pension të personat me aftësi të kufizuara;
- Udhëzimi administrativ nr. 3/2003 për pensionin e përkoshëm për punëtorët e kompleksit trepça dhe të minierave të nëntokës në Kosovë nën administrimin e Unmik-ut
- Udhëzimi administrativ nr.9/2005, ndryshimet plotësuese të proceduarve të paraqitjes së kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar

TË DHËNA

Republika e Kosovës sot ballafaqohet me sfida me të cilat ajo patjetër duhet të merret. Një nga këto sfida pa dyshim është papunësia e vlerësuar në 43% (shkalla shtetërore). Vitet 1990, sistemi paralel i arsimit, lufta në vitet 98-99 dhe faktorët e tjerë, kanë ndikuar mbi ekonominë dhe punësimin. Papunësia prek shumicën e njerëzve dhe posaçërisht të rinjtë pasi ata përfundojnë shkollimin, ngaqë punësimi i qëndrueshëm është shumë i vështirë.

Një faktor tjetër me të cilin shoqëria dhe institucionet janë të preokupuara është numri i njerëzve të papunë të cilët nuk janë të kualifikuar (prej më shumë se 335.000 personave të regjistruar si të papunë, 59 % prej tyre nuk janë të kualifikuar).

Me objektivin e kualifikimit, rikualifikimit dhe përgatitjes së forcës punëtore për tregun e punës, MPMS në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare ka themeluar në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës Qendrat për Aftësim Profesional (QAP).

Grupi Punues nuk ka të dhëna të sakta për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Kjo mund të paraqesë një problem serioz për përpilimin e Planit Kombëtar. Nëse ne i referohemi të dhënave zyrtare, aktualisht 1804 persona janë regjistruar (sipas statistikave të muajit tetor të vitit 2008) si punëkërkuar. Por në realitet nuk dihet se sa është numri i njerëzve të papunë, çfarë lloji kualifikimesh kanë ata, sa prej tyre janë të interesuar të kenë aftësim profesional, në cilat profesione ata mund të ishin të shkathtë dhe a ka nevojë të hapen profesione të tjera të reja.

Një element tjetër është se duhet të bëhen analiza lidhur me mbrojtjen në vendet e punës dhe në qendrat e punës. Kjo duhet të sjellë një vendim të pa-kompromis lidhur me atë se cilat janë mundësitë më të mira për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Papunësia në Republikën e Kosovës paraqet një nga sfidat kyçe të shoqërisë në Kosovë. Në mesin e karakteristikave të tregut të punës në Republikën Kosovë është papunësia e lartë (rreth 43%), papunësia

afatgjatë në 90%, papunësia e grave në 47%, fakti se rreth 59% e të papunëve të regjistruar janë kryesisht të pakualifikuar, papunësia e të rinjve është rreth 29% për grup-moshën 15-24 vjeçare dhe rreth 50% për grup-moshën 25-39 vjeçare . Po ashtu, papunësia e personave me aftësi të kufizuara është e lartë. Kjo është arsyeja pse politikat aktive të punësimit mund të rrisin punësimin me qëllim të lehtësimit të transicionit në tregun e punës për të kontribuar drejt harmonizimit më të mirë të propozimeve dhe kërkesave të punës si dhe për të ndihmuar ri-integrimin e grupeve të rrezikuara siç janë personat me aftësi të kufizuara.

BURIMET FINANCIARE

Burimet duhet të jenë në dispozicion në pajtim me:

- Kapitullin VII Neni 29 i Ligjit mbi Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara 2009/03/L-019 dhe
- KASH 2009-2011, paragrafi 4.5 Zbutja e Varfërisë dhe Stabiliteti Social, nën-paragrafi 4.5.1 Politikat sociale dhe të tregut të punës.

Politikat sociale (në miliona euro, tabelë e marrë nga KASH)

	2009	2010	2011	2009-2011
Shpenzimet Operative	158.7	161.9	165.1	485.7 (14.2%)
Shpenzimet Kapitale	2.3	2.4	2.4	7.0
Totali	161.0	164.3	167.5	

Në varësi nga afatet kohore të Kuvendit dhe të autoriteteve lokale, është e arsyeshme të pritet që ta kemi tërë situatën nën kontroll, të paktën , brenda disa vitesh.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Si burim i frymëzimeve të punëve të kryera gjer më tani kanë qenë traktatet ndërkombëtare, siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, posaçërisht neni 27, dhe Rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, që burojnë nga Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës 159/1983 mbi Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Rekomandimin e ONP 168/1983 “Puna e mirë është qëllimi parësor i ONP për secilin njeri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Kur të drejtat dhe dinjteti i personave me aftësi të kufizuara janë të kultivuara, ne jemi duke fuqizuar individët, duke forcuar ekonomitë dhe duke pasuruar shoqërinë në përgjithësi”.

Elementet kyçe të ardhshme lidhur me shanset për të punësuar personat me aftësi të kufizuara janë:

- Punësimi është i barabartë me:
 - Përfshirjen sociale dhje luftën kundër varfërisë;
 - Arritja e vetëbesimit dhe realizimi i kapaciteteve të tyre
- Politika e BE-së synon punësimin në tregun e hapur të punës;
- Lëvizja e paradigmes në sektorin e aftësive të kufizuara e prezantuar nga lëvizja mbi aftësitë e kufizuara synon përfshirjen dhe pjesëmarrjen e plotë të njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqëri;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Personat me Aftësi të Kufizuara dhe ajo e Këshillit të Evropës, përherë theksojnë rëndësinë e punësimit dhe bëjnë thirrje për veprim;

Objektivat dhe aktivitetet e identifikuar janë:

1. Implementimi dhe zbatimi i Ligjit mbi Punësimin për Personat me Aftësi të Kufizuara. Përmirësimi i trajnimit profesional për personat me aftësi të kufizuara:

Aktiviteti 1.1 Identifikimi i Administratës Publike dhe i Firmave Private me më shumë se 50 të punësuar (Ligji 2009/03/L-019 neni 12: 1 vend pune për një person me aftësi të kufizuara në 50 të punësuar).

Një aksion preliminar i cili garanton zbatimin e ligjit 2009/03/L-019 është duke i financuar vendet e obliguara të punës si tek punëdhënësit publikë ashtu edhe tek ata privatë.

Aktiviteti 1.2 Përkufizimi i kriterëve të prioritetëve për punësim të personave me aftësi të kufizuara.

Ngaqë vendet e punës janë theksuar, është e domosdoshme të përkufizohen kriteret e punësimit bazuar në përshkrimin e vendit të punës dhe përshtatshmërinë e tij për funksionimin e të punësuarit. Po ashtu është e domosdoshme për t'u dhënë prioritet punëkërkuarëve me aftësi të kufizuara në pajtim me kriteret e tjera të mëposhtme siç janë: varfëria, paaftësia serioze, moshë, gjendja e rëndë familjare dhe ngjashëm.

Aktiviteti 1.3 Hartimi i një rregulloreje ekzekutive të Ligjit 2009/03/L-019, në pajtim me nenin 29.

Zbatimi i ligjit 2009/03/L-019 kalon përmes hartimit të udhëzimeve të sakta administrative të bazuara në kriterin e transparencës dhe të qartësisë. Ligji, vërtet, parasheh parimet e përgjithshme të mundësive të barabarta për të siguruar një punë. Së këndejmi, është e domosdoshme që rregullorja ekzekutive të shpallë rregulla të hollësishme për t'u mundësuar punëtorëve me aftësi të kufizuara për të kryer punën e siguruar.

2. Përmirësimi i trajnimit profesional për personat me aftësi të kufizuara:

Aktiviteti 2.1 Krijimi i programeve të trajnimit në Qendrat e Trajnimit Profesional.

Programet e trajnimit duhet të përforcojnë aftësitë e personave me aftësi të kufizuara lidhur me vendet e tyre të punës. Në pajtim me modelin e ri të aftësisë së kufizuar të ndërlidhur me funksionimin e secilit person, programet e trajnimit duhet të formësohen sipas karakteristikave të të trajnuarve.

Aktiviteti 2.2 Trajnimi i personelit profesional për trajtim të personave me aftësi të kufizuara në sektorin e punësimit (duke përfshirë, po ashtu, Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF)).

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit (KNF) është një mjet i domosdoshëm për të theksuar dhe vlerësuar kapacitetet që kanë punëkërkuarët me aftësi të kufizuara. Trajnimi i personelit të Qendrave të Trajnimit Profesional (QTP) – posaçërisht në lidhje me shfrytëzimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF)- mund të përmirësojë aftësitë e tyre për të trajtuar personat me aftësi të kufizuara dhe kapacitetet e tyre për të vënë në pah qëndrimet e punëkërkuarëve.

Aktiviteti 2.3 Zbatimi i trajnimit profesional, me asistencë të veçantë për nevojat e ndryshme (interpretuesit e gjuhës së shenjave, Braille, etj.) të personave me aftësi të kufizuara.

Në trajnimet profesionale, metoda duhet të marrë parasysh nevojat e komunikimit të të trajnuarve si dhe faktin se përmbajtja e tyre duhet të jetë në koherencë me qëndrimet e tyre. Kjo ndodh posaçërisht kur të trajnuarit janë të shurdhër ose të verbër: metodologjia vizuale ose dëgjimore mund të paraqesë diskriminim të mëtejshëm. Interpretuesi i gjuhës së shenjave, Braille dhe dokumentet e shkruara me shkronja të mëdha mund të garantojnë pjesëmarrjen e plotë në procesin e trajnimit.

Aktiviteti 2.4 Trajnimi profesional për personat e rinj me aftësi të kufizuara brenda dy viteve pas përfundimit të shkollimit.

Tranzicioni i menjëhershëm nga shkolla në punësim është i domosdoshëm në veçanti për personat e rinj me aftësi të kufizuara. Një periudhë e gjatë e papunësisë mund të shkaktojë humbjen e vetëbesimit, që zvogëlon mundësinë për të aplikuar për punë dhe për të zbatuar atë.

3. Integrimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës dhe mbështetja e vetë-punësimit:

Aktiviteti 3.1 Zgjedhja e metodologjisë mbi mbështetjen e punësimit (Shih Aneksin 1 – Metodologjitë e mundshme të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara).

Përdorimi i metodologjisë së punës së përkrahur është duke e rritur anë e kënd botës mundësinë për të integruar personat me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Një vend i përshtatshëm i punës dhe

ekipi i punës mund të lehtësojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mund të ngritin cilësinë e kryerjes së punës së tij ose të saj.

Aktiviteti 3.2 Krijimi i një rrjeti të qasshëm të informacioneve.

Përhapja e informacioneve në fushën e punësimit është esenciale për përshtatjen e vendit të punës dhe për punëkërkuessit. Për këtë qëllim, krijimi i një rrjeti të veçantë të qasshëm të informacionit mund të përmirësojë qasjen ndaj shpalljeve të punës dhe shanseve të punësimit.

Aktiviteti 3.3 Zhvillimi i skemave për para-punësim.

Si rezultat i shfrytëzimit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit (KNF), skema e para-punësimit duhet të bazohet në pikëpamjet dhe karakteristikat e punëkërkuessve. Një plan i qartë mësimor, plotësimi i duhur i aplikacionit dhe mundësia e prezantimit të vetvetes në një mënyrë pozitive janë parakushte për t'u marrë parasysh si kandidat potencial.

Aktiviteti 3.4 Verifikimi dhe inspektimi i qasjes ndaj ambientit të punës, në varësi nga aftësitë e kufizuara të të punësuarve.

Përshtatja e ambientit të punës është ngushtësisht e lidhur me teknologjitë e reja. Me qëllim të sigurimit të qasjes, shfrytëzimi i pajimeve ndihmëse mund të eliminojë barrierat dhe pengesat.

4. Kryerja e hulumtimeve dhe analizave mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuara lidhur me sektorin e punësimit

Aktiviteti 4.1 Pyetësorët për vlerësim të personave me aftësi të kufizuara.

Mbledhja e të dhënave është kusht me qëllim të krijimit të strategjive të duhura për sektorin e punësimit. Kjo çështje është e specifikuar në hollësi në Sektorin e të Dhënave Statistikore të PAK.

Aktiviteti 4.2 Raportet mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Monitorimi dhe raportimi i punësimit të personave me aftësi të kufizuara është një çështje tjetër e rëndësishme për vlerësim të proceseve dhe mungesave në këtë fushë. Monitorimi duhet të udhëhiqet mbi baza specifike, siç është saktësuar në mënyrë më të përgjithshme në Sektorin e Monitorimit, Raportimit dhe të Vlerësimit të PAK.

Aktiviteti 4.3 Pyetësorët për përmbushjen e detyrave nga personat me aftësi të kufizuara.

Në momentin që sigurohet punësimi i njerëzve me aftësi të kufizuara, punësimi mund të analizohet mbi bazën e kualitetit me qëllim të verifikimit të nivelit të përmbushjes së detyrave dhe kënaqësisë së punonjësve.

5. Fushatat e mbështetjes së ndërgjegjësimit për lehtësim të qasjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Aktiviteti 5.1 Botimi i broshurave dhe i materialeve të tjera informative lidhur me punësimin dhe personat me aftësi të kufizuara

Integrimi i plotë i personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës mund të sigurohet përmes pranimi të punëtorëve me aftësi të kufizuara si burim njerëzor pune për të gjithë shoqërinë. Personat me aftësi të kufizuara në mënyrë aktive mund t'i kontribuojnë biznesit privat dhe ekonomisë familjare. Shpërndarja e materialeve informative lidhur me këto çështje mund të forcojë këtë vizion të ri për personat me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 5.2 Përhapja e informacioneve përmes programeve / reklamave të Radios dhe të Televizionit.

Ajo që është përmendur më lart, me lehtësi mund të shpërndahet përmes më shumë mediave, siç janë TV dhe Radio.

Aktiviteti 5.3 Trajnimet e veçanta në kompani me qëllim të lehtësimit të qasjes së personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim të përfundimit të procesit të integrit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, punëdhënësit duhet të sigurojnë trajnime të veçanta të personelit. Rritja e vetëdijes në mesin

e të gjithë personelit është hapi final për të siguruar integrimin e punëtorëve me aftësi të kufizuara brenda biznesit funksional.

ANEKSET

Aneksi 1 – Metodologjitë e mundshme të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara

Punësimi i përkrahur

Metodologjia e punësimit të përkrahur është përkufizuar dhe zhvilluar nga Asociacioni Botëror për Punën e Përkrahur: “Punësimi i përkrahur mund të karakterizohet si punë e paguar në ambientet e integruara të punës me përkrahje të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës. Puna e paguar për individët do të thotë e njëjta pagesë për të njëjren punë si për personat pa aftësi të kufizuara”.

Aktivitetet	PUNA E PËRKRAHUR, NË PIKA TË SHKURTRA
Trajnuesi i punës	Përkrahësi i punëdhënësit dhe i punëtorit, pasi që është arritur gjetja e vendit të punës.
Analiza e punës	Aktivitet i cili realizohet në secilën fazë të procesit të Përzgjedhjes së Punësimit (PP).
Kërkuesi i punës	Personi i cili kërkon punët e përshtatshme për klientin.
Vlerësimi	Procesi i vlerësimit të kandidatit, në mënyrë që të mund të bëhet një deklaratë lidhur me përshtatshmërinë e kandidatit për disa funksione.
Bashkërendimi i punës	Përshtatshme formal i punës. Paraqet informacionin e plotë të dhënë nga analizat dhe vlerësimi i punës.
Elementet e tjera	Njohja e klientit me kolegët – Trajnimi i kolegëve – Udhëzimi personal i klientit jashtë ambientit të punës– Ofrimi i këshillimit për punëdhënësin.

Punëtoritë për strehim

Personat me aftësi të kufizuara po ashtu mund të punësohen brenda “punëtorive të strehuara” ose “kooperativave”.

Punëtoritë e strehuara ofrojnë mundësi punësimi për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për njerëzit nga ambiente me kushte të pafavorshme, siç janë grupet minoritare etnike, të papunët në afat të gjatë kohor dhe personat të cilët i kthehen forcës punuese pas një periudhe të rehabilitimit.

PUNËSIMI

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Implementimi dhe zbatimi i Ligjit mbi Punësimin për personat me aftësi të kufizuara.	1.1 Identifikimi i Firmave të Administratës publike dhe i atyre Private me më shumë se 50 punëtorë (Ligji 2009/19 neni. 12: 1 vend pune për një person me aftësi të kufizuara në 50 punëtorë).	MPMS (DPP), Zyrat Rajonale të Punësimin (ZRP), Zyra Komunale për Punësim, MMPH, Shoqata e Firmave Private	Vendet e gjetura të punës për Personat me aftësi të kufizuara. Përqindja e vendeve të punës të plotësuara nga personat me aftësi të kufizuara.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH 3.000 Euro
	1.2 Përkufizimi i kriterëve të prioritetit për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	MPMS (DPP), Zyrat Rajonale të Punësimin (ZRP), Zyra Komunale për Punësim, OJQ-të, OPAK	Kriteret e miratuara.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5000 euro
	1.3 Hartimi i udhëzimeve administrative për zbatimin e Ligjit 2009/19, sipas nenit 29.	MPMS (DPP) dhe Ministrinë e tjera	Projekti i miratuar.	2010	Aktivitet me kosto të ulët KASH (Obj. 4.5.1) 5.000 Euro
2. Përmirësimi i trajnimit profesional për personat me aftësi të kufizuara.	2.1 Krijimi i programeve të trajnimit në qendrat profesionale të trajnimit.	MPMS (DPP). Qendrat e Trajnimit Profesional (QTP), MASHT, OJQ-të dhe OPAK	Numri i personave të kualifikuar.	2010	KASH 50.000 Euro
	2.2 Trajnimi i personelit profesional për trajtim të personave me aftësi të kufizuara në sektorin e punësimin (duke përfshirë, po ashtu, edhe trajnimin e KNF).	MPMS (DPP). Qendrat e Trajnimit Profesional (QTP), MASHT, OJQ-të dhe OPAK	Personeli i trajnuar në baza vjetore.	2010	KASH (Obj. 4.5.1) 20.000 Euro
	2.3 Implementimi i trajnimit profesional, me ndihmën e veçantë për nevoja të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara (interpretuesit e gjuhës së shenjave, Braille, etj.).	MPMS (DPP). Qendrat e Trajnimit Profesional (QTP), MASHT, OJQ-të dhe OPAK	Numri i klasave të krijuara në baza vjetore.	2011	KASH (Obj. 4.5.1) 100.000 Euro
	2.4 Trajnimi profesional për të rinjtë me aftësi të kufizuara brenda dy vjetësh pas kryerjes së shkollimit.	MPMS (DPP).MASHT, ZRP, ZKP, MKRS	Numri i personave të trajnuar. Koha e kaluar në listën e punëkërkuësve pas kryerjes së shkollës.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH 10 000 euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
3. Integrimi i personave në tregun e hapur të punës dhe përkrahja e vetë-punësimit.	3.1 Zgjedhja e metodologjisë mbi përkrahjen e punës.	MPMS (DPP), OJQ-të, OPAK	Metodologjia e zgjedhur dhe e hartuar.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (pa kosto)
	3.2 Krijimi i një rrjeti të qasshëm të informacioneve.	MPMS (DPP), OJQ-të, OPAK	Krijimi i një faqeje kushtuar kësaj çështjeje në kuadër të Faqes së Internetit të Ministrisë.	2009	Aktivitet me shpenzime të ulëta BKK-KASH (pa kosto)
	3.3 Zhvillimi i skemave për para-punësim.	MPMS (DPP).MASHT, ZRP, ZKP	Trajnimi i këshilltarëve që punojnë në ZRP dhe ZKP.	2010	KASH (Obj. 4.5.1) 15.000 Euro
	3.4 Verifikimi dhe inspektimi i qasjes së ambientit të punës, varësisht nga aftësitë e kufizuara të punëtorëve.	MPMS (DPP), MASHT, Punëdhënësit, OJQ-të, OPAK	Numri i vendeve të inspektuara të punës. Numri i ndëshkimeve.	2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (pa kosto)
4. Kryerja e kërkimit dhe e analizave lidhur me situatën e Personave me aftësi të kufizuara në lidhje me sektorin e punësimit.	4.1 Pyetësorët për vlerësim të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.	MPMS (DPP), MAPL, ZRP, ZKP, ESK, OJQ-të, OPAK	Numri i pyetësorëve të plotësuar.	2010	KASH 20.000 Euro
	4.2 Raportet mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara.	MPMS (DPP), MAPL, ZRP, ZKP, ESK, OJQ-të, OPAK	Raportet vjetore.	2011	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH (pa kosto)
	4.3 Pyetësor për përmbushjen e kushteve për punonjësit me aftësi të kufizuara .	MPMS (DPP), MAPL, ZRP, ZKP, ESK, OJQ-të, OPAK	Numri i pyetësorëve të plotësuar.	2011	KASH (Obj. 4.5.1) 5000 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
5. Përkrahja e fushatave të ngritjes së vetëdijes për lehtësim të qasjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.	5.1 Botimi i broshurave dhe i materialeve të tjera informative lidhur me punësimin dhe personat me aftësi të kufizuara.	MPMS (DPP), MAPL, ZRP, ZKP, ESK, OJQ-të, OPAK	Materiali informativ i shtypur dhe i shpërndarë.	2010	KASH 20.000 Euro
	5.2 Përhapja e informacioneve përmes programeve të Televizionit dhe Radios / reklamave.	5.2 MPMS (DPP), MAPL, ZRP, ZKP, ESK, OJQ-të, OPAK	Koha që i kushtohet në Radio dhe TV. Reklammat	2009 2010	Aktivitet me shpenzime të ulëta KASH 5.000 Euro
	5.3 Trajnimi specifik në Kompanitë për lehtësim të qasjes së personave me aftësi të kufizuara.	5.3 MPMS (DPP), QPT	Numri i njerëzve të trajnuar në baza vjetore nëpër kompani.	2011	

Shkurtesat

MPMS Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
 QRP Qendrat Rajonale të Punësimin
 QKP Qendrat Komunale të Punësimin
 QTP Qendrat e Trajnimit Profesional
 MAPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 MSHP Ministria e Shërbimeve Publike
 MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 MKRS Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
 ESK Enti Statistikor i Kosovës
 DPP Departamenti për Punë dhe Punësim
 OJQ-të Organizatat Joqeveritare
 OPAK Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara
 PAK Personat me Aftësi të Kufizuara
 KNF Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndeti
 KAMSH Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
 BKK Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

6.5 MBROJTJA SOCIALE

KONTEKSTI POLITIK DHE LEGJISLATIV

Në fushën e politikave sociale, Kosova ka miratuar ligje në sektorin social të cilat mbulojnë fusha të ndryshme për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ligjet mbulojnë pensionet¹⁸, shërbimet e mbrojtjes sociale dhe mbështetjes për familjet¹⁹ si dhe mbrojtjen e fëmijëve²⁰. Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) brenda kornizës së mbrojtjes sociale dhe fushave të autoritetit të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (MPMS) janë identifikuar dy fusha të intervenimit:

- Zhvillimi dhe sigurimi i një përfshirjeje efikase të asistencës sociale për grupet e planifikuara të njerëzve dhe
- Monitorimi i programit të tashëm të pensionit dhe zgjerimi i përfituesve prej tij.

TË DHËNAT NË DISPOZICION MBI MBROJTJEN SOCIALE

Njerëzit me aftësi të kufizuara të cilët përfitojnë nga pensionet:

Viti	Përfituesit	Në miliona euro
2004	15,077	12,600,000.00
2005	21,786	12,600,000.00
2006	19,981	13,900,000.00
2007	19,203	13,900,000.00
2008	18,645 (9,363 prej të cilëve janë femra dhe 9,282 meshkuj. 49.8%)	10,800,000.00

Shpërndarja gjeografike e përfituesve të pensioneve:

Q. R.-Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Gjakovë	Ferizaj	Prizren	Gjilan
M/F	M/F	M/F	M/F	M/F	M/F	M/F
2127/2317	1145/1255	1132/1030	730/1069	1038/924	1950/1700	1160/1072

Nuk ka të dhëna statistikore në dispozicion mbi shërbimet sociale ekzistuese.

¹⁸ Legjislacioni kosovar mbi pensionet është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë, Rregulloren Nr. 2005/20 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/15 mbi shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Metodologjinë për përcaktimin e nivelit të pensioneve bazë në Kosovë dhe për vendosjen e datës së fillimit për sigurimin e pensioneve bazë. (Ligji nr. 2002/1 mbi Metodologjinë për përcaktimin e Nivelit të Pensioneve Bazike në Kosovë, dhe Përcaktimi i Datës së Fillimit për Sigurimin e Pensioneve Bazë), Rregullorja Nr. 2003/28 mbi Shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi skemën e asistencës sociale në Kosovë (Ligji nr. 2003/15 mbi Skemën e asistencës sociale në Kosovë), Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 mbi Shpalljen e ligjit mbi Pensionet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2003/23 mbi Pensionet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë); Propozimi nr. 9/2005 për modifikimin dhe përplotësimet e udhëzimit administrativ Nr. 09/2004 mbi procedurat parashtrimit të kërkesës për pensionet për persona me aftësi të kufizuara; Udhëzimet Administrative 03/2005 për procedurat e monitorimit dhe të rishqyrtimit të së drejtës për pensionet për persona me aftësi të kufizuara.

²⁰ Legjislacioni kosovar mbi mbrojtjen sociale është i rregulluar me Ligjin Nr. 02/L-17 mbi Shërbimet Sociale dhe të Familjes, Ligjin mbi statusin dhe të drejtat e familjes së martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës dhe familjeve të viktimave civile të luftës; Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2005 për procedurat e ndryshimit të ndihmës financiare për familjet dhe individët në nevojë të jashtëzakonshme; Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2005 për ndarjen e mjeteve për banorët e vendosur në institucionet e MPMS.

²⁰ Ligji Nr. 03/L-022 mbi ndihmën materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme.

BURIMET FINANCIARE

Lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), burimet financiare të theksuara në fushën e mbrojtjes sociale dhe në fushat e ndërlidhura me MPMS janë si më poshtë:

Politikat sociale (në miliona euro, tabelle e marrë nga KASH)

	2009	2010	2011	2009-2011
Shpenzimet operative	158.7	161.9	165.1	485.7 (14.2%)
Shpenzimet kapitale	2.3	2.4	2.4	7.0
Totali	161.0	164.3	167.5	

Tabela tregon se në vitet e ardhshme (2009-2011), përqindja vjetore e rritjes e buxhetit në dispozicion dhe e totalit gjatë periudhës trevjeçare është si më poshtë (duke përdorur vitin 2008 si bazë, në miliona euro):

2009	2010	2011	2009-2011
+ 3.3% Euro	+ 3.3% Euro	3.2 Euro	9.8 Euro
(+2.09%)	(+2.04%)	(+1.94%)	(+6.21%)

MPMS në vitin 2008 shpenzon për mbrojtjen sociale (në miliona euro):

- Përafërsisht 147.0 për pensionet dhe
- Përafërsisht 10.8 për asistencën për familjet.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Para së gjithash, është me rëndësi të saktësohet se objektivi i përgjithshëm është të transformohet qasja e bazuar në mbrojtjen sociale për personat me aftësi të kufizuara në një qasje të bazuar në përfshirjen sociale. Kjo do të thotë të kalohet nga një sistem i shërbimeve i bazuar në asistencën ekonomike dhe mbrojtjen nga qeveria në një sistem shërbimesh të lidhur me fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri.

Kujdes i veçantë do t'u kushtohet veprimeve të cilat kanë për synim luftën kundër varfërisë së popullatës me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përjetojnë procese të varfërimit social që shpesh i bënë ata më të varfrit në mesin e të varfërve.

Si rezultat i një diskutimi të gjerë, grupi punues tematik ka nënshkruar 4 objektiva mbi çështjet specifike²¹, duke përfshirë edhe një varg të veprimeve të veçanta:

1. Përmirësimi i shërbimeve sociale, reflektimi mbi të drejtat dhe liritë fundamentale të personave me aftësi të kufizuara ;
2. Përmirësimi i standardeve ekonomike të jetesës të personave me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
3. Krijimi dhe zbatimi e një kornize koherente ligjore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në një spektër të gjerë të shërbimeve cilësore të komunitetit dhe
4. Decentralizimi.

²¹ 4 Grupet punuese kanë realizuar pesë takime si dhe pesë takime lokale këshilluese janë organizuar në qytetet e Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Gjilanit.

1. Përmirësimi i shërbimeve sociale, që reflektojnë të drejtat dhe liritë fundamentale të personave me aftësi të kufizuara

Objektivi parësor është të zhvillohen shërbime sociale të gjithëpërfshirjes të cilat sigurojnë ndihmën për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të participojnë plotësisht në jetën e komunitetit, duke hequr çfarëdo diskriminimi ose disavantazhi. Shërbimet duhet të bazohen në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në kapacitetin për të rritur aftësinë e secilit person me aftësi të kufizuara me qëllim që të arrihet barazia e mundësive dhe jo-diskriminimi në raport me qytetarët e tjerë.

Aktiviteti 1.1 Ndryshimi i kriterëve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara në bazë të parametrave mjekësorë, ambientale dhe sociale dhe përfshirja në komisionin e vlerësimit kompetenca të tjera sociale

Bazat e sistemit të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse, në pajtim me dokumentet ndërkombëtare, duhet të sigurojnë qasje ndaj ndihmës dhe ndaj shërbimeve mbi kriterin e verifikimit dhe të vlerësimit të kushteve të personave me aftësi të kufizuara, duke përdorur jo vetëm parametrat mjekësorë, por, po ashtu, parametrat relativë, siç janë ambientin i cili krijon pengesa dhe barrierat si dhe rrethanat dhe mungesa e mundësive të barabarta. Nga ky këndvështrim, sistemi më adekuat i vlerësimit që e bënë të mundur të vlerësohen jo vetëm kushtet mjekësore të personit, por, po ashtu, edhe barrierat dhe pengesat ambientale, është Klasifikimi Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (KNF)²². Në pajtim me këtë, duhet të identifikohen parametra të ri të verifikimit që e bëjnë të mundshme përcaktimin e parametrave të ndryshëm dhe të veçantë bazuar në nivelin e kushteve të pavolitshme sociale, të cilin është duke e përjetuar personi. Në të njëjtën kohë, shkathtësitë e komisionit të verifikimit dhe të vlerësimit do të përplotësohen nga ekspertët e shërbimit social. Për të arritur këtë, një grup i studimit teknik to të caktohet në vitin 2009 dhe ky grup do të prezantojë propozimin për kriteret e bazuara në KNF dhe në qasjen e Konventës së Kombeve të Bashkuara në vitin 2010.

Aktiviteti 1.2 Vazhdimi i deinstitutionalizimit dhe përmirësimi i qasjes ndaj shërbimeve e zhvilluar në pajtim me parimet e jetesës së bashkësisë

Procesi i deinstitutionalizimit të personave me aftësi të kufizuara do të vazhdohet, posaçërisht në institucionet e shëndetit mendor, me mbylljen e institutit special në Shtime në vitin 2011.

Qasja për krijimin e shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe përfitimeve ekonomike synon mbajtjen e personave me aftësi të kufizuara në familjet e tyre dhe ambientet sociale si dhe për mbështetjen e pjesëmarrjes së tyre të plotë në jetesën e bazuar në bashkësi. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi për të nxitur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e përfshirjes.

Kjo do të thotë mbështetje e fuqizimit të aftësive dhe të shkathtësive të personave me aftësi të kufizuara, përmes proceseve të rehabilitimit, pajisjes dhe trajnimit.

Shërbimet sociale duhet të bazohen në parimet e mëposhtme: qasjen ndaj të gjithë përfituesve, të qenët në dispozicion në mënyrë të njëjtë në të gjitha territoret, mundësinë për të ndihmuar, qëndrueshmërinë dhe transparencën financiare, të zbatuara sipas nevojës, që lejojnë zgjedhjen e lirë të përfituesve dhe që janë të përqendruara në cilësinë e shërbimeve, të kontrolluara mbi bazën e efikasitetit të tyre dhe plotësimin e nevojave të përfituesve.

Në pajtim me këtë, do të zhvillohen dhe zbatohen politika të cilat parandalojnë deinstitutionalizimin e personave me aftësi të kufizuara, të të rriturve dhe të të moshuarve, përmes krijimit të shërbimeve të komunitetit në mbarë vendin. Këto shërbime do të sigurojnë njësi të vogla banuese ose mikro rezidenciale, të menaxhuara nga sektori publik ose privat, të ndërtuara në pajtim me standardet të bazuara në modelet e jetesës së familjes.

²² Klasifikimi Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Shëndetin dhe Aftësitë e Kufizuara, i miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 2001.

Aktiviteti 1.3 Identifikimi dhe zhvillimi i standardeve cilësore kombëtare për shërbimet sociale, me qëllim që t'u përgjigjen të drejtave dhe nevojave reale të personave me aftësi të kufizuara dhe kultivimit të të drejtave dhe të lirive të tyre fundamentale.

Krijimi i një rrjeti të shërbimeve sociale të gjithëpërfshirjes është një nga objektivat e PKVPAK. Përmes lidhjes së ministrive me autoritetet në këtë fushë, do të përcaktohen nivelet esenciale të shërbimeve të cilat kanë për qëllim personat me aftësi të kufizuara e të cilat në mënyrë të njëjtë ose homogjene do të garantohen në mbarë vendin. Këto shërbime po ashtu do të realizohen në bashkëpunim me entitetet private me qëllim të nxitjes së shfrytëzimit të plotë të të gjitha burimeve në dispozicion. Do të ftohen donatorët e huaj për të kontribuar për sigurimin e shërbimeve, për të siguruar shpërndarjen homogjene anekënd territorit të Kosovës.

Rregullat që kanë të bëjnë me secilin shërbim do të përkufizohen dhe do të identifikohen karakteristikat kuantitative dhe kualitative për t'i dhënë akreditimin entiteteve të cilat do të sigurojnë dhe menaxhojnë këto shërbime. Në secilin rast, shteti do të jetë përgjegjës për oraret, verifikimin dhe monitorimin e shërbimeve të siguruar. Do të krijohen, zhvillohen dhe implementohen shërbime të bazuara mbi planet shumëvjeçare kombëtare vjetore. Do të përkufizohen shërbimet esenciale që duhet të përfshihen në rrjetin e territorit të shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale. Për vitin 2010 do të përgatitet një listë dhe përkufizimi i shërbimeve sociale.

Aktiviteti 1.4 Krijimi i shërbimeve të asistencës personale për jetesën e pavarur

Brenda shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shërbimit mbështetës për jetesë të pavarur për personat me nevojë të madhe të asistencës. Së këndejmi, në njërën anë, të drejtat njerëzore të këtyre personave do të promovoheshin dhe, në anën tjetër, proceset e institucionalizimit, që vërtet janë të kushtueshme për shtetin, do të parandaloheshin. Kjo mund të përkufizohet përmes një ligji të veçantë për jetesën e pavarur²³.

Personave me kufizime më të mëdha mund t'u sigurohet një kompensim plotësues në pensionet e tyre, i cili nuk i nënshtrohet taksimit. Kjo dispozitë është përfshirë në ligjet e disa vendeve evropiane dhe është nxjerrë me të vetmin qëllim të reduktimit, si pranim i kushteve të pafavorshme që personat me aftësi shumë të kufizuara përjetojnë, e cila, së këndejmi, nuk konsiderohet si burim i të ardhurave dhe nuk taksohet.

Kjo zgjidhje, në plan afatshkurtër, e plotëson kërkesën e një mbështetjeje më të mirë të ndihmës sociale në lidhje me diferencimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuara, me çka sigurohet një vëmendje e veçantë për familjet të cilat kanë persona me paaftësi më të rënda. Disa vende evropiane kanë mekanizma ligjorë për identifikimin e këtyre kategorive të përfituesve²⁴. Në vitin 2011 do të bëhet monitorimi i numrit të përfituesve dhe i karakteristikave të tyre.

²³ Ligji duhet të sigurojë përkufizimin e përfituesve, një buxhet të orëve të përkufizuar përmes një projekti individual të përgatitur mbi bazat e karakteristikave të secilit përfitues, menaxhimin e buxhetit, të cilin secili përfitues e ka në dispozicion dhe zgjedhjen e asistentit personal

²⁴ P.sh., përkufizimi në nenin 5 të Ligjit Italian 104/92:

Neni. 3. –Përfituesit

1. *Person me aftësi të kufizuara është cildo person i cili ka dëmtim fizik, mental ose shqisor, që është i qëndrueshëm dhe progresiv, që është shkak i vështirësive në të mësuar, në marrëdhënie ose në sigurimin e punës dhe i tillë që përcakton procesin e gjendjes së pafavorshme sociale ose marginalizimin.*

2. *Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në shërbimet e krijuara në emër të tyre në lidhje me natyrën dhe shkallën e paaftësisë, aftësinë e gjithmbarshme të mbetur të individit dhe efikasitetin e terapisë rehabilituese.*

3. *Nëse një ose më shumë paaftësi e kanë zvogëluar pavarësinë personale, të ndërlidhur me moshën, deri në atë shkallë sa që asistencë e vazhdueshme dhe e plotë është e nevojshme për nevojat personale dhe ato relacionale, atëherë gjendja konsiderohet të jetë e aspektit serioz. Situatat e njohura si serioze do të kenë prioritet në programet publike dhe intervenimet e shërbimit.*

Aktiviteti 1.5 Krijimi i programit të trajnimit të vazhdueshëm të personelit të involvuar në dhënien e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Programi i trajnimit duhet të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas përkufizimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe do të mbulojë në mënyrë progresive gjithë personelin e përfshirë në dhënien e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara. Plani duhet të financohet nga Ministria përgjegjëse për trajnimin e të punësuarve publikë. Sesionet e trajnimit duhet të ndiqen, të paktën, nga personat përgjegjës për shërbimet publike dhe private për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, si dhe përfaqësuesit e OPAK. Trajnimi do të azhurnohet në mënyrë periodike. Në vitin 2011 do të përgatitet një raport i monitorimit.

Aktiviteti 1.6 Përmirësimi i bashkëpunimit midis Qeverisë, OJQ-ve dhe OPAK në procesin e sigurimit të shërbimeve sociale

Bashkëpunimi midis qeverisë kombëtare, autoriteteve lokale dhe organizatave civile sociale mund të bashkojë kapacitetet institucionale dhe ato private. Kjo qasje është esenciale për shërbimet sociale të gjithëpërfshirjes, të cilat shpesh ende kanë nevojë të realizohen. Do të zhvillohen të gjitha format e mundshme të bashkëpunimit përmes projekteve ndërkombëtare dhe partneritetit si dhe shpalljeve të konkurse vjetore për caqet e duhura (OPAK, OJQ-të, universitetet etj.). Kjo synon unitetin e shoqatave përmes aktiviteteve fuqizuese për shoqatat dhe partnerët e tyre, aktiviteteve të avokimit, krijimit të shërbimeve të reja, projekteve inovative dhe mbështetjes së zhvillimit, studimit dhe hulumtimit mbi kushtet e personave me aftësi të kufizuara. Në vitin 2011 do të zhvillohet një vlerësim i kualitetit dhe i kuantitetit të aksioneve me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit dhe të përfshirjes së Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) dhe OJQ-ve.

Aktiviteti 1.7 Avokimi për shërbime sociale cilësore në nivel të komunitetit dhe rritja e vetëdijes lidhur me këto shërbime në mesin e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre

Është me rëndësi për të zhvilluar fushata të informimit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe mbi objektivat e përmajtura në planin e veprimit. Kur të miratohet plani i veprimit, do të realizohen fushata të veçanta të informimit dhe të ngritjes së vetëdijes. Fushatat duhet të sigurojnë transmetime televizive, takime në zona të ndryshme të vendit, seminare mbi çështjet specifike, ngjarjet, broshura etj.

Në të njëjtën kohë, është me rëndësi për të ngritur vetëdijen për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara brenda njerëzve që vetë kanë aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre ne qëllim që të largohen paragjykimet dhe stigmat negative lidhur me të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, me një vëmendje të veçantë në ato aftësi të kufizuara të cilat i nënshtrohen diskriminimit të madh (personat të cilët nuk mund të përfaqësojnë vetveten, gratë me aftësi të kufizuara, fëmijët me aftësi të kufizuara etj.). Do të inkurajohen, në pajtim me këtë, projektet dhe aktivitetet e avokimit. Në vitin 2011 do të përkufizohet një vlerësim kuantitativ dhe kualitativ i aksioneve (fushatave, seminareve, konferencave, programeve televizive dhe atyre të radios, publikimeve, etj.).

2. Përmirësimi i standardit ekonomik të jetesës të personave me aftësi të kufizuara dhe i familjeve të tyre

Sistemi i ndihmës sociale duhet të zbatohet më mirë dhe, në disa raste, duhet të avancohet një pikëpamje e re për aftësitë e kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre do të përfshihen në strategjinë e MDG për të çrrënjosur varfërinë. Përfitimet e mbështetura në qasjen e bazuar në ndihmën në jetesën në komunitetin e vet do të përkufizohen, duke përfshirë të gjitha llojet e aftësive të kufizuara dhe duke siguruar shuma të azhurnuara dhe barazi të trajtimit për të njëjtat kushte të aftësive të kufizuara.

Aktiviteti 2.1 Reduktimi i shpenzimeve dhe i taksave për personat me aftësi të kufizuara dhe për familjet e tyre

Zbutja e varfërisë së personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre është një objektivi i cili duhet të arrihet në vitet e ardhshme për mbështetje të standardeve ekonomike më të mira të jetesës. Do të përkufizohet një numër i masave të adresuara për reduktimin e shpenzimeve shtesë si pasojë e aftësive të kufizuara. Në të njëjtin drejtim, do të merren masa specifike si dhe reduktimi i taksave kombëtare dhe lokale për të lehtësuar qasjen ndaj shërbimeve publike. Në vitin 2011, do të realizohet një vlerësim i rezultateve.

Aktiviteti 2.2 Përfshirja e të gjitha aftësive të kufizuara në skemën pensionale

Ngritja e standardit të jetesës së personave me aftësi të kufizuara mund të vazhdohet përmes zgjerimit të numrit të përfituesve të pensioneve, me azhurnimin gradual të sistemit.

Zgjerimi i llojit të personave me aftësi të kufizuara, i përfituesve, të cilët tash janë pjesërisht të përjashtuar, duhet të bëhet me personat e shurdhër, të verbër dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Një aksion tjetër, i cili shkon në drejtim të njëjtë, është indeksimi i personave në rritjen e shpenzimeve të jetesës.

Ngaqë shkak i aftësive të kufizuara varet nga kushte të veçanta dhe të ndryshme, kërkesa për barazim të të gjitha llojeve të pensioneve është legjitime. Barazimi i të gjitha pensioneve është parim i drejtësisë sociale; ato duhet të korrespondojnë me aftësi të kufizuara specifike dhe me situatë të pafavorshme sociale pavarësisht nga shkak.

Për të gjitha këto veprime, për shkak të dallimit mes burimeve pensionale dhe ekonomike në dispozicion do të përkufizohet një orar kohor me qëllim që të bëjë të mundur që gradualisht të arrihet ky rezultat. Në vitin 2011 do të zhvillohet një vlerësim vjetor i numrit dhe i llojit të përfituesve.

3. Krijimi dhe zbatimi i një kornize ligjore koherente për qasje të personave me aftësi të kufizuara në spektrin e gjerë të shërbimeve cilësore të komunitetit

Lidhja midis vizionit të ri mbi aftësitë e kufizuara, objektivave të planit të veprimit mbi aftësitë e kufizuara dhe kornizës legislative të Kosovës kërkon një azhurnim të ligjeve. Ky azhurnim duhet të fokusohet në ligjet lidhur me qasjet e reja mbi aftësitë e kufizuara, duke futur koncepte mbi të cilat është bazuar ideja mbi aftësitë e kufizuara, në veçanti në respektimin e të drejtave të njeriut (jo-diskriminimi, mundësitë e barabarta, gjithëpërfshirja sociale, përforsimi i kapaciteteve, kualifikimi ndaj qasjes në të drejta). Në të njëjtën kohë, të gjitha ligjet duhet të azhurnohen për të përfshirë të drejtat e personit me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të kenë qasje të barabartë ndaj drejtësisë.

Aktiviteti 3.1 Krijimi i një ligji sistematik të ndërlidhur me promovimin e gjithëmbarshtëm dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

Në pajtim me konceptin e ri mbi aftësitë e kufizuara, i tërë sistemi ligjor duhet të përfshijë ligje, akte nënligjore, udhëzime administrative dhe veprime ligjore me qëllim që të garantojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Krahas dispozitave të reja ligjore primare dhe sekondare, veprimet konkrete ligjore duhet të identifikohen me qëllim që të reagojë kundër shkeljeve të ligjit.

Ligjet sistematike mbi këtë çështje, në të cilën hartuesit e politikave, juristë, Ombudspersoni dhe avokatët mund të punojnë në nivele të ndryshme, e kanë qëllimin e përbashkët: t'i bëjnë efektive të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 3.2 Shqyrtimi dhe zbatimi i legjislacionit mbi personat me aftësi të kufizuara

Azhurnimi i ligjeve mbi personat me aftësi të kufizuara është një kriter që buron nga pikëpamja e re e kushteve të personit me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, azhurnimet e ligjeve mbi familjen dhe shërbimet sociale, mbi pensionet, mbi jetesën e pavarur, kriteret e vlerësimit, përkufizimin dhe akreditimin e shërbimeve sociale janë përcaktuar si prioritet që duhet të arrihet deri në vitin 2011.

Zbatimi i një politike mbi personat me aftësi të kufizuara kërkon përkufizimin e mjeteve që e bënë të mundshëm vlerësimin e gjendjes së aplikimit të politikave dhe të ligjeve. Kjo mund të arrihet me një raport periodik kombëtar mbi ligjet sociale dhe një konferencë kombëtare e cila e bënë të mundur raportimin nga të gjithë aktorët e përfshirë.

4. Decentralizimi

Një pjesë e rëndësishme e procesit të adaptimit të sistemit të gjithëpërfshirjes sociale të Kosovës është transferimi i shkathtësive dhe i aktiviteteve nga niveli qendror tek ai i territorit. Komunitetet duhet gradualisht të marrin autoritetin lidhur me çështjet sociale, posaçërisht ndërtimin, menaxhimin dhe monitorimin e sistemit të shërbimit social bazuar në mbështetjen e jetesës në komunitet dhe në pjesëmarrjen e plotë sociale.

Aktiviteti 4.1 Përfundimi i skicimit të shërbimeve të tashme sociale dhe hulumtimi mbi kushtet e jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të tyre

Të dhënat dhe informacionet që mungojnë lidhur me kushtet e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre mund të sigurohen me anë të një vargu të projekteve të hulumtimit të cilat e bëjnë të mundur njohjen me gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale, të krijuara dhe të menaxhuara nga asociacionet falë mjeteve financiare të donatorëve. Skicimi i shërbimeve sociale aktuale do të përfundojë në vitin 2009. Kjo do ta bëjë të mundshme vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efikasitetin e këtyre intervenimeve dhe mundësinë e futjes së tyre në një sistem të integruar të shërbimeve sociale midis atyre publike dhe private.

Në të njëjtën kohë, çështja e kushteve të personave me aftësi të kufizuara dhe e familjeve të tyre duhet të përfshihet në hulumtimin e përgjithshëm mbi kushtet e popullatës (varfëria, qasja ndaj të drejtave dhe shërbimeve etj.). Gjatë vitit 2011 do të përgatitet një numër i studimeve.

Aktiviteti 4.2 Përkufizimi dhe zhvillimi i akreditimit të ofruesve të shërbimeve dhe komponentët institucional mbi sigurimin e shërbimeve sociale

Krijimi i një sistemi të integruar të shërbimeve sociale kërkon përkufizimin e entiteteve që projektojnë, realizojnë, sigurojnë dhe menaxhojnë shërbimet të cilat kanë për synim personat me aftësi të kufizuara. Këto entitete, të cilat merren me shërbimet sociale, duhet të vlerësohen me qëllim që të sigurojnë akreditimin në regjistrin kombëtar. Sistemi i monitorimit, përcaktimit dhe vlerësimit duhet të preokupohet me karakteristikat kuantitative dhe kualitative të këtyre entiteteve. Në vitin 2011 do të miratohen udhëzimet për akreditimin.

Aktiviteti 4.3 Përkufizimi i përgjegjësive të ndryshme në nivel lokal në një kontekst të përzier të mirëqenies, duke përfshirë mekanizmat për kontraktimin dhe financimin e ofruesve të shërbimeve në nivel lokal

Në bazë të vlerësimit lidhur me të qenët adekuat dhe efikas të shërbimeve ekzistuese sociale, do të studiohet dhe vlerësohet mundësia e futjes së tyre në një sistem të integruar të shërbimeve sociale, në një mirëqenie të përzier midis asaj publike dhe private. Do të rregullohet përkufizimi i formës së kontratave dhe fondeve adekuate si dhe do të përkufizohen rregulla dhe udhëzime mbi shërbimet sociale gjatë vitit 2011.

MBROJTJA SOCIALE

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Përmirësimi i shërbimeve sociale, që reflektojnë të drejtat dhe liritë fundamentale të personave me aftësi të kufizuara	1.1 Ndryshimi i kriterëve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara në bazë të parametrave mjekësorë, ambientalë dhe socialë dhe përfshirja në komisionin e vlerësimit të kompetencave të tjera sociale	Grupi i veçantë i studimit i cili përfshin: MPMS (Dept. i Mirëqenies Sociale), OJQ-të, OPAK	Themelimi i grupit të studimit Propozimi i kriterëve të bazuara në qasjen e KNF dhe Konventën e KB	2009 2010	BKK 2009 KASH 2010 10.000 Euro
	1.2 Vazhdimi i deinstitutionalizimit dhe përmirësimi i qasjes ndaj shërbimeve të zhvilluar në pajtim me parimet e jetesës në komunitetin	Ministritë, Qeveria, OJQ-të, OPAK	Mbyllja e institucioneve të shëndetit mental, përkatësisht e Institutit Special në Shtime	2011	KASH 200.000 Euro
	1.3 Identifikimi dhe zhvillimi i standardeve cilësore kombëtare për shërbimet sociale, me qëllim të përgjigjes ndaj të drejtave dhe nevojave reale të personave me aftësi të kufizuara dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të tyre fundamentale.	MPDM, MPMS, Komunat, OPAK	Lista dhe përkufizimi i shërbimeve sociale	2010	KASH 10.000 Euro
	1.4 Krijimi i shërbimit të asistencës personale për jetesë të pavarur	Ministritë, Qeveria, OJQ-të, OPAK	Numri i përfituesve	2011	KASH 150.000 Euro
	1.5 Krijimi i programit të trajnimit të vazhdueshëm të personelit të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara	Qendrat për Punë Sociale, Ministritë, OJQ-të në bashkëpunim me Qeverinë	Numri i kurseve, përfshirja gjeografike dhe orari periodik	2011	KASH 20.000 Euro
	1.6 Përmirësimi i bashkëpunimit midis qeverisë, OJQ-ve dhe OPAK në procesin e sigurimit të shërbimeve sociale	MPMS, MTPT, Komunat, OJQ-të, OPAK	Kuantiteti dhe kualiteti i aksioneve për fuqizim të bashkëpunimit dhe përfshirje të OPAK dhe OJQ-ve	2011	Shpenzimet e ulëta të aktiviteteve KASH (pa kosto)
	1.7 Avokimi për cilësinë e shërbimeve sociale në nivel të komunitetit dhe rritja e vetëdijes lidhur me këto shërbime në kuadër të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre	MPMS, Komunat, OPAK	Kuantiteti dhe kualiteti i aksioneve (fushatat, konferencat, seminarët programet televizive dhe ato të radios , publikimet etj.)	2011	KASH 100.000 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
2. Përmirësimi i standardit ekonomik të jetesës së personave me aftësi të kufizuara dhe i familjeve të tyre	2.1 Reduktimi i shpenzimeve dhe i taksave për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), MEF, MSHP, Komunat, OPAK	Numri vjetor i përfituesve	2011	Shpenzimet e ulëta të aktiviteteve KASH 5.000 Euro
	2.2 Përfshirja e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në skemën pensionale	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), MEF, OPAK	Numri dhe lloji i përfituesve	2011	KASH 50.000 Euro
3. Krijimi dhe zbatimi i një komize ligjore koherente për qasjen e personave me aftësi të kufizuara ndaj një spektri më të gjerë të shërbimeve cilësore të komunitetit	3.1 Ndërtimi i kushteve sistematike të ndërlidhura me promovimin e gjithëmbarshtëm dhe me mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), Qeveria, OJQ-të, OPAK	Kuantiteti dhe kualiteti i aksioneve	2011	KASH 10.000 Euro
	3.2 Shqyrtimi dhe zbatimi i legjisllacionit mbi personat me aftësi të kufizuara	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), Kuvendi dhe Qeveria , OJQ-të, OPAK	Miratimi i i ligjeve përkatëse (kriteret e vlerësimit, jetesa pavarur, përkufizimi dhe akreditimi i shërbimeve sociale)	2011	Shpenzimet e ulëta të aktiviteteve KASH 3.000 Euro
4. Decentralizimi	4.1 Përfundimi i krijimit të skemës së shërbimeve të tashme sociale dhe hulumtimi i kushteve të jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe i familjeve të tyre	MPMS, MSHP, OJQ-të, OPAK dhe institucionet relevante	Numri i studimeve Numri i shërbimeve sociale dhe i përfituesve	2009	Buxheti komunal (shpenzimet që duhet të përkufizohen)
	4.2 Përkufizimi dhe zhvillimi i akreditimit të ofruesve të shërbimeve dhe kompetencave institucionale mbi sigurimin e shërbimeve sociale	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), MAQL, Qeveria, Komunat, OPAK	Udhëzimet për akreditim	2011	KASH 15.000 Euro
	4.3 Përkufizimi i përgjegjësive të ndryshme në nivel lokal në një kontekst të përzier të mirëqenies, duke përfshirë mekanizmin për kontraktimin dhe financimin e ofruesve të shërbimeve në nivel lokal	MPMS (Dept. i Mirëq. Soc.), MAQL, Qeveria, Komunat, OPAK	Rregullat dhe Udhëzimet mbi shërbimet sociale	2011	Buxheti komunal (shpenzimet që duhet të përkufizohen)

Shkurtesat

MPMS Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale

MSH Ministria e Shëndetësisë

MSHP Ministria e Shërbimeve Publike

MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MEF Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MTPT Ministria e Transportit dhe e Telekomunikimeve
OPAK Organizatat për Persona me Aftësi të Kufizuara
BKK Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KASH Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2011

6.6 QASJA

KONTEKSTI POLITIK DHE LEGJISLATIV

Qasja është një çështje e cila gërshetohet me të gjitha temat e tjera të cilat janë të përfshira në Planin e Veprimit. Në të vërtetë, qasja në ambientin fizik dhe qasja në informacione dhe komunikim (duke përfshirë teknologjinë) është tejet e rëndësishme për pjesëmarrjen e njëmendët të personave me aftësi të kufizuara në arsimim, shëndetësi, punësim, të drejta politike dhe civile, mbrojtje sociale etj. Në parim, qasja duhet të merret parasysh në secilën matricë të Planit të Veprimit, megjithëse, për arsye praktike të konceptualizimit dhe të implementimit, kjo pjesë do të mbulojë këtë çështje.

Korniza ligjore e ndërlidhur me qasjen përbëhet nga: Ligji mbi Ndërtimin 2004/15, me të cilin rregullohet sektori i ndërtimit i Republikës së Kosovës. Brenda fushëveprimit të këtij Ligji, janë shtuar më pas dispozita teknike dhe administrative 2007/33 “Dispozitat Administrative për tejkalim të barrierave arkitekturale” që përkufizojnë dhe rregullojnë hapat që duhet të merren me qëllim që të tejkalohen këto barrierë arkitekturale dhe informative.

Pos kësaj, Ligji mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 02/L-47, Neni 20, paragrafi 11, i ndryshuar me Rregulloren Nr. 2006/14, mbi shpalljen e Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës, parasheh që 5% e fondeve nga parapagimi të derdhen në Fondin mbi Ndihmën për Mediat e Grupeve për Minoritete, ato Shumetnike dhe Grupet e tjera në gjendje të pafavorshme. Kjo bëhet me qëllim që personat me aftësi të kufizuara po ashtu të mund të përfitojnë nga kjo dispozitë, me qëllim që të kenë qasje në informim publik të programeve të radios dhe televizionit. Mirëpo, prapëseprapë, në Kosovë nuk ka dispozita të ndërlidhura me standardet e qasjes në Teknologjitë e Informimit dhe të Komunikimit (TIK)

TË DHËNA

Grupi punues tematik mbi qasjen nuk ka mundur të gjejë kurrfarë të dhënash në dispozicion në lidhje me qasjen në ndërtesat dhe infrastrukturën publike, në shërbime ose ndërtesa private të hapura për publikun. Megjithatë, ekzistojnë iniciativa interesante në nivel komunal, posaçërisht për projektet e mbështetura nga UN-HABITAT në Pejë. Gjatë periudhës e cila mbulohet me Planin e Veprimit kjo iniciativë duhet të monitorohet dhe përvoja e saj duhet të bartet te komunat e tjera. Ne sugjerojmë që azhurnimi i ardhshëm i Planit të Veprimit në mënyrë të kujdesshme të përqendrohet në këto përvoja.

BURIMET FINANCIARE

Në kontekstin e KASH ishte e pamundur të identifikohet ndonjë linjë buxhetore e lidhur në mënyrë specifike për ndërtimin e ri ose heqjen e pengesave arkitekturale e as për qasjen në informim ose komunikim.

Sidoqoftë, për shkak të rëndësisë ndër-sektoriale të qasjes, grupi punues tematik është pajtuar se mënyra më e arsyeshme është për ta përfshirë qasjen në rrjedhën e përgjithshme të të gjitha projekteve të ndërtimeve të reja dhe të renovimeve të financuara nga KASH. Në të vërtetë, sfidat e qasjes duhet të adresohen me miratimin e normave të përmbajtura në 2007/33 “Dispozitat Administrative për tejkalimin e pengesave arkitekturale” në të gjitha ndërtimet e reja dhe renovimet që duhet të financohen nga KASH pa ose me shpenzime shumë të pakta. Ekzistojnë dëshmi se shpenzimet e qasjes në shkollat e reja në përgjithësi janë më pak se 1% të totalit të

shpenzimeve të ndërtimit²⁵. Në mënyrë të ngjashme, të gjitha punimet civile që bëhen në ambientet urbane ofrojnë shanse pa shpenzime plotësuese për të rritur qasjen nëpër qytete.

Tabelat e mëposhtme japin një ide të disa prej linjave kryesore të buxhetit të ndërlidhura me infrastrukturën, ku qasja duhet të adresohet pa ndarje të mjeteve shtesë.

Transporti dhe infrastruktura Projektet financiare të përfshira në KASH, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	Total 2009-2011
Burimi financiar KASH: Meremetimi dhe ndërtimi i ri i rrugëve, autostradave dhe urave	70.0	82.0	139.3	291.3
Burimi financiar - donatorët:				
Rrugët dhe autostradat	46,5	52,0		98.5
Pajimet e TI	9.3	14,1	8.9	32.3
Transporti publik	1.6	2.0	2.0	5.6
1 – Tërë sektori i transportit	127,4	150.1	150.2	427.7
HEKURUDHAT				
Burimi financiar KASH	4.5	5.5	6.5	16.5
Burimi financiar Donatorët	2.0	1.5	1.0	4.5
2 – I tërë sektori i hekurudhave	6.5	7.0	7.5	21.0
I tërë transporti dhe hekurudha (1+2)	133.9	157.1	157.7	448.7

Arsimi Financimi i projekteve të përfshira në KASH, në milion euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	Total 2009-2011
Ndërtimi i hapësirave të reja të shkollës (për punë kryesisht në dy ndërrime)	18.3	18.3	14.5	51.2
Riparimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	3.6	5.1	6.1	14.8
Krijimi dhe pajisja e qendrave kompjuterike me pajimet e duhura	2.2	2.2	2.2	6.5
Pajisja e objekteve shkollore me laborator dhe pajimet e tjera laboratorike	2.4	2.6	4.1	9.0
Shpërndarja e librave shkollore falas për nivelin primar dhe familjet e varfra	2.5	2.5	2.5	7.5
Pajimet e TI	0.3	0.5	0.7	1.5
Modernizimi i rrjetit të bibliotekave	0.4	0.3	0.3	1.0
Ndërtimi i objekteve të reja universitare dhe riaktivizimi i atyre ekzistuese	5.2	5.5	9.5	20.2
Krijimi i sistemit të të mësuarit elektronik ose në distancë dhe krijimi i qendrave të kompjuterëve	0.2	0.1	0.1	0.3
Total	35.0	37	40.0	112.00

Shëndetësia Financimi i projekteve të përfshira në KASH, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	Total 2009-2011
------------	------	------	------	--------------------

²⁵ Shkollim për të gjithë: Shpenzimet e qasjes, Shënime mbi arsimimin, Banka Botërore (World Bank) 2005

Burimi financiar - KASH: Renovimi i Institucioneve dhe i Objekteve Shëndetësore	2.6	0.5	0.3	3.4
Ndërtimet e reja	0.0	4.4	7.7	12.1
Burimi financiar – donatorët:				
Ndërtimet e reja	2,5	2,5	2.5	7.5
Total	5.1	7.4	10.5	23.0

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Janë identifikuar gjashtë objektiva dhe aktivitete përkatëse për implementim:

1. Implementimi dhe zbatimi i ligjit ligjit për ndërtimet nr.2004/15 dhe i udhëzimeve administrative të tashme (2007/33) mbi qasjen në të gjitha ndërtimet e reja dhe renovimet e ndërtesave publike dhe të ndërtesave të hapura për publikun;
2. Ndihma teknike dhe decentralizimi;
3. Qasja në institucione dhe objekte publike, hapësira publike dhe shërbime të hapura për publikun për personat me aftësi të kufizuara;
4. Përmirësimi i qasjes dhe i sigurisë në transportin dhe infrastrukturën publike;
5. Qasja në komunikime dhe teknologji informative (shih KMDPAK neni . 3, 9, 21 dhe 32) dhe
6. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve.

1. Implementimi dhe zbatimi i ligjit për ndërtimet nr.2004/15 dhe i udhëzimeve aktuale administrative (2007/33) mbi qasjen

Objektivi kryesor është adresimi i mungesave normative që janë shfaqur gjatë takimeve të përpamë lidhur me përmbajtjet e udhëzimeve aktuale teknike dhe administrative.

Aktiviteti 1.1 Përfshirja e udhëzimeve administrative dhe hollësive teknike në tenderët dhe kontratat për kompanitë ndërtuese dhe projektuesit.

Korniza ekzistuese ligjore nuk është e zbatuar qoftë si rezultat i injorancës nga ana e ndërtuesve qoftë si mungesë e kontrollit dhe e zbatimit nga ana e zyrave të ndryshme administrative. Me qëllim që të arrihet ky objektivi, do të jetë e domosdoshme për të integruar udhëzimet ekzistuese administrative dhe kërkesat teknike në dokumentet e ofertimit dhe në kontratat dhe për t'i inkuadruar ato si kushtëzime për lëshimin e lejeve të ndërtimit.

Aktiviteti 1.2 Realizimi i një doracaku me normativa dhe udhëzime

Integrimi i këtyre udhëzimeve në tender dhe kontrata do të shoqërohet me krijimin e një doracaku ose manuali teknik, me qëllim të përplotësimit të ligjit ekzistues, me ilustrime, grafika, diagrame, vizatime, simbole ndërkombëtare dhe çfarëdo tjetër që është e nevojshme për të përplotësuar ose për ta bërë të qartë përmbajtjen e udhëzimeve dhe të ligjeve ekzistuese. Doracaku do të jetë një ndihmë praktike për ekspertët teknikë të specializuar si dhe për këshilluesit dhe cilindo person të interesuar (duke përfshirë Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara).

Aktiviteti 1.3 Realizimi i Faqes së Internetit dhe i DVD-së për normativat dhe udhëzimet teknike

Përmbajtja e ligjeve dhe e rregulloreve si dhe e manualit të lartpërmendur do të jetë në dispozicion në Faqe të Internetit dhe në DVD. Faqja e Internetit do të mundësojë qasjen përmes linjës elektronike (on-line), derisa DVD do të mundësojë qasjen në informacione pa

internet. Faqja e internetit përherë do të freskohet me informacionet e fundit. Ajo do të raportojë ligjet e veçanta dhe udhëzimet ashtu siç janë të ndërlidhura me secilën prej kategorive të ndryshme (qasja, plani urban, shtigjet taktile, platformat etj.) dhe do të sigurojë referenca në praktikatat më të mira ndërkombëtare²⁶, për t'u përdorur si sugjerime për specifikimet teknike që nuk janë të përfshira në kornizën ligjore të Kosovës. Organizatat ndërkombëtare që e kanë vijuar takimin kanë shprehur interesimin dhe gatishmërinë për të financuar zhvillimin e aksioneve 1.2 dhe 1.3.

2. Përmirësimi i ndihmës teknike në nivel qendror dhe lokal

Objektivi i dytë është ndërtimi i kapacitetit të qasjes dhe krijimi i një sistemi për implementimin e ligjeve. Kjo përfshin ndërtimin e shkathtësive teknike, shpërndarjen e diturisë, implementimin dhe zbatimin e rregullave dhe të rregulloreve si dhe zbatimin e dënimeve në raste të shkeljeve. Kjo do të kërkojë një transferim të këtyre detyrave dhe përgjegjësive tek autoritetet lokale.

Aktiviteti 2.1 Ngritja e kapaciteteve për çështje të qasjes (trajnimi i trajnerëve)

Përmes shfrytëzimit të këshilltarëve ndërkombëtarë nga universitete të mirënjohura dhe të profesionistëve në dispozicion në Kosovë, kurset e trajnimit mbi çështjet e qasjes do të ofrohen për krijim të një ekipi të parë të ekspertëve teknikë, me njohuri të përgjithshme mbi qasjen arkitekturale, teknologjinë informative dhe dizajnin universal. Ky ekip i parë i ekspertëve teknikë do të luajë rolin e pikave qendrore interne për ministri dhe komuna të ndryshme të përfshira në qasjen dhe më vonë do të specializonte në pajtim me fushat e tyre të përcaktuara të përgjegjësive (transporti, arsimi, planifikimi i qytetit, infrastruktura, komunikimet etj.).

Aktiviteti 2.2 Trajnimi i ekspertëve mbi çështjet e qasjes në rajone dhe komuna

Ekipi i parë i ekspertëve i trajnuar në çështje të qasjes do të sigurojë trajnimin për grupet e tjera duke krijuar, kështu, disa ekipe të teknikëve në qeveritë lokale (në rajone dhe komuna). Këto grupe do të kenë përgjegjësinë, në territoret e tyre, për të verifikuar fazat e ndryshme të projekteve të lidhura me zhvillimin e intervenimeve të reja publike dhe / ose shërbimeve të hapura për publikun si dhe riparimin dhe përshtatjen e objekteve ekzistuese publike dhe / ose të hapësirave ku lejohet publiku.

Aktiviteti 2.3 Krijimi i një grupi të ekspertëve për implementim të ligjit në koordinim me personelin përkatës ligjor

Një grup i ekspertëve teknik mbi çështjet e qasjes duhet të mbështes personelin juridik komunal përmes sigurimit të informacionit specifik dhe teknik dhe sugjerimeve për të implementuar ligjet; ekspertët teknik do të jenë një burim i dobishëm për të azhurnuar komunat lidhur me ligjet dhe rregulloret e kohëve të fundit mbi qasjen në mënyrë që rinovimi ose krijimi i objekteve / i infrastrukturës të mund të realizohet në pajtim me ligjet mbi standardet e qasjes.

3. Përmirësim i qasjes në institucione dhe objekte publike, hapësira publike dhe shërbime të hapura për publikun

Objektivi i tretë ka për synim sigurimin e qasjes për të gjithë shfrytëzuesit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, në të gjitha objektet publike si dhe shërbimet dhe zonat e hapura për publikun përmes zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese të qasjes dhe zbatimit të standardeve ekzistuese ndërkombëtare, siç është E3C për qasjen në faqe të internetit.

²⁶ “Praktikat më të mira ndërkombëtare në Dizajnin Universal” Një vështrim Global – Mars 2006, Komisioni për të Drejta të Njeriut i Kanadasë në dispozicion në www.gaates.org

Aktiviteti 3.1 Mundësimi i qasjes në ashensorë, dysheme të rrafshuara, shtigje taktile, shkallë të lëvizshme (platformave), parking, dritave në trafik, në objekte lëvizëse, etj.

Të qenët në dispozicion i ashensorëve të arritshëm, i sipërfaqeve të flluskuara, shtigjeve taktile (të prekshme) ose i shenjave për personat me dëmtime vizuale, i shkallëve ose platformave lëvizëse që janë në pajtim me standardet e gjerësisë, gjatësisë dhe pjerrtësisë, shenjat audio për këmbësorët; parkingjet e rezervuara etj., duhet të karakterizojnë secilin lloj të objekteve publike (ministritë, shkollat, stacionet e autobusëve dhe të trenave, aeroportet, spitalet, bibliotekat, muzetë, stadiumet, entitetet publike, infrastrukturën urbane, mjetet publike të transportit) dhe /ose zonat private të hapura për publikun (dyqanet, hotelet, bankat, teatrot, komplekset sportive, klinikat, restorantet, palestrat, sallat e kinemave, kishat, klubet shoqërore, mjetet private të transportit etj.). Procesi do të jetë në rritje e sipër, duke filluar me ndërtimet e reja dhe renovimet e mëdha të objekteve / infrastrukturës.

Aktiviteti 3.2 Kushtëzimi i licencës për shërbime të hapura për publikun dhe ndërtime të reja me respektimin e qasjes

Dhënia e licencave dhe, madje, edhe miratimi i projekteve për zhvillimin dhe ristrukturimin e objekteve publike ose të hapësirave do të varen dhe do të kushtëzohen nga miratimi që lëshohet nga zyrat teknike të ngarkuara me përgjegjësinë e verifikimit të respektimit të ligjeve dhe rregulloreve mbi standardet e qasjes.

Aktiviteti 3.3 Dënimet për mosrespektimin e standardeve të qasjes

Me qëllim që të sigurohet zbatimi i ligjeve të qasjes, është rekomanduar që për kontraktuesit (projektuesit, kompanitë ndërtimore që marrin përsipër projektin, shefat e projekteve) të përcaktohen sanksione administrative dhe monetare si dhe bashkë-përgjegjësi për teknikët nga ministritë dhe komunat të përcaktuar për mbikëqyrje, për pronarët e bizneseve komerciale, kulturore dhe sociale.

Aktiviteti 3.4 Përfitimet (financiare ose fiskale) për intervenimet e qasjes në çdo objekt dhe vende të hapura publike

Intervenimet për përshtatje të standardeve të qasjes të objekteve ekzistuese dhe shërbimeve ose të pjesëve të tyre (p.sh., hyrjet me shkallë), ose banimet private ose pjesët e tyre (p.sh., banjat ose dyert e një apartamenti të blerë nga një person me aftësi të kufizuara) mund të përfitojnë nga lehtësirat financiare ose fiskale të ofruara nga ministritë kompetente dhe komunat pas verifikimit të buxhetit të vlerësuar dhe verifikimit të ekzekutimit të duhur të intervenimit.

4. Përmirësimi i qasjes dhe i sigurisë në transportin dhe në infrastrukturën publike

Objektivi i katërt i cili duhet të arrihet, për të gjitha llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara, është shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të transportit publik dhe infrastrukturës përkatëse, siç janë rrugët dhe rrjeti i rrugëve urbane dhe lokale. Të gjitha nga këto që përmenden më lart do të bëhen duke marrë parasysh faktorin e sigurisë dhe masat e tjera specifike lidhur me të gjithë shfrytëzuesit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 4.1 Blerja e mjeteve të qasshme të transportit kur bëhet zëvendësimi i atyre të vjetrave

Kurdo që mjetet e reja të sistemit të transportit zëvendësohen me të reja, automjetet e reja (autobusët, taksitë etj.), duhet patjetër t'i kenë specifikat teknike në përputhje me standardet e qasjes.

Aktiviteti 4.2 Plani vjetor për futjen e elementeve të qasjes në çështjet urbane dhe nën-urbane

Intervenimet për një qasje të përmirësuar në zonat urbane, siç janë rrugët e reja dhe rinovimi i sistemit të rrugëve, në transportet urbane dhe lokale duhet të inkuadrohen në një Plan Vjetor për infrastrukturën dhe transportin. Në përpunimin e planit të tillë, Ministrinë dhe Komunitet duhet të këshillohen me organizatat e personave me aftësi të kufizuara që përfaqësojnë të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, për të identifikuar nevojat, prioritetet dhe zgjidhjet e qëndrueshme. Plani do të hartojë një program vjetor të intervenimeve që në mënyrë specifike kanë për synim qasjen në zonat urbane dhe lokale dhe sistemin e transportit publik.

Aktiviteti 4.3 Mirëmbajtja dhe rindërtimi i sistemit të rrugëve

Në pajtim me Planin Vjetor për Infrastrukturë dhe transport, (nën. 4.2) mirëmbajtja dhe ristrukturimi i sistemit të rrugëve kërkon prioritet, siç është mbushja e gropave, rrafshimi i gropave në rrugë, ndërtimi i qasshëm i rrugëve të shtruara në rrugët urbane dhe jashtë-urbane dhe ngjashëm. Komunitet duhet të mbajnë nën vëzhgim qarkullimin privat dhe publik dhe kujdesin për sigurinë e rrugëve si dhe garantimin e respektimit të rregullave të trafikut.

Aktiviteti 4.4 Blerja e karrocave të vogla për personat me aftësi të kufizuara për t'i vendosur personat me aftësi të kufizuara në aeroplan në aeroport

Karrocat specifike për personat me aftësi të kufizuara, ulësja dhe timoni i të cilave është më i vogël se sa ato të karrocave të tilla të zakonshme, i mundësojnë personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë mundësi për të ecur, të hyjnë në aeroplan dhe të ulen në vendet e tyre. Këto karroca mund të sigurohen në aeroporte dhe të sigurojnë shërbimin me një çmim të lirë. Personat me aftësi të kufizuara fizike po ashtu kanë nevojë për një karrocë me ngritës – i cili mund t'i lëviz ata në aeroplan dhe t'i shtyj ata në nivelin e ulëseve pa i ngjitur shkallët.

5. Sigurimi i qasjes në informacione dhe teknologji të komunikimit

Qasja në informacione dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjinë, është kyçe po aq sa edhe qasja në një ambient të ndërtuar (qasja fizike). Së këndejmi, qasja në teknologji të informimit dhe në faqe të internetit përbën objektivin e pestë të planit.

Aktiviteti 5.1 Sigurimi i mbështetjes dhe shenjave të përshtatshme në infrastrukturën dhe shërbimet publike

Sigurimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve publike sipas sistemit të Brajlit (Braille), hartave taktile, shenjave të konfiguruar në formatet adekuate që i përshtaten nevojave të leximit nga personat me dëmtime vizuale dhe vështirësi të dëgjimit si dhe formave të tjera të aftësive të kufizuara (siç janë shenjat vizuale dhe dëgjimore tek stacionet e autobusit dhe në mjete publike të transportit), shkurtimisht, të gjitha instrumentet tashmë të përdorura në shumë vende dhe të krijuara sipas standardeve ndërkombëtare të favorshme për qasjen efikase dhe përmirësimin e përgjithshëm të kualitetit të jetës.

Aktiviteti 5.2 Sigurimi i mbështetjes së përshtatshme për të garantuar të drejtën e votës dhe pjesëmarrjen në jetën politike

Në pajtim me të drejtën për vendime të informuara dhe të drejtën për të marrë pjesë në jetën politike, zgjedhjet e ardhshme politike duhet të marrin parasysh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara lidhur me pjesëmarrjen aktive dhe pasive në jetën politike.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje për të ushtruar të drejtat e tyre ndaj lirisë së shprehjes dhe të mendimit dhe kjo po ashtu përfshin lirinë e kërkimit, të pranimit, të këmbimit dhe të sigurimit të informatës nga dhe për qytetarët. Mundësitë e tilla të barabarta, së këndejmi, do të garantohen përmes shfrytëzimit të mjeteve të duhura të komunikimit lirshëm të përzgjedhura nga personat me aftësi të kufizuara në kuadër të

ushtrimit të plotë të drejtave të tyre. Megjithatë, para përkufizimit të veprimeve specifike, siç janë fletëvotimet zgjedhore në sistemin e shenjave të Brajlit ose shtypi i madh në të zeza, është bërë e qartë nevoja për të pasur në dispozicionin tonë, në forma të qasshme dhe përmes teknologjive të aplikueshme për secilin lloj të aftësisë së kufizuar, informacione që vihen publikisht në dispozicion. Kjo mund të realizohet pa shpenzime plotësuese për shfrytëzuesin, tipologjia e të cilit kërkon përdorimi e gjuhës së shenjave, kodifikimin në sistemin e shenjave të Brajlit që është shfrytëzim i komunikimit alternativ.

Aktiviteti 5.3 Sigurimi i mbështetjes së përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen e plotë në jetën publike

Personat me aftësi të kufizuara, po ashtu, gëzojnë të drejtën që plotësisht të marrin pjesë në jetën publike. Kjo do të thotë, së pari, se ata duhet të jenë të informuar mbi të gjitha aktivitetet të cilat zhvillohen përmes masmediave të qasshme. E dyta, ata duhet të marrin pjesë në iniciativat e ndryshme në secilën fushë, siç janë: ngjarjet kulturore, aktivitetet sportive, si dhe të gjitha ngjarjet publike. Vizioni i ri i personave me aftësi të kufizuara duhet të inkurajojë institucionet publike dhe kompanitë private, të përfshira në organizimin e ngjarjeve të tilla, për të krijuar akomodimin e arsyeshëm me qëllim të lehtësimit dhe të garantimit të pranisë dhe të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 5.4 Krijimi i një stacioni të punës multimedial të qasshëm në secilën komunë

Me qëllim që të lehtësojë qasjen në informim dhe komunikim, secila komunë duhet të pajiset së paku me një stacion pune të qasshëm multimedial, përmes sigurimit të kompjuterit me modelin e teknologjive ndihmëse për qasje në informacione për personat me aftësi të kufizuara. Shpenzimet e përgjithshme të themelimit të një stacioni të punës të qasshëm mund të sillen mes 5 -10 000 Euro.

Aktiviteti 5.5 Miratimi i standardeve të qasjes së faqes standarde të internetit E3C duke përfshirë këtë dispozitë në tenderë dhe në kontrata publike

Të gjitha faqet e reja të internetit, të Qeverisë lokale dhe të asaj qendrore dhe të entiteteve publike, duhet të zbatojnë qasjen standarde të internetit E3C. Ky objektivi lehtë mund të ndiqet duke përfshirë dispozitën e tillë në tenderët publikë dhe kushtet e kontratave.

Aktiviteti 5.6 Pranimi i përdorimit të gjuhës së shenjave

Shfrytëzimi i interpretëve profesionalë të gjuhës së shenjave, që do t'u mundësojë të shurdhërve të kenë qasje në komunikime, është adresuar nga të gjitha grupet punuese tematike. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara, mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, plani i veprimit e pranon shfrytëzimin e gjuhës së shenjave si një instrument të domosdoshëm i cili ka për synim të garantojë që personat e shurdhër ta kenë në dispozicion krahas qasjes në mjete të ndryshme të komunikimit.

Aktiviteti 5.7 Realizimi i një softueri lexues nga ekrani në gjuhët zyrtare të Kosovës

Softueri për leximin e tekstit është i modeluar për personat me dëmtime vizuale që të kenë qasje në informata. Krijimi i një softueri të tillë mund të realizohet në bashkëpunim me vendet e tjera të cilat kanë gjuhë të përbashkëta me një investim modest, por me një ndikim të madh mbi shfrytëzuesit. Lexuesit e ekranit janë të mësuar me të gjitha llojet e aktiviteve sociale dhe ekonomike, duke përfshirë arsimimin dhe punësimin. Organizatat e njerëzve me aftësi të kufizuara duhet të jenë në mënyrë aktive të përfshira në realizimin e një softueri (programi) të tillë dhe organizatat ndërkombëtare do të mund të financonin shpenzimet përkatëse posaçërisht nëse nga projekti do të përfitonin disa vende.

6. Përmirësimi i trajnimit

Aktiviteti 6.1 Trajnimi i shërbyesve civilë me qëllim të lehtësimit të qasjes së personave me aftësi të kufizuara

Trajnimi themelor i personelit të aftë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe për t'u siguruar informacione në vendet me trafik të ngjeshur të këmbësisë, siç janë aeroporti, stacionet e trenit, терминаlet e autobusëve, qendrat e mëdha tregtare, muzetë, bibliotekat, është identifikuar si objektivi i gjashtë dhe i fundit i projektit të parë të Planit të Veprimit Kombëtar. Trajnimi i tillë mund të realizohet me formate të ndryshme (faqe interneti, video, publikimet e vogla).

QASJA

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Implementimi i ligjit për ndërtimet nr.2004/15 dhe i udhëzimit administrative të tashëm (2007/33) mbi qasjen fizike.	1.1 Futja e udhëzimeve administrative dhe hollësive teknike në tenderët dhe kontratat për kompanitë ndërtimore dhe projektuesit.	MMPH, MSHP, Komunat	Numri i tenderëve dhe kontratave të krijuara në pajtim me rregulloren.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta (pa shpenzime)
	1.2. Realizimi i një doracakut të plotë të normativave dhe udhëzimeve teknike.	MMPH, MSHP,	Përfundimi i manualit.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5.000 Euro
	1.3 Realizimi i faqes së internetit lidhur normativat teknike, legjislativë dhe udhëzimet administrative.	MMPH, MSHP, OJQ-të	Faqja aktive e internetit, e shpallur dhe numri i vizitorëve.	2010	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 10.000 Euro
2 Përmirësimi i ndihmës teknike në nivel qendror dhe lokal.	2.1 Ngritja e kapaciteteve për çështje të qasjes (trajnimi i trajnerëve)	MMPH, UP (Fakulteti i Edukimit dhe i Arkitekturës), Agjencia Akredituese, MAPL. MPTK, komunat, OJQ-të	Numri i personave të trajnuar.	2011	KASH 10.000 Euro
	2.2 Trajnimi i ekspertëve mbi çështjet e qasjes në rajone dhe komuna	MMPH, MAQL. MPTK, komunat, OJQ-të	Numri i personelit të krijuar.	2010	KASH 10.000 Euro
	2.3 Krijimi i një grupi të ekspertëve për implementim të ligjit në bashkëpunim me personelin përkatës ligjor.	MAPL. MPTK, komunat,	Themelimi i grupit të ekspertëve.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta (pa shpenzime)

Plani Kombëtar i Veprimt për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
3. Përmirësimi i qasjes në institucione dhe hapësira publike si dhe shërbime publike.	3.1 Vënia në dispozicion e ashensorëve, shtigjeve taktile, dyshemeve të rrafshuara të qasshme, shkallëve lëvizëse, parkingjeve, dritave të trafikut, pajimeve.	MAPL, MPTK, komunat,	Numri i strukturave të instaluar në baza vjetore.	2011	KASH (Obj. 4.6.1) 100 000 Euro
	3.2 Licencimi për shërbimet e hapura për publikun, ndërtimet e reja dhe shqyrtimi i respektimit të standardeve të qasjes.	Komunat	Numri i licencave që respektojnë standardet e qasjes.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta (pa shpenzime)
	3.3 Ndëshkimet për mosrespektimin e standardeve të qasjes.	Komunat	Numri i ndëshkimeve.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta (pa shpenzimet)
	3.4 Përfitimet (p.sh., zvogëlimi i taksave) për intervenimet e lidhura me qasjen për meremetimin e objekteve dhe të ambienteve të hapura publike.	MMPH, Komunat	Numri i përfituesve dhe numri i përfitimeve.	2010	Aktivitetet me shpenzime të ulëta 20.000 Euro
4. Përmirësimi i qasjes dhe i sigurisë në transportin dhe infrastrukturën publike.	4.1 Blerja e mjeteve të reja të transportit me qëllim të zëvendësimit të atyre të vjetrave.	MMPH, Komunat, Ndërmarrja private	Numri i automjeteve të blera në baza vjetore.	2010	KASH (Obj.4.2.3) 100.000 Euro
	4.2 Plani vjetor për futjen e elementeve të qasjes në çështjet urbane dhe lokale.	MMPH, MAPL, Komunat	Hartimi i Planit Vjetor.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5.000 Euro
	4.3 Sistemi i mirëmbajtjes dhe i rindërtimit të rrugëve.	MMPH, MAPL, MPTK Komunat	Numri i intervenimeve rindërtuese.	2011	KASH 300 000 euro
	4.4 Blerja e karrocave të vogla për vendosjen e personave me aftësi të kufizuara në aeroplan në aeroport.	MPTK, Aeroporti	Karrocet e blera për PAK	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5.500 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
5. Garantimi i qasjes në teknologjinë informative dhe komunikacion.	5.1. Sigurimi i shenjave të përshtatshme dhe ndihma në shërbimet dhe në infrastrukturën publike.	MTP, MMPH, MSHP, MAPL Komunat, Shoqata e Tregtarëve	Numri dhe llojet e shërbimeve publike të vëna në dispozicion.	2011	KASH 30.000 Euro
	5.2 Sigurimi i ndihmës së përshtatshme me qëllim të garantimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në jetën politike.	MPB, MSHP, Komunat, OJQ-të	Përqindja e personave me aftësi të kufizuara që votojnë ose marrin pjesë në jetën politike.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 10.000 Euro
	5.3 Sigurimi i ndihmës së përshtatshme me qëllim të garantimit të së drejtës së pjesëmarrjes së plotë në jetën politike.	Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, MSHP, MAPL, MKRS, Komunat	Ndihma e përshtatshme e siguruar.	2011	KASH 50.000 Euro
	5.4 Krijimi i një stacioni të punës multimedial të qasshëm në secilën komunë	MAQL, Komunat, OJQ-të	Numri i stacioneve të krijuara në baza vjetore.	2011	KASH 259.000 Euro
	5.5 Zbatimi i standardit të Faqes së Internetit E3C duke përfshirë sigurimin e tenderëve publikë dhe të kontratave.	MPTK	Përqindja e kontratave të shpërblyera që përfshin dispozitat e tilla.	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta BKK-KASH 5.000 Euro
	5.6 Pranimi i përdorimit të gjuhës së shenjave.	Kuvendi, OJQ-të, OPAK	Hartimi i ligjit.	2010	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 3.000 Euro
	5.7 Realizimi i softuerit (programit) të ekranit për lexim në gjuhët zyrtare të Kosovës.	MPTK, MASHT, OJQ-të	Programi (softueri) i realizuar.	2009	BKK-KASH 25.000 Euro
6.Përmirësimi i trajnimit.	6.1 Trajnimi i personelit të shërbimit publik për të lehtësuar qasjen e personave me aftësi të kufizuara.	MSHP (IKAP), Kompanitë që sigurojnë Shërbime, OJQ-të, OPAK	Numri i kurseve të mbajtura. Numri i personave të trajnuar.	2010	KASH 10.000 Euro

Shkurtesat

MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MTTK	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
MAPL	Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MASHK	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike (agjenci ekzekutive e MSHP)
Ë3C	Konzorciumi Anekënd Botës për zhvillim të standardeve, protokolleve dhe udhëzimeve
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2011

6.7 TË DHËNA STATISTIKORE

KONTEKSTI POLITIK DHE LEGJISLATIV

Mbledhja e të dhënave në Republikën e Kosovës është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/04, e hyrë në fuqi nga 2 korriku 2001 dhe tash në revidim e sipër. Kjo Rregullore autorizon Entin Statistikor të Kosovës (ESK) si entitet përgjegjës për mbledhjen dhe analizën, e të dhënave me misionin e pajisjes së shfrytëzuesve dhe të hartuesve të politikave me të dhëna të dobishme të paanshme dhe të dhëna statistikore me qëllim që ata të sjellin vlerësime dhe vendime të mbështetura në informacione.

Qëllimi kryesor i Entit Statistikor të Kosovës është mbledhja, analiza dhe shpërndarja e të dhënave statistikore demografike, sociale dhe ekonomike në pajtim me standardet ndërkombëtare të statistikave dhe të klasifikimit.

ESK është i obliguar të ruajë konfidencialitetin përkitazi me shfrytëzimin e informacioneve individualisht të mbledhura vetëm për qëllime statistikore. ESK duhet të garantojë se shpërndarja e të dhënave përmes zonave gjeografike nuk do të lejojë identifikimin e respondentëve individual.

TË DHËNAT

Nga një hulumtim preliminar, duket se në mbledhjen e të dhënave administrative mbi personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës përfshihen si më poshtë:

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka të dhëna të detajuara mbi pensionet e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë të shpërndara në nivel komunal dhe sipas aspektit gjinor;
- Në nivel komunal, Zyrat e Punës kanë të dhëna në lidhje me aplikacionet e dorëzuara për punësim nga personat me aftësi të kufizuara;
- Ministria e Arsimit ka të dhëna mbi shtatë shkolla speciale dhe mbi klasat e bashkëngjitura që janë pjesë e sistemit të rregullt shkollor. Këto të dhëna shpërndahen sipas gjinisë dhe të llojit të aftësive të kufizuara. Pos kësaj, ekzistojnë të dhëna mbi arsimtarët dhe personelin ndihmës arsimor për shkollat speciale dhe klasat e bashkëngjitura.

Fare qartë, nuk ka të dhëna administrative në dispozicion në nivel komunal lidhur me shërbimet sociale të siguruar dhe as nivelin e plotësimit të nevojave të shfrytëzuesve.

Sot e kësaj dite, ESK nuk mbledh as nuk shpërndan në mënyrë sistematike të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara.

BURIMET FINANCIARE

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2009-2011 ka vetëm një linjë specifike të buxhetit lidhur me Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Ekonomive Familjare, por jo edhe bazë për aksione të veçanta për mbledhjen e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Duhet të theksohet se revidimi i ri i KASH duhet të marrë parasysh këto nevoja.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Janë identifikuar dy objektiva parësore dhe aksione të ndërlidhura me këtë:

1. Mbledhja e informacioneve të duhura për të mundësuar formulimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave mbi personat me aftësi të kufizuara.

Objektiivi kryesor është të zhvillohet një Sistem i Informimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (SIPAK), i cili ka për qëllim vlerësimin e zbatimit të politikave, identifikimin dhe adresimin e barrierave me të cilat

ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në realizimin e të drejtave të tyre. Informacionet e mbledhura duhet të shpërndahen në mënyrën e duhur²⁷.

Ky sistem, po ashtu, do t'i vë në dispozicion të dhënave statistikore për shfrytëzues të ndryshëm, siç janë OPAK, OJQ-të, hulumtuesit, mas mediat etj.

Aktiviteti 1.1 Analizimi dhe identifikimi i indikatorëve të nevojshëm për të ndërtuar një sistem të integruar të mbledhjes së të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara

Elementi i parë është identifikimi i hollësishëm i informacionit statistikor dhe indikatorëve (treguesve) të nevojshëm jo vetëm për hartuesit e politikave, por po ashtu, edhe për ata të cilët menaxhojnë programet parandaluese, rehabilituese, arsimore, shëndetësore dhe transportuese, si dhe akademia, institucionet kërkimore, organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe qytetarët në përgjithësi.

Po ashtu duhet të theksohet se kjo fazë duhet të ketë parasysh të dhënave mbi nevojat të cilat rrjedhin prej grupeve tematike punuese gjatë zhvillimit të PKVPAK dhe të cilët tashmë janë të përfshira në matricën e ndryshme tematike.

Në fund, shfrytëzuesit në përgjithësi janë të interesuar për vlerësimin nëse politikat kanë arritur qëllimin e tyre dhe nëse burimet e ndara janë shfrytëzuar plotësisht dhe në mënyrë efikase. Ata, së këndejmi, janë më shumë të interesuar për indikatorët informativë, të cilët janë në gjendje të përshkruajnë nëse janë përmirësuar kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 1.2 Shqyrtimi i burimeve në dispozicion mbi aftësitë e kufizuara, duke përfshirë të dhënave që vijnë nga ministrinë, komunat, OPAK, që nënvizojnë mungesën e informacionit

Identifikimi i burimeve të informacionit në dispozicion në Kosovë është esencialisht për ndërtimin e një pamjeje të saktë të karakteristikave kryesore të të dhënave në dispozicion, aspekteve të hulumtuara të aftësive të kufizuara dhe të procedurave të të dhënave. Burimet e të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara mund të grupohen brenda dy titujve të përgjithshëm: të dhënave administrative ose analizat e popullatës.

Qëllimi i këtij inventari është të identifikojë zbrazëtitë e informacionit mbi aftësitë e kufizuara.

Aktiviteti 1.3 Përkufizimi i aksioneve specifike për të mbledhur të dhënave administrative dhe ato statistikore me qëllim që të tejkalohen zbrazëtitë informative mbi aftësitë e kufizuara

Në momentin kur zbrazëtitë e informacionit identifikohen, hapi tjetër është përcaktimi i burimeve / metodologjive më të duhura të mbledhjes së të dhënave. Ndonjëherë është adekuate të përcillen të dhënave administrative, por po ashtu edhe instrumentet periodike të mbledhjes së të dhënave, siç është regjistrimi i përgjithshëm i popullatës, analizat e ekonomive familjare, analizat e lidhura me punësimin ose edhe analizat ad hoc mund të jenë instrumente adekuate.

²⁷Neni. 31 i KDNPAK në mënyrë specifike adreson mbledhjen e të dhënave me kushtin që: “Palët shtetërore marrin mbi vete të mbledhin informacionin e duhur, duke përfshirë edhe të dhënave statistikore dhe hulumtimin e të dhënave për të mundësuar formulimin dhe zbatimin e politikave që jetësojnë Konventën e tashme..

1. Procesi i mbledhjes së të dhënave dhe i kultivimit të këtij informacioni duhet të jetë në:

a) përputhje me kujdesin e krijuar ligjor duke përfshirë legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave, për të siguruar konfidencialitetin dhe për të respektuar privatësinë e personave me aftësi të kufizuara;

b) përputhje me normat ndërkombëtarisht të pranuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale si dhe parimet etike në mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave statistikore.

2. Informacioni i mbledhur në pajtim me këtë nen duhet të shpërndahet, sipas nevojës, dhe të shfrytëzohet për të ndihmuar vlerësimin e zbatimit të obligimeve të Palëve shtetërore sipas Konventës së tashme dhe për të identifikuar e adresuar pengesat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në realizimin e të drejtave të tyre.

3. Palët shtetërore duhet të marrin përgjegjësitë për shpërndarjen e këtyre të dhënave statistikore dhe duhet të sigurojnë qasshmërinë e tyre ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe të tjerëve.”

Aktiviteti 1.4 Përkufizimi dhe zbatimi i të dhënave të mbledhura dhe standardet e përhapjes

Një marrëveshje e qartë mbi standardet, metodologjinë dhe formimin e të dhënave të mbledhura duhet të arrihet mes ESK dhe prodhuesve të ndryshëm të tjerë të të dhënave, me qëllim që të sigurohet qarkullimi me kohë dhe koherent i të dhënave.

Aktiviteti 1.5 Zhvillimi i Sistemit të Informacioneve mbi aftësitë e kufizuara

Me qëllim që të ndihmohet qasja e lehtë dhe e thjeshtë ndaj të dhënave të paraqitura përmes sistemit të treguesve dhe duke marrë parasysh se shfrytëzuesit kanë kërkesa të ndryshme për informacione dhe nivel të ndryshëm të ekspertizës në shfrytëzimin e të dhënave statistikore, arkitektura e sistemit duhet të përfshijë produkte të tjera siç është metasistemi ose sistemi i të dhënave mbi të dhënat dhe një depo e të dhënave.

Aktiviteti 1.6 Shpërndarja e të dhënave statistikore mbi aftësitë e kufizuara përmes faqes së internetit si dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit

KDNPAK thekson nevojën për shpërndarje të të dhënave në formate të qasshme. Kjo përfshin aplikimin e standardeve për qasje faqe të internetit në dizajnin e faqes së internetit të OSK. Qasshmëria është një çështje për shumë shfrytëzues, duke përfshirë njerëzit me dëmtime vizuale ose të dëgjimit, por po ashtu edhe me aftësi të kufizuara njohëse (kognitive).

Zhvillimi i suksesshëm i SIPAK kërkon një nivel të lartë të koordinimit në kuadër të ofruesve të ndryshëm të të dhënave. Kjo po ashtu lejon arritjen e “konsensusit” midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në sistemin e informimit, inkurajimin e këmbimit të të dhënave dhe lejimin e ndërtimit të një baze të informacionit për sistemin e treguesve. Një aspekt tjetër që duhet të nënvizohet është se kërkohet efikasiteti mbi çështjet statistikore dhe metodologjike. Për këto dy arsye, është sugjeruar se roli koordinues duhet të merret nga ESK, ashtu siç ndodh në disa vende të Evropës.

2. Përmirësimi i krijimit të statistikave zyrtare bazuar në rekomandimet ndërkombëtare

Ky objektivi pjesërisht lidhet me prioritetin e përparshtëm, si element përbërës deri në njëfarë mase, për kufizohet brenda statistikave zyrtare. Tash, mbledhja e të dhënave mbi aftësitë e kufizuara në Kosovë është e rrallë. Regjistrimi i ardhshëm i përgjithshëm i popullsisë është një shans thelbësor për të mbledhur të dhënat themelore mbi personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha aksionet, siç përshkruhet më poshtë, janë hapa të rëndësishëm të nevojshëm për të përforcuar sistemin e mbledhjes së të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara nga ESK.

Aktiviteti 2.1 Miratimi i një përkufizimi mbi aftësinë e kufizuar në pajtim me standardet ndërkombëtare si bazë për krijimin e të dhënave statistikore zyrtare.

Zbatimi i një përkufizimi koherent dhe i një metodologjie të mbledhjes së të dhënave është një shtyllë e sistemit të të dhënave statistikore mbi personat me aftësi të kufizuara, i një rëndësie kyçe për kualitetin e të dhënave dhe për krahasimin e tyre në një nivel ndërkombëtar. Praktika e tashme më e mirë është metodologjia e zhvilluar nga Grupi i Uashingtonit mbi personat me aftësi të kufizuara²⁸, i cili është gjerësisht i shpërndarë nga Zyra e Statistikave të KB, OBSH dhe Banka Botërore.

²⁸ Grupi i Uashingtonit mbi të dhënat statistikore mbi aftësitë e kufizuara është formuar si rezultat i Seminarit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara mbi Matjen e Aftësive të Kufizuara, i cili është mbajtur në New York në Qershor të vitit 2001. Një rezultat i atij takimi ka qenë pranimi se puna në të dhënat statistikore dhe metodologjinë është e nevojshme në një nivel ndërkombëtar me qëllim që të lehtësojë krahasimin e të dhënave mbi aftësitë e kufizuara në një kontekst ndërnacional. Si rezultat i kësaj, Divizioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara e ka autorizuar formimin e City Group për të adresuar disa nga çështjet e identifikuar në Seminarin Ndërkombëtar dhe e ka thirrur Qendrën Kombëtare për Statistikat Shëndetësore, Agjencinë zyrtare të statistikave për shëndetësinë të Shteteve të Bashkuara, për të qenë nikoqir i takimit të parë të këtij grupi (City Group). Format i City Group është ai që është përdorur nga Kombet e Bashkuara (KB) në shumë raste të tjera për të adresuar problemet e ndryshme në matjen e analizave dhe metodologjisë, siç është Rio Group, i cili fokusohet në të dhënat statistikore mbi varfërinë. City Group është format informal i organizimit të përkohshëm që u mundëson përfaqësuesve nga agjencitë kombëtare të statistikave dhe nga organizatat ndërkombëtare, siç është OBSH-ja, Banka Botërore, UNSD, EUROSTAT, të bashkohen për të adresuar problemet e përzgjedhura në metodat statistikore. City Group zakonisht emërohet sipas vendit të takimit të parë.

Aktiviteti 2.2 Ndërtimi i kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara

Ndërtimi i kapaciteteve për aktorët e përfshirë në mbledhjen e të dhënave është një kusht për përmirësimin e kualitetit të të dhënave. Janë shfrytëzuar qasje të reja për përkufizimin e aftësive të kufizuara në Klasifikimin e ri Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësitë e kufizuara dhe Shëndetin (OBSH, 2001) si dhe KDNJPAK, dhe, së këndejmi, mbledhja e të dhënave duhet të jetë në pajtim me konceptet e reja të aftësive të kufizuara

Aktiviteti 2.3 Miratimi i çështjeve mbi aftësitë e kufizuara në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare në Regjistrimin e përgjithshëm të ardhshëm të popullsisë

Regjistrimi i përgjithshëm i ardhshëm i popullsisë është një shans i veçantë për të filluar me sistemin e informimit mbi aftësitë e kufizuara. Përshtatja në kuadër të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të një vargu të pyetjeve të zhvilluara nga Grupi i Uashingtonit mbi aftësitë e kufizuara është një rekomandim i fortë për të cilin është arritur pajtimi nga grupi punues dhe fuqishëm i mbështetur nga të gjithë ekspertët ndërkombëtarë²⁹.

²⁹ Pyetjet e Regjistrimit të Korrigjuar mbi Aftësitë e Kufizuara, miratuar nga Grupi i Uashingtonit mbi Aftësitë e Kufizuara (Washington Group on Disability)

Fjala hyrëse:

Pyetjet e mëposhtme kanë të bëjnë me vështirësitë të cilat mund t'i kenë gjatë kryerjes së aktiviteteve të caktuara për shkak të problemeve shëndetësore.

Pyetjet thelbësore:

A keni vështirësi në të parë, madje edhe nëse mbani syza?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

A keni vështirësi në të dëgjuar, madje edhe nëse përdorni aparatën për dëgjim?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

A keni vështirësi gjatë ecjes ose ngjitjes së shkallëve?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

A keni vështirësi në mbamendje ose në përqendrim?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

Pyetje plotësuese:

A keni vështirësi (lidhur me kujdesin për vetveten) gjatë pastrimit ose veshjes?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

A keni vështirësi gjatë përdorimit të gjuhës tuaj të zakonshme, në komunikim për shembull, në të kuptuarit ose në të qenët i kuptuar?

Jo – pa vështirësi

Po – disa vështirësi

Po – mjaft vështirësi

Nuk mund t'ia dal fare

Aktiviteti 2.4 Futja dhe konsolidimi i pyetjeve mbi aftësitë e kufizuara në analizat periodike të zhvilluara nga Enti Statistikor i Kosovës

ESK është përgjegjës për anketat periodike siç është ajo e Analizës së Buxhetit të Ekonomisë Familjare (ABEF) dhe Analiza e Forcës Punuese (AFP). Fuqishëm është rekomanduar që AFP në vitin 2009 dhe ABEF për vitin 2010 të përfshijnë të njëjtën pako të pyetjeve të sugjeruar për Regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë. Kjo praktikë po ashtu do të mundësojë monitorimin e trendeve të aftësive të kufizuara midis dy regjistrimeve të përgjithshme të popullsisë.

Aktiviteti 2.5 Realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara dhe / ose i anketës së atypëratyshme (ad hoc) mbi aspekte specifike të aftësive të kufizuara

Rekomandimi final parasheh mundësinë e Regjistrimit të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara për të mbledhur të dhëna të hollësishme mbi aftësitë e kufizuara në Kosovë. Vërtet, një regjistrim i përgjithshëm i popullsisë mundet vetëm të mbledhë informacione gjysmake mbi aftësitë e kufizuara të cilat në masë të madhe do të përmirësohen me informacione më kualitative dhe kuantitative të mbledhura përmes një Regjistrimi të Veçantë të Personave me aftësi të kufizuara. Një përplotësim i mundshëm dhe alternativ ndaj këtij aktiviteti do të ishte zhvillimi i një ankete të tipit ad hoc mbi aspekte të veçanta të aftësive të kufizuara.

TË DHËNA STATISTIKORE

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Mbledhja e informacionit të duhur për të mundësuar formulimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave mbi aftësitë e kufizuara	1.1 Analizimi dhe identifikimi i indikatorëve të nevojshëm për të ndërtuar një sistem të integruar të mbledhjes së të dhënave mbi aftësitë e kufizuara	MSHP, ESK, Ministritë, OPAK, OJQ-të	Raporti mbi indikatorët e nevojshëm për të zhvilluar Sistemin e Informacioneve mbi Aftësitë e Kufizuara (SIAK)	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 2.500 Euro
	1.2 Shqyrtimi i burimeve në dispozicion mbi aftësitë e kufizuara, duke përfshirë të dhënat që vijnë nga ministritë, komunat, OPAK, duke nënvizuar mungesën e informacionit.	MSHP, ESK, Ministritë, IKSHP, OPAK, OJQ-të	Inventarizimi i të dhënave, raporti mbi mungesën e informacioneve	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 15.000 Euro
	1.3 Përkufizimi i veprimeve specifike për të mbledhur të dhënat administrative dhe statistikore me qëllim të tejkalimit të zbrazëtisë së informacioneve mbi aftësitë e kufizuara.	MSHP, ESK, Ministritë, IKSHP, OPAK, OJQ-të	Zhvillimi i planit të hollësishëm të qarkullimit të ri të informatave	2010	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 2.500 Euro
	1.4 Përkufizimi dhe zbatimi i standardeve të reja të mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave	MSHP, ESK, Ministritë, IKSHP, OPAK, OJQ-të	Zbatimi i Marrëveshjeve midis ESK dhe krijuesve të të Dhënave lidhur me mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave	2010	KASH Aktivitetet me shpenzime të ulëta 2.500 Euro
	1.5 Zhvillimi i Sistemit të Informacioneve mbi aftësitë e kufizuara	MSHP, ESK	Përkufizimi dhe krijimi i strukturës arkitekturale të Sistemit të Informacioneve mbi Personat me Aftësitë Kufizuara (SIAK).	2011	KASH 25.000 Euro
	1.6 Shpërndarja e të dhënave statistikore mbi aftësitë e kufizuara përmes faqes së internetit si dhe mjeteve të tjera të komunikimit	MSHP, ESK	Funksionalizimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i faqës së internetit sipas standardeve ndërkombëtare mbi qasjen e komunikimit për persona me aftësi të kufizuara.	2011	KASH 11.000 Euro

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
2. Përmirësimi i krijimit të të dhënave statistikore zyrtare bazuar në rekomandimet ndërkombëtare	2.1 Zbatimi i përkufizimit të aftësive të kufizuara si bazë për krijimin e të dhënave zyrtare statistikore.	MSHP, ESK, Ministritë, IKSHP, OPAK, OJQ-të	Përputhshmëria e përkufizimit të aftësive të kufizuara me standardet ndërkombëtare	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta 2.500 Euro
	2.2 Ndërtimi i kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave mbi aftësitë e kufizuara.	MSHP, ESK, Ministritë, IKSHP	Trajnimet e realizuara	2009	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 7.000 Euro
	2.3 Miratimi i çështjeve lidhur me aftësitë e kufizuara në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare në regjistrimin e ardhshëm të popullatës	MSHP, ESK	Përputhshmëria e të dhënave statistikore me standardet ndërkombëtare	2009	KASH Aktivitetet me shpenzime të ulëta (pa shpenzime)
	2.4 Futja dhe konsolidimi i pyetjeve mbi aftësitë e kufizuara në anketat periodike të zhvilluara nga Enti Statistikor i Kosovës.	MSHP, ESK	Përshtatja e pyetjeve mbi aftësitë e kufizuara në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare në Analizat e tashme të Buxhetit të Ekonomive Familjare dhe të Forcës së Punës. Mundësimi i krahasimit të të dhënave nga periodha të ndryshme kohore	2010	Aktivitetet me shpenzime të ulëta KASH 2.500 Euro
	2.5 Zhvillimi i regjistrimit të personave me aftësi të kufizuara dhe/ose i anketave të tipit ad hoc mbi aspektet e veçanta të aftësive të kufizuara	MSHP, ESK	Mbledhja e të dhënave dhe shpërndarja e rezultateve	2011	KASH 1 milion Euro

Shkurtesat

MSHP Ministria e Shërbimeve Publike
 ESK Enti Statistikor i Kosovës
 IKSHP Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
 OJQ-të Organizatat Joqeveritare
 OPAK Organizatat për Persona me Aftësi të Kufizuara
 SIAK Sistemi i Informimit mbi Aftësitë e Kufizuara
 ABEK Analiza e Buxhetit të Ekonomive Familjare
 AFP Analiza e Forcës së Punës
 BKK Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
 KASH Korniza Afatmesme Shpenzimeve 2009-2011

6.8 MONITORIMI, VLERËSIMI DHE SISTEMI I RAPORTIMIT PËR PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Përmes hartimit dhe publikimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK), Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e njeriut dhe Mundësi të Barabarta, për herë të parë në Republikën e Kosovës ndërmerr një qasje serioze zyrtare ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara me një dokument i cili garanton të drejtat dhe saktëson masat për monitorimin e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara do të implementohet gjatë kornizës kohore 2009-2011.

Implementimi i Planit të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara (PVAK) dhe zbatimi progresiv i tij kërkon zhvillimin e një sistemi për monitorim dhe vlerësim të rezultateve të arritura. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e Kombeve të Bashkuara parasheh në nenin 33 një sistem prej tri nivelesh, i cili përfaqëson një kornizë paradigmatiche për Planit të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara (PVAK), i frymëzuar mbi parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes.

Pika Qendrore: përcaktimi brenda Qeverisë për një Pikë Qendrore Kombëtare të ngarkuar me përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) është element kyç i ndërtimit dhe zbatimit të sistemit të monitorimit. Sipas Vendimit nr.10/20 të Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila e ka deleguar përgjegjësinë e hartimit të Planit të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara (PKVPAK) tek Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM). Kjo Zyrë do të caktohet si Pikë Qendrore e ngarkuar me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit. Çështja e aftësive të kufizuara saktësisht është çështje e lidhur për një fushë më të gjerë të të drejtave të njeriut.

Për këtë qëllim, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit duhet të pajiset me personelin teknik dhe administrativ të nevojshëm për të mundësuar koordinimin e monitorimit, vlerësimin dhe raportimit konkret të aktiviteteve implementuese të Planit të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara (PVAK).

Në pajtim me qëllimet dhe objektivat e saktësuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, plani pasqyron dhe saktëson detyrat konkrete, palët e ndryshme të interesuara të ngarkuara me zbatimin e veprimeve, krahas treguesve të rezultateve dhe kornizave të caktuara kohore.

Organi Koordinues: *Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta* do të menaxhojë organin koordinues të përbërë nga palët e interesuara, njësitë për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesit e shoqërisë civile (përfaqësuesit e shoqatave, OJQ-ve dhe Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuara (OPAK)).

Organi Koordinues do të ketë qëllimet dhe detyrat e mëposhtme:

- Të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit për Aftësitë e Kufizuara (PVAK);
- Të përkrahë elaborimin e rezultateve të monitorimit me qëllim të sigurimit të një vlerësimi të bazuar në treguesit kualitativë dhe kuantitativë;
- Të nxisë mbledhjen e të dhënave statistikore sistematike dhe të informatave lidhur me situatën e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në bashkëpunim me institucionet relevante përgjegjëse;
- Të nxisë përpilimin e analizave dhe kërkimeve, të cilat mund të kontribuojnë drejt identifikimit të veprimeve / intervenimeve parësore për promovim;
- Të përkrahë mbledhjen e të dhënave statistikore sistematike dhe të informacioneve lidhur me situatën e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me institucionet relevante përgjegjëse;
- Të shpërndajë në formatin e duhur të gjitha informacionet e mbledhura dhe
- Të bashkëpunojë dhe t'i raportojë Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara për implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK).

Në fund, pika qendrore është përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi implementimin e gjithmbarshëm të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) në Republikën e Kosovës. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e njeriut dhe Mundësi të Barabarta periodikisht raporton - çdo gjashtë 6 muaj për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe njëherit monitoron dhe vlerëson çdo vit procesin e implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

MONITORIMI, VLERËSIMI DHE SISTEMI I RAPORTIMIT

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
1. Identifikimi i pikave qendrore të PVPAK	1.1 ZQM/ZKM do të shërbej si Pikë Qendrore për PKVPAK përmes një vendimi zyrtar.	Qeveria, ZQM	Miratimi i aktit të emërimit	2009	BKK
	1.2 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit identifikon personelin e duhur për monitorim të aktiviteteve nga PKVPAK	Qeveria, ZQM	Identifikimi i personelit nga ZKM/ZQM	2009	BKK
	1.3 Trajnimi i personelit	ZQM	Numri i kurseve,seminareve etj., Numri i njerëzve të trajnuar	2010	KASH
2. Ngritja e një mekanizmi koordinues	2.1 Emërimi i një Organi Koordinues për PKVPAK	Qeveria, ZQM, Ministritë, Komunat, OPAK dhe Ombudspersoni	Emërimi i Organit Koordinues	2009	BKK
	2.2 Identifikimi dhe përkufizimi i kompetencave të Organit Kordinues	Qeveria, ZQM, Ministritë, Komunat, OPAK dhe Ombudspersoni	Përkufizimi i Rregullave të Organit Koordinues	2009	BKK
	2.3 Ngritja e një sistemi të mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve bazuar në standardet ndërkombëtare	ZQM,Organi Koordinues, MSHP – ESK në bashkëpunim me institucionet e duhura	Përkufizimi i Rregullave dhe udhëzimeve	2010	KASH
	2.4 Mbajtja e analizave, kërkimeve dhe studimeve mbi kushtet e personave me aftësi të kufizuara	ZQM,Organi Koordinues, MSHP – ESK në bashkëpunim me institucionet e duhura	Numri dhe kualiteti i analizave, kërkimeve dhe studimeve të mbështetura	2010	KASH

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët	Treguesit	Afatet kohore	Burimet
3. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi mbi implementimin e PKVPAK	3.1 Monitorimi i implementimi të PKVPAK	Pika Qendrore (ZQM) Organi koordinues	Monitorimi PKVPAK	2010	KASH
	3.2 Vlerësimi i monitorimit të PKVPAK	Pika Qendrore (ZQM)	Vlerësimi i monitorimit	2010	KASH
	3.3 Përgatitja e raporteve për çdo gjashtë muaj lidhur me implementimin e PKVPAK	Pika Qendrore (ZQM)	Numri i raporteve të bëra	2010	KASH
	3.4 Shpërndarja, në formatin e duhur, e të gjitha informacioneve të mbledhura, duke përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe raportet periodike	Pika Qendrore (ZQM) Organi Koordinues	Numri dhe kualiteti i informacioneve, monitorimit, vlerësimit dhe i raporteve të shpërndara	2010	KASH

Shkurtesat

PKVPAK Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara

ZQM Zyra për Qeverisje të Mirë

MSHP Ministria e Shërbimeve Publike

ESK Enti Statistikor i Kosovës

OPAK Organizatat për Persona me Aftësi të Kufizuara

KASH Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

BKK Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

6.9 SHTOJCAT

SHTOJCA I. LIGJET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PLANIN E VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008 (faqja e internetit: <http://www.kuvendikosoves.org/>)

SHËNDETËSIA

- Ligji për shëndetësi në Kosovë nr.2004/4
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për shëndetësi në Kosovë nr.2004/31
- Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nr.2004/38
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor nr.2004/47
- Ligji për inspektoratin shëndetësor nr.02/L-38
- Rregullorja mbi shpalljen e ligjit për Inspektoratin Shëndetësor nr.2006/13
- Ligji mbi shëndetin publik nr.02/L-78
- Rregullorja për zbatimin e ligjit mbi shëndetin publik nr.2008/6
- Ligji për produktet medicinale dhe pajisjet mjekësore nr.2003/26
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi produktet medicinale dhe pajisjet mjekësore nr.2004/23
- Ligji për amendamentimin e ligjit mbi shëndetësinë nr.03/L-124
- Dekreti për shpalljen e ligjit për amendamentimin e ligjit mbi shëndetësinë nr.DL-074-2008
- Ligji mbi barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë nr.02/L-128
- Rregullorja për zbatimin e ligjit mbi barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë nr.2008/10

ARSIMI

- Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë nr.2002/2
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë nr.2002/19
- Ligji për arsimin e lartë Nr. 2002/03
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për arsimin e lartë nr.2003/14
- Ligji për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve nr.02/L-24
- Rregullorja mbi shpalljen e ligjit për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve nr.2005/43
- Ligji për arsimin parashkollor Nr. 02/L-52
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për arsimin parashkollor nr.2006/11
- Ligji mbi inspektimin e arsimit në Kosovë Nr. 2004/37
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi inspektimin e arsimit nr.2004/55
- Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik Nr. 02/L-67
- Rregullorja mbi shpalljen e Ligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik nr.2006/45
- Ligji për arsim në komunat e Kosovës Nr. 03/L-068
- Dekreti për shpalljen e ligjit për arsim në komunat e Kosovës nr.DL-024-2008

PUNËSIMI:

- Ligji themelor i punës në provincën e Kosovës të administruar nga KB-ja, nr.2001/27
- Ligji themelor i punës Nr. 11/03
- Ligji mbi arsimimin dhe aftësimin profesional nr.02/L-42
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për arsimimin dhe aftësimin profesional nr. 2006/24
- Ligji për aftësimin profesional, rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nr.03/L-019
- Dekreti mbi shpalljen e ligjit për aftësimin profesional, rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nr.DL-084-2008

MBROJTJA SOCIALE

- Ligji për skemën e ndihmës sociale në provincën e Kosovës të administruar nga KB-të nr.2000/66
- Rregullorja mbi beneficionet e invalidëve të luftës të Kosovës dhe anëtarët e familjeve të personave që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë
- Ligji mbi metodologjinë për caktimin e nivelit të pensionit bazë Nr. 2002/1
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi metodologjinë e caktimit të nivelit të pensioneve bazë nr. 2002/15
- Ligji për shërbimet familjare dhe sociale nr.02/L-17
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për shërbimet familjare dhe sociale nr.2005/46
- Ligji për statusin dhe të drejtave të familjeve të invalidëve, veteranëve dhe viktimave civile të luftës nr.02/L-2
- Ligji mbi skemën për ndihmë sociale në Kosovë nr.2003/15
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi skemën për ndihmë sociale në Kosovë nr. 2003/28
- Ligji mbi pensionet invalidore nr. 2003/23
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi pensionet invalidore nr. 2003/40
- Ligji për përkrahjen materiale për familjet e fëmijëve me paaftësi të përhershme nr.03/L-022
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për përkrahje materiale të fëmijët me paaftësi të përhershme PSSP nr.2008/33

QASJA

- Ligji për planifikim hapësinor nr.2003/14
- Rregullorja për shpalljen e ligjit për planifikim hapësinor nr.2003/30
- Ligji mbi ndërtimin nr.2004/15
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi ndërtimin nr.2004/37
- Ligji për amendamentimin e ligjit për planifikim hapësinor nr.03/L-106
- Dekreti për shpalljen e ligjit mbi amendamentimin e ligjit për planifikim hapësinor nr.DL-055-2008
- Ligji për Radio Televizionin e Kosovës nr.02/L-47
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi RTK-në nr.2006/14

TË DHËNAT STATISTIKORE

- Ligji për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë nr.2003/16
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë nr.2004/53

DECENTRALIZIMI

- Ligji për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040
- Dekreti për shpalljen e ligjit për vetëqeverisje lokale nr.DL-008-2008
- Ligji për financat e qeverive lokale nr.03/L-049
- Dekreti mbi shpalljen e ligjit për financat e qeverive lokale nr.DL-015-2008
- Ligji për kufijtë administrativë të komunave nr.03/L-041
- Dekreti mbi shpalljen e ligjit për kufijtë administrativë komunalë nr.DL-009-2008

TË TJERA

- Ligji kundër diskriminimit nr.2004/3
- Rregullorja për shpalljen e ligjit kundër diskriminimit nr.2004/32
- Ligji për qasje në dokumente zyrtare nr.2003/12
- Rregullorja mbi ligjin për qasje në dokumente zyrtare nr.2003/32
- Ligji për bibliotekat nr.2003/06
- Rregullorja mbi shpalljen e ligjit mbi bibliotekat nr.2003/19
- Ligji mbi sportin nr.2003/24
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi sportin nr.2004/26
- Ligji mbi familjen në Kosovë nr.2004/32
- Rregullorja për shpalljen e ligjit mbi familjen në Kosovë nr.2006/7

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës

- Ligji për akreditim nr.03/L-069
- Dekreti mbi shpalljen e ligjit për akreditim nr.DL-067-2008
- Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, Nr. 03/L-105
- Dekreti mbi shpalljen e ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, nr.DL-081-2008